



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES
L.1 Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 2223 10
e-mail:info@durres.gov.al

Lënda:Kthim Përgjigje

Drejtuar:Qendrës "Res Publica"

Adresa:BLV "Gjergj Fishta "Nd.24, H.3,Ap.44,

Tiranë

Gjithashtu ju bëjmë me dije se në Bashkinë Durrës që nga viti 2004 ekziston zyra e Mardhënieve me Publikun ,ku cdo qytetar ka të drejtë të bëjë kërkesë apo ankesë, për probleme të ndryshme për të cilat mer një përgjigje brenda një afati ligjor të caktuar, por dhe takime me drejtorë dhe specialistë të Drejtorive të ndryshme në ditë të caktuara të javës, sipas problematikave të qytetarëve.Çdo kërkesë që plotësohet protokollohet, dhe më vonë mbahet në arkivën e institucionit.Qytetarët japin mendimin e tyre dhe me anë të takimeve të ndryshme që organizohen me Kryetarin e Bashkisë, dëgjësave publike që organizohen ,web-it të Bashkisë ku meret informacion dhe njëkohësisht mund të jepen dhe mendime të ndryshme lidhur me problematikën përkatëse.

Një informacion më i detajuar në lidhje me këto kërkesa (nr ,problematikën)e gjeni dhe në Buletin Statistikor 2015,(bashkëngjitur si më poshtë).Botim i përviteshem i Bashkise Durrës.

Ndihma ekonomike e dhënë nga Drejtoria përkatëse e institucionit, jepet për kategori të ndryshme personash si:fëmijët pa të ardhura fare, fëmijët pa të ardhura të mjaftueshme, jetimët që janë nën 25 vjeç të papunë, familjet kujdestare të fëmijëve , gratë e dhunuara, viktimat e trafikimit.

Nga dt 1-10 të çdo muaji të gjithë personat mbi 18 vjeç, që janë në moshë për të punuar paraqiten në njesitë administrative për të plotësuar formularin përkatës.Këto persona duhet të jenë të pajisur me kartë identiteti një dokument pronësie, (nëse kanë tokë), vërtetim nga zyra e punës si i papunë. Kriteret janë të vendosura sipas vendimit 904 të Këshillit të Ministrave. Proçdurat janë standarte për pagesat në kesh, për arsye të paaftësive ose statuseve të ndryshme që mund të kenë këto persona si: me statusin e të verbërit, me statusin paraplegjikë, kategoria e invalidëve të punës ,persona me aftësi të kufizuar të grupeve te ndryshme (mendore,fizike),personat kujdestarë per këta femije.Paafhtësine e personave e përcakton komisioni mjeksor.Masat dhe kriteret e pagesës janë të përcaktuara me Vendim Qeverie(për të gjitha grupet).

Në Buletin Statistikor që po ju bashkëngjisim , keni të dhëna mjaft të detajuara për kërkesat tuaja ,gjithashtu gjeni informacion mbi të gjithë strukturën e Bashkisë ,drejtorite dhe shërbimet e tyre, nëpunësit e institucionit dhe pagat e tyre të ndara sipas kategorive,buxhetin e ndarë në zëra përkatës, prokurimet publike etj.

Gjithashtu ne përgjigje dhe të shkresës nr.362/16(referuar protokollit tuaj), ju sqarojme si më poshte:

Qyteti i Durrësit nuk ka kontrata pastrimi me të tretë, pasi pastrimi kryhet nga dy ndërmarjet publike të Bashkisë Durrës.

Me riorganizimin e ri,pas reformës territoriale disa nga ish komunat kanë pasur shërbim për pastrimin me kompani private.

Ju lutemi na sqaroni më konkretisht se për çfarë kontratash të pastrimit bëhet fjalë.

Duke ju falenderuar per bashkëpunimin mbetemi te hapur per çdo lloj informacioni.

Kondinatori për të drejtën e informimit

Vilma Hyseni

BASHKIA DURRES



Buletini Statistikor

2015

Buletini Informativ Statistikor Vjetor i Bashkisë Durrës 2015

Botuar nga Bashkia Durrës

Realizimi i botimit:

Sektori i Statistikave në Departamentin e Politikave Zhvilluese

Punoi: **Etleva VOCI**

Botimi i Njëmbëdhjetë

Falenderoj të gjithë Drejtoritë pranë Bashkisë Durrës si dhe Ndërmarrjet në varësi apo Institucione të tjera të qytetit tonë dhe Komunat për bashkëpunimin e vazhdueshëm, të cilët ndihmuan në realizimin e këtij Buletini Informativ Statistikor.

Bashkia Durrës

Sheshi “Liria”

Telefon: +355 52 223454

Tel/fax: +355 52 222310

www.durres.gov.al www.visitdurres.com

e-mail: info@durres.gov.al

PERMBAJTJA

• Profili i Qytetit të Durrësit.....	4
• Profili i Zhvillimit të Qytetit të Durrësit.....	29
• Demografia.....	42
• Tregu i Punës.....	44
• Stema e Bashkisë.....	48
• Historiku i Bashkisë dhe i Kryebashkiakëve të Bashkisë.....	49
• Këshilli Bashkiak.....	51
• Burimet Njerëzore.....	62
• Marrëdhëniet me Publikun dhe Institucionet.....	65
• Ndihma Ekonomike dhe Shërbimi Social.....	68
• Infrastruktura-Shërbimet Publike.....	117
• Shërbime të tjera.....	137
• Aktiviteti Ekonomik.....	148
• Aktiviteti Ligjor.....	182
• Politikat Zhvilluese.....	198
• Urbanistika.....	211
• Shëndetësi-Arsim-Kulturë-Sport.....	215
• Gjobat dhe Kontrollët.....	248

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

POZITA GJEOGRAFIKE DHE NDARJA ADMINISTRATIVE

E QYTETIT TE DURRESIT

Durrësi është një nga qytetet më të vjetër të Shqipërisë. Si vendbanim Ilir i fisit Taulant, ka të dëshmuar jetën e tij që në prehistori, bazuar në gjetjet arkeologjike dhe të dëshmive të autorëve antikë. Ka mbijetuar në shekuj deri në ditët e sotme. Muzetë, objektet dhe monumentet e vizitueshme, si dhe vetë qyteti me rrethinat e afërta të Durrësit i pasqyrojnë më së miri vlerat historike, arkeologjike, etnografike, natyrore dhe urbanistike.

Durrësi është qendra më e rëndësishme portuale dhe turistike e Shqipërisë dhe qyteti i dytë më i rëndësishëm i vendit nga pikëpamja politike, ekonomike, administrative, edukative, shkencore dhe kulturore të vendit.

Ka një pozitë rajonale gjeografike strategjike të favorshme, përmes pikave me vlerë të madhe territoriale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shtrihet buzë detit Adriatik në një gjatësi bregdetare rreth 30 milje.

Bashkia Durrës shtrihet nga Kepi i Rodonit në veriperëndim deri tek Përroi i Agait pas Shkëmbit të Kavajës në jugperëndim. Ajo kufizohet me Bashkinë Kurbin në veri, me Bashkinë Krujë, Vorë dhe Shijak në lindje si dhe me Bashkitë Tiranë dhe Kavajë në jug dhe juglindje.

Bregdeti perendimor i krahinës laget nga ujrat e detit Adriatik.

Vija kufitare e bregdetare:	114 km e gjatë dhe ndahet në:
Kufij tokësor:	45.3 km
Kufij lumor :	7.1 km
Vijë bregdetare:	61.6 km
Sipërfaqja e Bashkisë Durrës:	341.9 km ²
Sipërfaqja e qytetit:	46.1 km ²
Distancat:	39 km larg nga kryeqyteti, Tirana.
	30 km larg nga Aeroporti i Tiranës “Nënë Tereza”
	150 km larg nga Mali Zi (Hani i Hotit)
	243 km larg nga Kosova (Morinë)

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE

TE QYTETIT TE DURRESIT

162 km larg nga Maqedonia (Qafë Thanë)

184 km larg nga Tushemishti

178 km larg nga Bllata

Popullsia: 309190 banorë

Durrësi bën pjesë në zonën Mesdhetare Atlantike dhe është në Qendër të Ultësirës Perendimore Prandariatike të Shqipërisë.

Koordinatat gjeografike përcaktuese për qytetin e Durrësit janë:

Gjerësi gjeografike veriore: 41° 18' 40"

Gjatësi gjeografike lindore: 19° 26' 21"

Ora lokale sipas orës 12 të Europës Qendrore është 12° 17' 45"

Relievi i qytetit të Durrësit është kryesisht fushor dhe kodrinor, ku lartësia më e madhe është Kodra e Durrësit me 178 m e lartë. Nga pikëpamja fizike, territori i Durrësit karakterizohet nga një terren bujqësor në pjesën e saj më të madhe, ku mbizotërojnë fushat e Katundit të Ri, Sukthit dhe Mnzës, përmes të cilave kalon lumi Erzen. Në pjesën veriore dhe lindore, territoret fushore, kufizohen me vargun kodrinor të Manzës dhe të Ishmit, me një lartësi 269 m mbi nivelin e detit, të cilat pozicionohen si kurorë natyrore e Gjirit të Lalëzit. Në pjesën jugore, dhe konkretisht në Rrashbull, ngrihet gradualisht terreni në formacionet kodrinore të Arapajt, të cilat luajnë rolin e kufizuesit natyror të “fushës” së Durrësit. Sistemi i kodrave gjarpëron nga Kepi i Rodonit, në Bishtin e Pallës deri në Kodrën e Durrësit, i shtrirë në pjesën veriperendimore të qytetit të Durrësit. Ky varg kodrinor shërben si një barrierë natyrore ndaj erërave detare për qytetin e Durrësit dhe zonave në veri të tij. Në veri-lindje të Kodrës së Durrësit, shtrihet fusha e Spitallës 60 km².

Durrësi bën pjesë në brezin subtropikal dhe karakterizohet nga një klimë me dimër të butë dhe të lagësht dhe verë të nxehtë dhe të thatë.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE

TE QYTETIT TE DURRESIT

• Temperatura mesatare vjetore	15.5°C
• Temperatura mesatare e Janarit	7°C
• Temperatura mesatare e Gushtit	24°C
• Temperatura absolute me e ulet ka zbritur ne	-4.4°C
• Temperatura absolute me e larte ka arritur	39°C-43°C
• Sasia mesatare vjetore e reshjeve	963 mm
• Sasia maksimale vjetore	1542 mm
• Sasia minimale vjetore	637.7 mm
• Ore me diell ne vit	2786 ore
• Lageshtia mesatare vjetore	70%
• Shpejtesia e eres me e madhe sipas muajve	24-40m/sek
• Drejtimi kryesor i eres	veri-juglindore, perendimore, puhi detare.
• Lartesia mbi nivelin e detit	89m

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES



Durrësi, i cilësuar që para 2070 vjetësh, nga romaku Gai Katuli si “Taverna e Adriatikut” është jo vetëm qyteti më i vjetër i banuar pa ndërprerje dhe porti më i madh i vendit, por dhe destinacioni turistik më masiv në Shqipëri.

Në jetën e tij të gjatë gati 3000-vjecare, qyteti ynë ka pritur dhe përcjellë me qindra mijë vizitorë e kalimtarë. Poetë dhe historianë, gjeografë dhe udhëtarë kanë shkruar për Durrësin, qytetin e njohur fillimisht me emrin Epidamn dhe më pas Dyrrachium.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Qyteti që ju fton t'a vizitoni ka disa cilësi të vecanta, të cilat me siguri nuk i gjen kështu së bashku në qytetet e tjera të Shqipërisë.

Durrësi është themeluar 27 shekuj më parë. Qyteti antik vazhdon të mbijetojë pas dhjetra luftrave dhe tërmeteve shkatërruese. Paraardhësit tanë e kanë rindërtuar atë në të njëjtin vend, pa e braktisur kurrë Durrësin, qytetin më të vjetër të Adriatikut Lindor.

Përse Durrësi është një destinacion i pashmangshëm turistik për këdo që vjen në vendin tonë?

Brenda qytetit ndodhet Porti më i madh i vendit, në të cilin lëvizin drejt porteve të perëndimit afro 800 mijë udhëtarë dhe 3 milion ton mallra në vit. Për këdo që do të vijë me avion, do t'a gjejë Durrësin vetëm 30 km larg nga aeroporti "Nënë Tereza" dhe po aq larg nga kryeqyteti. Ndërsa për transportin automobilistik dhe hekurudhor, po të perifrazojmë shprehjen latine: "të gjitha rrugët të cojnë në Durrës". Për këdo që vjen nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia apo Greqia, rrugët do të sjellin me siguri në qytetin tonë, aty ku kryqëzohen akset rrugore të veriut, jugut dhe pjesës qendrore të vendit.

Ndërsa kur je në Durrës befasishtë janë të shumta. Pranë qytetit ndodhet Plazhi më i madh i vendit me një shtrirje prej 6 km, ndërsa në veri të tij ka ende gjire detare thuajse të virgjëra, të gatshme për të pritur vizitorë të rinj.

Pallatet shumëkatëshe të ndërtuara vitet e fundit gërkshëtohen me monumentet arkeologjike mijëvjeçare, ndër të cilat dallon amfiteatri antik, më i madhi i këtij lloji në të gjithë Ballkanin. Muzeu arkeologjik dhe etnografik, muret rrethuese mesjetare të qytetit, termat antike dhe hamami mesjetar, janë vetëm një pjesë e vogël e trashëgimisë kulturore, e cila vitet e fundit po mbledh turistë që mbrrijnë me krocera nga vende të ndryshme të botës.

Kalendari i festave dhe veprimtarive kulturore të qyteti shtohet çdo vit. Festivali ndërkombëtar i Poezisë dhe ai i Dancit modern dhe konteporan, takimet e muzikës klasike me ato të xhazit, festat qytetare dhe koncertet e organizuara në sheshe si dhe baret dhe restorantet e pafund në bregdet i bëjnë mbrëmjet e Durrësit krejtësisht të vecanta. Por ajo që dallon mbi të gjitha është mikpritja që ofrojnë qytetarët durrsakë.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Ndër llojet e ndryshme të turizmit, vendin kryesor në Durrës e zë ai i banjove diellore, ujore e ranore. Kjo lidhet me kushtet optimale që krijon plazhi i Durrësit me motin e nxehtë e të qendrueshëm gjatë stinës së verës, ujin e ngrohtë të detit dhe rërën e imët e me sipërfaqe mjaft të gjërë. Numri më i madh i pushuesve në plazhin e Durrësit konsiderohet gjatë muajve Korrik dhe Gusht. Megjithatë sezoni turistik i Durrësit është shumë më i gjatë. Në varësi të motit ai fillon nga fundi i muajit Prill dhe vazhdon deri në fillim të muajit Tetor.



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

SI TE VINI NE DURRES

Në Durrës mund të vini në çdo kohë për pasuritë e tij historike e kulturore, lokalet e bukura dhe shëtitjet buzë detit.

Për të ardhur në Durrës mund të përdorni të gjitha mjetet e transportit. Porta më e rëndësishme e hyrjes dhe daljes është porti i qytetit. Ndërkohë që Durrësi ndodhet jo më shumë se 30 km larg aeroportit të Rinasit dhe është i lidhur me të gjitha rrugët automobilistike dhe hekurudhore që ka vendi.

NEPERMJET DETIT

Linja të rregullta trageti lidhin Durrësin me Barin, Ankonën dhe Triesten. Me Portin e Barit ka lidhje të përditshme, ndërsa me Ankonën dhe Triesten ka 3-5 udhëtime në javë. Gjatë sezonit të verës dhe për festat e fundvitit, vendosen gjithmonë tragete dhe udhëtime shtesë për të perballuar fluksin e lartë të udhëtarëve, kryesisht emigrantë shqiptarë vendas dhe nga kosova që vijnë për pushime apo pranë familjeve.



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

NEPERMJET AJRIT

Nëpërmjet aeroportit të Rinasit, 30 km larg, rreth gjysëm ore.

NEPERMJET RRUGES ME MAKINEN TUAJ

Durrësi ofron lidhje automobilistike me Tiranën dhe gjithë qytetet e vendit. Distancat që duhet të dini: Tiranë-Durrës (35 km), Shkodër-Durrës (140 km), Korçë-Durrës (209 km), Pogradec-Durrës (168 km), Elbasan- Durrës (82 km), Fier-Durrës (84 km), Gjirokastër-Durrës (202 km).

NEPERMJET RRUGES ME MJETE TRANSPORTI MASIV

Linjat e rregullta të autobuzeve dhe minibusëve lidhin çdo ditë Durrësin me Tiranën, Elbasanin, Fierin, Korçën, Shkodrën, Vlorën, Sarandën, Mamurrasin, Librazhdin, Gramshin. Vendnisja ndodhet tek stacioni i trenit dhe pranë kryqëzimit të “Plepave”. Me autobus në Durrës mund të vini çdo ditë edhe nga Athina, Prishtina (Kosovë), Tetova dhe Kumanova (Maqedoni). Nga Durrësi nisja bëhet në zonën mes stacionit të trenit, “Rrotës së Kuqe” dhe “Plepave”. Në sezonin e verës, autobuzët që vijnë nga Kosova dhe Maqedonia janë më të shumtë dhe më të shpeshtë.

NEPERMJET TRENIT

Nga Durrësi mund të përdorni të gjitha linjat hekurudhore që ka vendi drejt Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Pogradecit. Megjithëse gjendja e hekurudhës është e vështirë, udhëtimi me tren mund të përbënte një përjetim të veçantë për shumë nga ju.

Durrësi është aktualisht qyteti dhe qendra më e rëndësishme turistike e Shqipërisë.

Përveç turizmit të banjave diellore Durrësi ka fituar tashmë rëndësi të madhe edhe për turizmin kulturor të orientuar drejt gjithë asaj pasurie historike dhe kulturore që ofron ky qytet. Kudo që të ecni nëpër pjesët e vjetra të qytetit ju do të hasni objekte të shumta arkeologjike që dëshmojnë lashtësinë dhe rëndësinë e qytetit. Amfiteatri romak dhe muri bizantin që rrethon pjesën perendimore të qytetit të vjetër janë dëshmitë më të mira që vërtetojnë lashtësinë e tij.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Përveç këtyre mund të shkoni të zbuloni “Bukuroshen e Durrësit” apo Rotondën historike, një forum i lashtë që nga koha bizantine me kolonat e saj madhështore. Statuja dhe mozaikë të tjerë të shumtë dhe të ndryshëm do t’ju shoqërojnë kudo nëpër rrugicat e ngushta të qytetit të vjetër të Durrësit. Për vendndodhjen e shumë prej tyre duhet madje dhe të pyesni pasi ato kanë mbetur pjesë integrale e ndërtimit të qytetit në të gjitha periudhat e tij, duke i dhënë kështu atij një tipar tepër origjinal.

Në tërësi qyteti i Durrësit përbën një ansambël shumë të rëndësishëm historik dhe kulturor të Shqipërisë.

Krahas objekteve të shumta arkeologjike qyteti i Durrësit ofron dhe shumë objekte të tjera historike dhe kulturore me rëndësi vizitonjëse. Ato gjenden të ekspozuara në muzeumet e ndryshme të qytetit, apo të veçuara në ndërtesat e vjetra të tij në formën e objekteve të kulturës popullore dhe veprave të artit.

Në majë të kodrës së qytetit mund të shihet pallati i mbretit Zog.



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

JETA E NATES

Jeta e natës gjallon kryesisht në bulevardin kryesor të qytetit, si dhe në zonën buzë detit. Gjatë stinës së verës bëhet vecanërisht aktive zona e plazhit dhe shetitorja“ Taulantja“, ku funksionojnë një sërë lokalesh nate, me muzikë live, disko etj .



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

CFARE MUND TE VIZITONI NE DURRES

Muzeu i ri arkeologjik u përrua me 13 Prill 2002 , me rreth 2000 objekte të gjetura dhe klasifikuara sipas kronologjisë së zhvillimit të qytetit që nga periudha arkaike deri në mesjetën e vonë. Ju do të keni kështu mundësinë të zhyteni në 3000 vjetet e historisë së qytetit .



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Nëntoka e Durrësit, duke qenë se qyteti aktual është i ngritur tërësisht mbi të vjetrin , është një burim i vazhdueshëm zbulimesh të reja dhe për këtë arsye është shpallur muze dhe mbrohet me ligj të vecantë .

Muzeu arkeologjik, përballë shëtitores kryesore te qytetit,e cila mban emrin “Taulantia”

Tel 05222253 Orari 08. 00 -15. 30

Amfiteatri (shek II e.s)

Eshtë ndër më të mëdhenjtë në botën antike. Boshti i gjatë i elipsit është 120 m, boshti i shkurtër 101 m ndërsa arena ka përmasa 61 x 42m. Mendohet të ketë patur një kapacitet prej 15 -20.000 spektatorë. Aktualisht është zbuluar rreth gjysma e tij, ku përfshihen shkallarja, disa galeri porta e madhe e hyrjes dhe një kapele e krishterë .



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES



Kapela e amfiteatrit

Eshtë ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit V, mesa duket për të strehuar një komunitet të vogël të krishterësh. Një nga veçoritë është prania e një prej mozaikëve të rrallë muralë (vertikalë) të zbuluar në Shqipëri .



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Termat

Termat e qytetit romak u ndërtuan në vitet e para të shek II p.k. Ato janë zbuluar në vendin ku sot ngrihet godina e teatrit “Aleksandër Moisiu”. Në ambientet e ruajtura dallohen: caldarium (dhoma me ujë të nxehtë 13 x 8m) si dhe pishina e shtruar me pllaka mermeri të bardha dhe të zeza si fushë shahu.



Ujësells i qytetit

I ndërtuar në kohën e sundimit të perandorit romak Hadrian (117-138) dhe i riparuar në periudhën e Alesandro Severit, është vepra më e madhe hidroteknike në peridhën antike në Shqipëri .Gjatësia e tij ishte 15 km, furnizohej nga Erzeni dhe shpërndarja e ujit bëhej me një sistem qyngjash prej plumbi të prodhuara nga vet ofiçina e Dyrrahut .

Gjurmët e ujësellsit mund ti shihni pranë shkollës Industriale-Durrës deri në afërsi të fshatit

Romanat, (Përroi i Gjokës).


PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Keshtjella e qytetit

Ndërtimi i fortifikimit lidhet me dëmtimet nga tërmeti në shek IV-V kur perandori Anastasi I organizoi rifortifikimin e kështjellës duke e bërë atë ndër më të fuqishmet në Ballkanin perendimor. Kështjella ka formën e nje trapezi me perimetër të mureve rrethuese 44 km, brenda të cilave përfshihej qyteti mesjetar me 120 ha .

Sipas historianes Ana Komnena, muri i Kështjellës së Durrësit ishte aq i gjërë, sa mbi të mund të ecnin pa vështirësi pesë kalorës.



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Torra veneciane

Ndodhet përballë portit dhe i përket shek XV. Bedenat, tek të cilat shkohet duke u ngjitur nga një shkallare e ndodhur në krahun e djathtë të hyrjes, kapin lartësinë 9.5m. Në pjesën e brendeshme, e cila ka tre kthina, është ndërtuar një bar mjaft i këndshëm.



Bazilika në Arapaj

Rrënojat e kësaj bazilike janë zbuluar në fshatin Arapaj, 6 km në lindje të qytetit. Bazilika ka përmasa 90x28m, tre absida, tre nefe dhe tre hyrje. Ndërtimi është bërë me muraturë të përzier (gurë, tulla dhe llac gëlqerorë). Në anën jugore të saj është punuar me gurë kubik polikron, një ndër mozaikët me të bukur të zbuluar në Shqipëri. Mozaiku ka përmasa 9x6m. Monumenti është ngritur në shekullin e VI dhe ka ruajtur funksionet e tij deri në shekullin XI.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Mozaiku i “Bukuroshes se Durresit”

Mozaiku i zbuluar në vitin 1916 në lagjen “Varosh”, i quajtur “Bukuroshja e Durrësit”, e ka marrë këtë emër nga përmbajtja e tij. Vepra i përket shek. IV p.e.s dhe është ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtarë në Tiranë.



Mozaiku i Orfeut

Ruhet në një banesë private të Lagjes Nr 9 të qytetit. Mozaiku duhet të jetë punuar aty nga fundi i shek. III p.e.s.

Muret e Porto Romanos.

Hamamin në oborrin e shkollës “16 Shtatori”.

Xhamia e Fathiut në qytetin e Durrësit.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Pusi i Top'Hanase ne L.Nr 1 te Rr. "A.Goga".



Festat lokale

Festa e Ditës së Verës (14 Mars)

Qytetarët shkëmbejnë urime dhe dhurata me bimë dhe lule të stinës. Mbas dreke organizohen shëtitje përgjatë kodrave ku ndizen edhe zjarre, ndërsa grupe fëmijësh bëjnë vizita nëpër shtëpi duke gostitur dhe uruar njëri tjetrin.

Festa e Detit (14 Maj)

Kjo festë shënon dhe hapjen e sezonit turistik për banjot e diellit. Pavaresisht nga moti, të gjithë i drejtohen plazheve të bregdetit. Nga Bashkia organizohen veprimtari të shumta kulturore-atistike dhe sportive.

Festa e Shën Mërisë (15 Gusht)

Banorët e qytetit apo fshatit, Kristian apo Muhamedanë mblidhen në Kishën e Shën Vlashit (fshati Rashbull). Aty organizohen lojra të ndryshme. Më pas të gjithë e kalojnë natën përjashta përreth zjarreve ose në mjediset e Manastirit.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

FIGURA TE PERMENDURA ME ORIGJINE NGA DURRESI.

Fituesi olimpik Kleosthen

Një epigram anonimë e përmend si fitues të lojrave olimpike t vitit 516 p.e.s.

Platon Graionin i Epidamit.

Poet dhe muzikant, fitues i një konkursi poetik në shek. e III p.e.s.

Filonid Dyrraheni (shek. II p.e.s)

Stefan Bizantini e përmend si dijetar dhe mjek të shquar i cili ka shkruar rreth 45 vepra mjeksore, të cilat gjendeshin në Bibliotekën e njohur të Durrësit që fatkeqësisht nuk janë ruajtur.

Anastasi I-Flavius Anastasius I (431-518)

Eshtë një nga personalitetet më të mëdha politike të periudhës së herëshme bizantine. Lindi në vitin 431 në Dyrrah. Nismëtari i një sërë ndërtimesh të mëdha në qytet, ku spikat Kështjella me murin rrethues mbi të cilin sipas historianes Ana Komnena, mund të kalëronin ballazi 4 kalorës njëherazi mbi kuajt e tyre. Ky Perandor ka ngelur i famshëm edhe për mjaft ndërtime jashtë Durrësit, sic është p.sh, rasti i Farit të Aleksandrisë në Egjipt, i njohur botërisht.

Gjoni i Epidamit (shek V i e.s)

Poet dhe gjykatës

Johan Kukuzeli (1270-ne gjysmen e pare te shek. XIV)

Në moshën 20 vjeçare ai shpallet mjeshtër i korit të oborrit perandorak në Kostandinopojë dhe arrin të fitojë titullin “Angelofonos” (Zëri i Engjëllit). Shpiku një sistem original muzikor me 40 simbole, i cili u përdor deri në shek XIX. Eshtë varrosur në malin Athos.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Andrea Aleksi-Andreas Alexius Dyrrahch-invs (1425-1506)

Arkitekt dhe skulptor i Rilindjes Dalmatine nga familja e Aleksëve në Durrës. Andrea Aleksi ka punuar si arkitekt në Durrës, në Katedralen e Shën Jakovit, Shën Jeronimit (Shibenik), në Kapelen e Shën Katerinës (Split) etj.

Leonik Tomeo (Gjysma e dyte e shek XVI)

Poet dhe astronom. Përkthyes i Aristotelit dhe një nga mësuesit e Nikola Kopernikut në Universitetin e Padovës. Tomeo që një ndër ata që hodhën poshtë sistemin gjeocentrik të Ptolemeut. Në përshkrimin e tij të meridianeve të tokës ai i jep meridianit të parë emrin e Durrësit.

Aleksander Moisiu (1879-1935)

Një ndër aktorët më të shquar të teatrit dhe kinematografisë në 10-vjeçarët e parë të shek.XX në Evropë. Emrin e tij e mban sot Teatri dhe Universiteti i qytetit të Durrësit

FESTIVALE

26 Prill- 2 Maj : “Poeteka”, festivali ndërkombëtar i poezisë, organizuar nga shoqata “Poeteka”.

Në mesin e Gushtit mbahet Festivali i Filmit

Në mesin e Shtatorit, në Durrës zhvillohet festivali ndërkombëtar i Jazz-folk-ut.

Tradita Shqiptare e Folkut.

Në qytetin e Durrësit organizohen shpesh aktivitete të folkut shqiptar. Megjithëse për to nuk ka data të fiksuara gjatë vitit, mund të informoheni pranë qendrës kulturore të Bashkisë së qytetit, si dhe nga reklama të ndryshme që bëhen për këto aktivitete.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

MIRESEVINI NE DURRES

Veshjet popullore dhe Muzeumet etnografike.

Ashtu si çdo zonë tjetër e Shqipërisë edhe Durrësi dallohet për veshjet e tij popullore. Ato mund t'i shikoni gjatë aktiviteteve të ndryshme të muzikës dhe kulturës popullore, në ditët e dasmave etj. Për to në qytet funksionon edhe një muze etnografik, i cili ia vlen të vizitohet.

Muzeu i Kulturës Popullore, Rr.”Koloneli Tomson”, ish shtëpia e Aleksandër Moisiut.

ORARI: 08.00-14.00 ne sezonin e dimrit 08.00-16.00 ne sezonin e veres

SHOPING-BLERJE

Vendet më të mira për blerje janë bulevardi kryesor i qytetit të Durrësit, ku në të dy anët e tij do të gjeni dyqanet e mbushura me të gjitha llojet e mallrave dhe shërbimeve, si dhe qendrat tregtare ”Galaktik” në hyrje të Durrësit, “Blu Star” dhe “Flag Ship” në rrugën ”Skënderbej”. Gjithashtu zonë e rëndësishme blerjesh, veçanërisht gjatë sezonit të verës është dhe ajo e plazhit, nga mbikalimi i autostradës për Tiranë deri tek Plepat

MENYRA E LEVIZJES NE QYTET DHE RRETHINA

Përveç makinës suaj apo taksive, ju mund të përdorni edhe linjat e autobuzit brenda qytetit dhe ato me destinacion rrethinat e Durrësit.

-Linja e plazhit: Durrës-Plazh-Plepa, përshkon gjithë plazhin e Durrësit deri tek kryqëzimi i Plepave.

-Linja e Shkozetit.Nisja: përballë Pallatit të Sportit.

-Linja e Shijakut. Nisja: tek ish “Goma e vjetër”

-Linja e Portoromanos: Nisja nga Posta Qendrore.

PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

NDARJA ADMINISTRATIVE

Qyteti i Durrësit, zë një sipërfaqe prej 46.1 km² dhe një popullsi prej 214.559 banorë.

Nga pikëpamja administrative, është organizuar në 6 njësi administrative, të emëruara në Rajone Administrative, të cilat kanë popullsi dhe sipërfaqe sipas tabelës së mëposhtme:

HARTA E QYTETIT TË DURRESIT NDARE SIPAS NJESIVE ADMINISTRATIVE



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

NDARJA ADMINISTRATIVE

Emërtimi	Rajoni Nr 1	Rajoni Nr 2	Rajoni Nr 3	Rajoni Nr 4	Rajoni Nr 5	Rajoni Nr 6
Sipërfaqja km2	2.98	1	0.6	10.32	15.8	15.4
Popullsia	29180	29589	28263	54852	36072	36594

Lagjet që përfshihen në çdo Njësi Administrative apo Rajon janë:

Rajoni 1 lagjet 1, 2, 3, 4

Rajoni 2 lagjet 6, 7, 9, 10, 11

Rajoni 3 lagjet 5, 12, 16

Rajoni 4 lagjet 8, 15, 18

Rajoni 5 lagjet 17, 13, 14

Rajoni 6 lagjet pjesë nga Rajoni 5, 4, 3

Ndër rajonet që kanë zona informale me sipërfaqe dhe popullsi të konsiderueshme janë rajoni 4,5 dhe 6.

Bazuar në ligjin Nr. 115/2014 dt. 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkisë së Durrësit iu bashkëngjiten dhe 5 Bashki të tjera si :

- Bashkia Manëz
- Bashkia Sukth
- Komuna Ishëm
- Komuna Katundi i Ri
- Komuna Rrashbull


PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

NDARJA ADMINISTRATIVE

Bashkia e Durrësit, sipas kësaj ndarje territoriale, nga një sipërfaqe prej 46.1 km² dhe një popullsie prej 214.559 banorë si qytet, është zgjeruar në një sipërfaqe prej 341.9 km² dhe një popullsie prej 309.190 banorë.

HARTA E BASHKISË SË DURRESIT NDARE SIPAS NDARJES

ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE



PROFILI I QYTETIT TE DURRESIT

NDARJA ADMINISTRATIVE

Bashkia Durrës shtrihet nga Kepi i Rodonit në veriperëndim deri tek Përroi i Agait pas Shkëmbit të Kavajës në jugperëndim. Ajo kufizohet me Bashkinë Kurbin në veri, me Bashkinë Krujë, Vorë dhe Shijak në lindje si dhe me Bashkitë Tiranë dhe Kavajë në jug dhe juglindje.

Bashkia e Durrësit është pjesë e Qarkut të Durrësit dhe përbëhet nga 6 Njësi Administrative: Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz. Në përbërje të tyre këto Njësi Administrative, përfshijnë 3 qytete dhe 40 fshatra si dhe 6 Rajone për Durrësin.

Më poshtë, po pasqyrojmë tabelën e Bashkisë së Durrësit, të organizuar në qytetet dhe fshatrat, sipas ndarjes së re administrative-territoriale:


Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë Administat. përkatëse	Qytetet dhe fshatrat përkatës	Bashkitë kufitare
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës: 6 Rajone Administrative	Vorë Shijak Kavajë Kurbin Krujë
		Sukth	Qyteti Sukth: Fshatrat: Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rrushkull, Hidrovori.	
		Ishëm	Fshatrat: Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Lalëz, Gjericaj, Kuraten, Bizë, Drac, Shetaj.	
		Katundi Ri	Fshatrat: Katund i Ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Rinia, Bisht-Kamëz, Erzen, Sukth, Adriatik.	
		Rrashbull	Fshatrat: Rrashbull, Arapaj, ShenaVlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bonzanxhije, Xhafzotaj.	
		Manëz	Qyteti Manëz: Fshatrat: Armath, Borc, Hamallaj, Kameronas, Radë, Shkallë, Fshat Manëz.	

Ndarja Administra

tive, sipas sipërfaqeve dhe popullsisë për Bashkinë e Durrësit paraqitet:

Emërtimi	Durrës	Sukth	Ishëm	Katundi Ri	Rrashbull	Manëz	Bashkia Durrës
Sipërfaqja km2	46.1	51.9	92.9	50.0	56.1	44.9	341.9
Popullsia	214.559	27.841	8.938	15.896	30.212	11.744	309.190

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT



Cili është vizioni dhe objektivi ynë këto 4 vitet e ardhshme (2011-2015)?

Vizioni ynë është ai i një zhvillimi të qëndrueshëm të Qytetit të Durrësit.

Objektivi ynë është t'a bëjmë Durrësin qendrën më të rëndësishme turistike në rajonin tonë.

Cfarë nënkupton zhvillim i qëndrueshëm dhe si e kemi aplikuar ne?

Zhvillim i qëndrueshëm nënkupton ndërrthurjen e sektorëve të ndryshëm të jetës së një qyteti dhe zhvillimin e njëtrajtshëm të tyre. Imagjinoni për një sekond se si mund të zhvillohej turizmi po të mos kemi një mjedis të mbrojtur por të kemi ndotjen e oxhaqeve, si mund të zhvillohet ekonomia po nuk patëm njerëz të arsimuar e të shëndetshëm, si mund të zhvillohen si ekonomia dhe turizmi nëse nuk investohet në infrastrukturë dhe në rekuperimin e shesheve dhe shetitoreve kryesore të qytetit.

PLANIFIKIMI URBAN

Për t'i dhënë jetë të re një qyteti si fillim duhet të luftosh kundër copëzimit të funksioneve në të. Këtë do ta arrijmë duke lidhur hapësirat dhe njerëzit me një vizion global, nga konteksti i lagjes në atë të qytetit, do të vazhdojmë ndërtimin e një qyteti me gjallëri e lëvizje. Për këtë do të punojmë për rigjenerimin e zonave mikse të cilat kanë një degradim urban. Ky do të jetë një

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

rigjenerim shumë planësh, me një mënyrë të menduari në sens global: në fushën sociale, ekonomike, mjedisore, të strehimit, të tëra këto të planifikuara si një e tërë, plotësuese të njëra tjetrës dhe bashkohore.

Rigjenerimi urban i zonës së Shkozetit. Zona ish – industriale e Shkozetit tani është një miksbanim dhe industri. Plani jonë për këtë zonë është ta kthejmë në një lagje ku të kombinohen mirë kushtet rezidenciale me aktivitetet e prodhimit jo ndotës dhe të shërbimit, kjo edhe nëpërmjet rinovimit dhe ripërdorimit të zonave dhe ndërtesave të braktisura. Kemi një plan strategjik për një zonë me sipërfaqe 100 ha, e cila do të ri-integrohet me rrjetin urban. Kjo zonë do të shpëtojë në vetvete banesa dhe njësi të vogla prodhimi (ndërmarrje në nivel familjar). Të gjitha aktivitetet e sektorit sekondar, të shpërndara në të gjithë qytetin, por kryesisht në Shkozë, do të vendosen në Parkun Industrial, pra ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të zëvendësohen nga ndërmarrje mikro-familjare.

Rigjenerimi urban i zonës së “Durrësit të Ri” (ish-Kënetës). “ Durrësi i Ri” është një zonë rezidenciale me popullsi të re dinamike, një zonë që ka nevojë për rinovim urban. Gjatë 4 viteve të ardhshme, ky rinovim do të jetë i plotë. Me projektet tona për rehabilitimin e infrastrukturës, si: “Ndërtimi i Sistemit të Furnizimit me Ujë”, “Rehabilitimi i Sistemit të Kanaleve të vjetra” duke i kthyer ato në rrugë të mirfillta, kjo zonë e re e qytetit do të ndërthuret me pjesën tjetër të qytetit, duke u bërë një trup i vetëm me sistemin e infrastrukturës së tij.

Rikuperimi dhe rijetëzimi i qendrës historike të qytetit. Në katër vitet e ardhshme do t’ju ofrojmë një qytet me një mjedis urban akoma më cilësor, duke kontribuar në ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë tonë kulturore. Këtë e kemi planifikuar ta bëjmë sipas një strategjie hap pas hapi si më poshtë:

- Realizimi i një inventari të detajuar të trashëgimisë arkitektonike të qendrës së qytetit;
- Promovimi i Restaurimit të Integruar, ku, përveç aspekteve urbane dhe vlerave arkitektonike, të merren parasysh edhe aspektet ekonomike dhe shoqërore të trashëgimisë kulturore;

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRËSIT

- Vlerësimi i duhur i ndërtesave të trashëgimisë kulturore dhe potencialeve të zhvillimit për të bërë integrimin e tyre në sektorin e turizmit;
- Nxitja e pronarëve në rehabilitimin e shtëpive në zonën në fjalë, duke kontribuar kështu rigjallërimin fizik të qendrës historike;
- Përdorimin dhe përfshirja e gjurmëve arkeologjike si: Amfiteatri Romak, Rotonda, Torra Veneciane dhe gjurmët e tjera arkeologjike, në aktiviteteve sociale-kulturore dhe tregtare, duke bërë kështu promovimin e tyre më të mirë;
- Krijimin e zonave, shesheve këmbësore, duke nxitur si qytetarët, ashtu edhe turistët, të zgjedhin qendrën historike për të kaluar pjesë të kohës së lirë.

Integrimi i zonave të reja rezidenciale me zonat e vjetra në Porto Romano. Ky është programi ynë për të lidhur zonat e reja rezidenciale në faqen lindore kodrinore dhe zonën e vjetër të Porto Romano-s: Ndërtimi i Unazës së Re të Qytetit të Durrësit, duke përcaktuar kështu një lagje rezidenciale lineare me të gjitha standartet europiane. Projekti ynë i Unazës së Re të Qytetit ka për qëllim të kufizojë trafikun e automjeteve të rënda dhe një pjesë të trafikut të automjeteve private në zonën qendrore të Durrësit, që rrethon zonën kryesore të banimit në qytet. Unaza shtrihet në pjesën veriore të qytetit, përfshin zonën e Durrësit të Ri dhe shkon drejt zonës industriale të Porto Romanos. Pra, praktikisht do të krijohen dy unaza: njëra lidh zonën e Durrësit të Ri me zonën urbane tradicionale të qytetit të Durrësit dhe pjesa tjetër lidh Durrësin e Ri me zonën e re industriale në Porto Romano. Ky projekt parashikon katër korsi lëvizjeje të mjeteve motorike dhe dy korsi për transportin publik, një për çdo drejtim.

Studim fizibiliteti dhe reabilitim urban i zonës së plazhit. Plazhi i Durrësit dhe i Currilave përbëjnë zonat kryesore çlodhëse të qytetit. Disa nga këto zona janë të cënuara nga rreziqet e shkarjes së tokës nga erozionet e ashpëra si rezultat i shpyllëzimit dhe zhvillimit të pakontrolluar të ndërtimit, veçanërisht në kodrat afër plazhit. Për këtë arsye është hartuar një projekt i detajuar, “Rinatyalizimi i Kodër-Vilës, “Brezit të gjelbër të qytetit”, i cili synon të rinatyalizojë pjesën e kodrës pranë plazhit, për të shmangur erozionin e mëtejshëm. Kjo ndërhyrje do të na sjellë si përmirësimin e cilësisë së ujrave nëntokësore ashtu dhe përmirësimin fizik dhe social të mjedisit në Durrës.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

Zona bregdetare mes Portit dhe Kavajës. Për këtë kemi gati për procedurat e zbatimit projektet e ndërtimit të pjesës më të madhe të infrastrukturës sekondare të kësaj zone të qytetit, zonë e cila do të ruajë prioritetin për ndërtimin e banesave. Që bregu i detit të jetë lehtësisht i arritshëm nga të gjithë qytetarët, bulevardet këmbësore do të zgjaten deri në zonën e shëtitores në veri dhe në jug të qytetit të Durrësit, si drejt zonës së Currilave ashtu dhe drejt plazhit të Plepave.

Rikualifikim i zonës pranë Portit. Sot kemi një port industrial në mes të qendrës së qytetit, në afërsi të qendrës historike. Prania e portit në qendër të qytetit është një problem të cilin ne duam ta menaxhojmë nëpërmjet projekteve. Këtë do ta arrijmë duke ripërkufizuar marrëdhënien qytet-port. Kjo ka të bëjë me një taksë të cilën Autoriteti Portual duhet t’ia paguajë qytetit mbi ndikimin në mjedis dhe infrastrukturë nga funksionimi i aktiviteteve të ndryshme në të. Vjelja e kësaj takse do të shkojë vetëm për Mjedisin dhe Infrastrukturën në qytet .

Projekti i rrugës **“Mars 91”**, rruga me parametra bashkohorë që ecën paralel me murin rrethues të portit, ka nisur të jetojë që në mars të vitit 2011. Kjo rrugë dhe rijetëzimi i zonës së qytetit paralel me të, do të jetë për ne fytyra e denjë e prezantimit të Durrësit për të gjithë pasagjerët që kalojnë nëpërmjet portit të pasagjerëve. Projekti ynë ambicioz **“Vija e kaltër”** gjithashtu do të rivendosë lidhjen qytet-det të munguar deri më sot në Durrës. Zona portuale do të jetë destinacioni për turistë të shumtë në të ardhmen, me një port me funksion turistik, zonë pushimi dhe vend për zhvillimin e eventeve të ndryshme kulturore. Porti ekzistues tregtar do të zhvendoset në Porto Romano, në mënyrë që Durrësi, si një qytet port europian, të presë varka me vela, jahte, anije të mëdha udhëtarësh dhe varka private sportive, duke krijuar një zonë turistike, për t’i rikthyer qytetit një karakter vërtetë bregdetar.

Portit i peshkimit duhet të ndërthuret me Portin Turistik, ku cdo element i tij të jetë i mirëprojektuar dhe i detajuar në funksion të Turizmit dhe qytetit.

Rinovimi dhe rivitalizimi i zonës ekzistuese të vjetëruar të portit tregtar, terminali i autobusëve dhe stacioni hekurudhor, projekt ky në realizim e sipër nga Bashkia e Durrësit, do ta kthejnë Durrësin në një qytet modern dhe me një port me platformë të integruar.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

INFRASTRUKTURA

Zhvillimi i infrastrukturës së këtij qyteti synon në mbrojtjen e vlerave antike dhe historinë që mbart ky qytet duke projektuar një qytet të ri të zhveshur nga barrierat, duke synuar bashkimin e periferive të qytetit “Durrësi i Ri”, si dhe kthimin e hapsirave të gjelbërta për çdo qytetar.

Vizioni i Bashkisë së Durrësit për katër vitet e ardhshme konsiston në vazhdimin e investimeve për përmirësimin e jetës së çdo qytetari duke synuar përfshirjen e tyre në vendimarrje si dhe duke rritur facilitetet në qytet. Ne do të zbatojmë me përpikmëri Projektin: “ Vija e Kaltër” i cili synon krijimin e infrastrukturës moderne të portit turistik si dhe konfirmon integrimin e plotë të Bashkisë së Durrësit në sistemin e transportit ndër-rajonal duke favorizuar zhvillimin e portit si hyrja kryesore në Korridorin e VIII-të.

Investimet në fushën e transportit duke siguruar mirëmbajtjen e rrugëve egzistuese si dhe projektimin, ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrugëve të reja të qytetit të Durrësit. Gjithashtu ne do të synojmë të përmirësojmë mobilitetin e brendshëm të qytetit në përputhje me zhvillimin industrial “infrastrukturën e transportit”. Projektet për rikonstruksionin e shesheve, hapësirave publike, shëtitoreve dhe rrugëve karakteristike të qytetit do të zbatojnë parimet e një zhvillimi të qëndrueshëm në respekt të elementeve mjedisore në përfitimin e energjisë duke përdorur vetëm burime të rinovueshme dhe duke ndikuar në kursimin e energjisë. Bashkia e Durrësit do të punojë për të përfunduar projektin për ndriçimin e çdo sheshi, rrugë, hapsirë publike si dhe do të jetë pjesë e nismave Globale mbi kursimin e energjisë “ Ora e Tokës“ nismë e cila në vitet në vijim do të kërkojë ndërgjegjësimin dhe gjithë përfshirjen e qytetarëve në qytet .

ZHVILLIMI LOKAL EKONOMIK

Bashkia Durrës udhëhiqet nga parimet themeltare të zhvillimit ekonomik, ku ka balancuar rritjen ekonomike me cilësinë e jetës, me kërkesat sociale dhe mjedisore.

Planifikimi strategjik ka qenë një proces gjithëpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar. Përmirësimi i ambjentit të biznesit në përgjithësi ka qenë shenjestruar nga Bashkia, mbrojtja dhe përkrahja e bizneseve ekzistuese ka qenë po aq e rëndësishme sa tërheqja e bizneseve të reja, sepse ato veprojnë si një mjet shumë i mirë marketingu për nxitjen e klimës së biznesit.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

Më konkretisht një pjesë e projekteve që do të zhvillohen këto 4 vite do të jenë :

- **Projekti: “Të bësh biznes ”,** ka për qëllim rritjen e aftësive konkurruese dhe investimeve private në territorin e Bashkisë Durrës .
Konsiston në uljen e kostove dhe kohës së kërkuar për zbatimin e procedurave administrative që lidhen me bizneset, përmirësimin e kapacitetve të organeve qeverisëse lokale për të menaxhuar të gjitha procedurat administrative.
- Projekti “ **Igovernment** ” është një projekt që ka përfshirë sektorin publik dhe privat në qytetin e Durrësit. Konsiston në ndërtimin dhe menaxhimin e sistemit të kontabilitetit në krijimin e një sistemi të menaxhimit të taksave vendore dhe përmirësimin e një shërbimi nga këndvështrimi qytetar në një “One-Stop-Shop” të një teknologjie të lartë duke përdorur kanale të reja komunikimi për qytetarët dhe bizneset .
- **Zona Industriale.** Mbështetje dhe vendosje e parkut industrial me infrastrukturën dhe shërbimet e duhura të cilat të kenë të bëjnë me industrinë e lehtë dhe fason dhe jo me industri te cilat çënojnë progresin turistik të qytetit, si orientim kryesor ekonomik i tij.
- **Platforma e Integrimit të Qytetit me Portin.** Bashkia Durrës do të inkurajojë një integrim midis qytetit dhe portit nëpërmjet përmirësimit të qeverisjes dhe implementimit të ndërhyrjeve fizike dhe manaxhimit.
- **MARINA, promotor i zhvillimit lokal.** Duke iu referuar një zhvillimi të qëndrueshëm të Marinës në Mesdhe, ajo ka një ndikim kryesor për zhvillimin lokal dhe rajonal dhe ka përgjegjësinë për krijimin e një modeli të suksesshëm dhe të qëndrueshëm. MARINA ka një ndikim shumë të madh në ekonominë e lokalitetit dhe të banorëve të tij. Lundrimi european është i organizuar si një komunitet, dhe Marina Durrës do të jetë pjesë e turizmit ndërkombëtar detar.
- **Koordinimi me autoritetet portuale.** Ngritja e një tabele permanente pajtimi midis autoriteteve portuale, institucionet administrative të hapura ndaj pjesëmarrjes publike për të zhvilluar dhe konsoliduar një qeverisje më të mirë mbi marrëdhënien qytet – port.
- **Zhvillimi i Zonës së Shkozetit.** Promovim i një zhvillimi të integruar të paisjeve dhe shërbimeve që lidhen me funksionet e logjistikës dhe transportit.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

- **Mbështetje Ndërrmarjeve të Vogla e të Mesme (NVM).** Mbështetje dhe vendosje e NVM-ve nëpërmjet masave të asistencës teknike (qendra trajnimi, facilitete, teknologji informacioni, inkubatorë biznesi)
- **Hapsira tregtare.** Sigurim i tregjeve si dhe zonave për qendra tregëtare dhe biznesi.
- **Teknologjia e informacionit në shërbim të biznesit.** Zhvillim i teknologjisë së informacionit. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për shtrirjen e rrjetit telefonik dhe informatik nga operatorët e ndryshëm.
- **Inkubatorët e biznesit.** Brënda Parkut Industrial dhe zonës së Shkozetit do të zhvillohen inkubatorët e bizneseve në bashkpunim me Universitetin e Durrësit.
- **Integrimi i zonës industriale me atë urbane.** Promovim i integritit fizik dhe funksional midis vendbanimeve ekzistuese rezidenciale informale dhe parkut të ri industrial.

TURIZMI

Turizmi, intersektohet me mjedisin, zhvillimin ekonomik, shërbimet, tregtinë, transportin, rendin, qetësinë publike, ndërtimet si dhe ruajtjen e vijës bregdetare prej 6 Km.

Edhe për këto 4 vitet e ardhëshme, Turizmi do të jetë një ndër prioritetet e Bashkisë.

Performanca e turizmit dhe përmirësimi i shërbimeve e mbështetur nga politikat e ndjekura të Bashkisë Durrës, e vendos atë në vendin e parë të listës së kontribuesve të produktit turistik shqiptar.

Durrësi ka hyrë tashmë në destinacionet turistike të Europës, me promovimin e Turizmit në Panairët më të rëndësishme Ndërkombëtare si: Panairin Ndërkombëtar “BIT” (Borsa Internazionale del Turismo) në Milano, Panairin “ ITB” në Berlin, Panairin “ World Travel Market” ExCel në Londër .

Për të përmirësuar promocionin turistik do të vazhdojmë të krijojmë guida turistike për trashgiminë arkeologjike, etnografike dhe kulturore të qytetit të Durrësit, do të rritet mundësia e financimit për projektet për Turizmin.

Bashkia Durrës mori pjesë suksesshëm në Programin IPA CBC 2007 -2013 , ku nga 8 projekte të aplikuara si partnerë ndërkombëtarë , 2 prej tyre kanë kaluar fazën finale dhe pritet marrëveshja e

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

bashkëpunimit për këto projekte në fushën e Turizmit dhe atë të mjedisit. Së shpejti fillon zbatimi i projekteve jo vetëm me rëndësi lokale por edhe Kombëtare dhe aq më tepër Rajonale .

Hartimi i Planit Rregullues të qytetit i ka dhënë prioritet Turizmit me planifikimin e ndërtimit të Portit Turistik dhe ndërthurjen e Rikualifikimit të Vijës Bregdetare të qytetit dhe hapjen e plazheve të reja në veri të qytetit drejt zonës së Kallmit.

Nisëm një “Epokë të re Urbane,, për qytetin me Planin e Ri Rregullues, me Rijetëzimin e “Sheshit Liria ,, me zbatimin e një programi rikualifikimi për rikthimin e hapësirave publike dhe krijimin e një qyteti policentral. Këto kulmojnë me Studimin e vijës bregdetare, projekt të cilin e kemi emërtuar “ Vija e Kaltër ,, e Durrësit.

Qyteti i jetës më të mirë dhe jetesës pranë detit konsolidohet me zbatimin e projektit “ Vija e kaltër ”, me zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm nga krijimi i një infrastrukture moderne të Portit Turistik, Shëtitoria“Taulantja-Zona Brryl-Curila,, deri tek zhvillimi i turizmit elitari në Kallm, zonën më të paprekur natyrore të Durrësit

Ky studim do ta bëjë Durrësin të përkufizohet si:

- porta drejt perëndimit
- qyteti i jetesës më të mirë dhe jetesës pranë detit
- qyteti i trashëgimisë kulturore.

Durrësit, “ Porta e Ballkanit dhe e Korridorit të Tetë ,, , i mungon një Port Turistik. Porti Turistik, Porti i Jahteve dhe “Vija e Kaltër“ e qytetit do të nxjerrin më në pah vitalitetin dhe identitetin e durrsakëve, duke i kthyer tiparin detar të munguar në gjithë këto vite.

Një “Trajektore e re turistike” parashikohet me Rijetëzimin e “ Qendrës historike ” të qytetit, duke krijuar një rrjet me monumente të trashëgimisë kulturore dhe historike, nga Torra Veneciane, Amfiteatri Romak dhe Forumi Bizantin ” .

Plazhi i Currilave do t’u kthehet durrsakëve, duke përfutur prej 1.5 Km vijë bregdetare plot 127.000 m² plazhe publike më shumë nga mbushja artificiale e detit.

KUJDESI SOCIAL

Prioritetet e Bashkisë në fushën e programeve sociale sipas grupeve në nevojë janë:

Zvoglimi i nivelit të varfërisë me:

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

- Rritje të familjeve për t'u përkrahur në skemën e ndihmës ekonomike deri në 200 familje.
- Reduktimi i numërit të të pastrehëve.
- Strehimi i 343 familjeve në nevojë, në banesat sociale, të përfunduara me investime të Bashkisë.
- Rritja e mundësive për punësim të grupeve vulnerabel.
- Asistencë dhe stimulim për bizneset private që punësojnë P.A.K, antarë nga familje të skemës ekonomike ose nga komuniteti rom.
- Pagesa e kurseve profesionale për grupet në nevojë, trajnime për 100 të rinj.
- Rritja e numrit të individëve të punësuar në programet e punës komunitare dhe punësimi sezonal, 200 të punësuar më shumë.

Zgjerimi i shërbimeve sociale për grupet në nevojë:

- Ngritja e një qendre ditore të rehabilitimit psiko-fizik për fëmijët e abuzuar dhe të dhunuar, në ambjentet e banesave sociale, me një kapacitet 100 fëmijë.
- Parandalimi i trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijeve, për lypësi dhe punë, si dhe mbrojtja dhe ri-integrimi i viktimave nëpërmjet sistemit të referimit.
- Ngritja dhe fuqizimi i shërbimeve alternative për fëmijët që nuk u krijohen kushtet e nevojshme në familjet biologjike, si shërbimi i kujdestarisë, mbështetja ekonomike e të afërmëve që kujdesen për fëmijë jetimë, familjet pritëse dhe birësuese, shërbime të tipit shtëpi familje.
- Hartimi i Strategjisë Lokale, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 2011-2015
- Ngritja e një qendre pritëse dhe riintegruese për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe viktimave të trafikimit, në ambjentet e banesave sociale, me një kapacitet 50 gra. Rritja e fondit të vecantë të alokuar për gratë kryefamiljare.
- Vazhdimi i projektit me UNDP për dhunën në familje, rritja e numrit të grave përfituese nga ky projekt.
- Dyfishimi i numërit të grave që do të përfitojnë vizita mjeksore falas, në kuadër të projekteve të Bashkisë me spitale prestigjoze.
- Stimulimi i bizneseve për rritjen e numrit të grave të punësuar.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

Personat me aftësi të kufizuar (P.A.K)

Nxitjen e punësimit të P.A.K, duke i mbështetur punëdhënësit me fonde dhe subvencione për përshtatjen e vendit të punës si dhe garantimin e punësimit afatgjatë, etj. Krijimin e shërbimeve në familje, **40 asistente**, për një mbështetje të mjaftueshme psiko-sociale për P.A.K dhe familjet e tyre. Ngritjen e një qendre ditore multifunksionale për rehabilitimin e P.A.K. Përshtatshmërinë e të gjithë ambjenteve dhe ndërtesave publike për t'u siguruar P.A.K një jetesë të pavarur. Transport i përshtatur falas për P.A.K.

Komuniteti rom

Ngritjen e një qendre komunitare që do të ofrojë shërbime psiko-sociale për këtë komunitet, në ambjentet e “Shtëpisë së Foshnjës” Shkozë, me kapacitet 50 përfitues. Nxitjen dhe zhvillimin e bizneseve familjare, nëpërmjet lehtësirave ekonomike dhe sociale. Rritjen e numrit të punësuarve në programet e punës komunitare 50 të punësuar cdo vit.

Të rinjtë

Aftësimi për punësimin e të rinjëve nëpërmjet një projekti me Bankën Botërore **“Fuqizimi i të rinjve nëpërmjet zhvillimit të komunitetit”**, duke informuar të rinjtë rreth kërkesave të tregut të punës, si dhe duke ofruar trajnime të licensuara falas për 100 të rinj sipas nevojave të tyre. Argëtimin dhe aktivitetet psiko- sociale për të rinjtë, duke ngritur një qendër rinore, projekt i Shërbimeve Sociale të Bashkisë Durrës, në ambjentet e qendrës së formimit profesional me kapacitet rreth 1000 të rinj.

Mosha e tretë

Të zgjerojmë rrjetin e shërbimeve, dhe stafin e qendrës ditore të të Moshuarve, duke u fokusuar tek shërbimi në familje për këtë grup moshe. Të rrisë kapacitetin e ambjenteve të qendrës ditore të të moshuarve në 140 përfitues, në mënyrë që të përmbushë sa më mirë nevojat e këtij target grupi. Të sigurojmë transportin urban falas për përfituesit e qendrës ditore të moshuarve.

ARSIMI

Arsimi është një dimension i rëndësishëm në vizionin drejtues të qytetit të Durrësit. Motoja jonë është **“Të investojmë sot për një të ardhme më të sigurt nesër”**.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

Në vizionin tonë 2011-2015 do të vazhdojmë të rikonstruktojmë dhe ndërtojmë institucione arsimore.

- Do të ndërtohen 2 shkolla të reja të ciklit 9-vjecar në qytet
- Ndërtimi i 3cerdheve dhe 3 kopshteve me ushqim, në Plazh, në Durrësin e Ri (ish-kënetë) dhe në Spitallë.
- Ndërtimi i 2 shkollave të reja në qytet, “M. Kaculini dhe J.Puka”.

Universiteti i Durrësit “ Aleksandër Moisiu ”i shton vlerat këtij qyteti. Ne e konsiderojmë këtë Institucion Akademik një partner të rëndësishëm në zhvillimin e qytetit . Kemi krijuar urën e komunikimit dhe bashkëpunimit në nivel akademik, duke i hapur dyert për praktika profesionale studentëve në Institucionin tonë në bazë të kurikulave Universitare. Do të krijojmë lidhje me struktura të tjera të punësimit dhe biznese që operojnë në qytetin tonë për të rinjtë që diplomohen në këtë Universitet, të aftë për tregun Kombëtar dhe Ndërkombëtar të punës, sepse motoja jonë ka qenë dhe do të jetë **“Njerëzit realizojnë ndryshimin”**.

Për t’ju shërbyer të gjithëve , kemi gati projektin **“Biblioteka e re e qytetit”**. Ajo do të funksionojë si një qendër multifunksionale, me kinema, bibliotekë dhe qendra të formimit profesional . Kjo bibliotekë do të shërbejë si një qendër e rëndësishme kulturore e qytetit .

Do të ngremë “fondin e ekselencës” për studentet me rezultate të larta duke mbështetur të rinjtë e shkëqyer në studime.

Stafi akademik dhe studentë me rezultate të mira do të përfshihen në raporte ose studime të projekteve të ndryshme të Bashkisë në nivel lokal ose ato në Nivel Rajonal sic mund të përmendim këtu edhe projektet që do të financohen nga Bashkimi Europian , IPA Cross Border Cooperation 2007-2013 .

MJEDISI

Durrësi është qyteti i frontit ujor të Adriaktikut dhe forca e tij duhet të mbahet nga Master Plani i ri duke propozuar masa të përshtatshme planifikimi për tu zhvilluar në harmoni ekologjike me tokën dhe detin. Master Plani i Durrësit do të sigurojë një propozim për një manaxhim më të mirë të bregut në lidhje me ndërtimin, ripërtëritien e bregut, parqeve publike dhe shërbimet.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

Sipërfaqet e gjelbërta janë rritur ndjeshëm me 40 % në qytet dhe synohet të dyfishojmë sipërfaqet e gjelbërta gjatë katër viteve të ardhshme.

Vizioni i Bashkisë së Durrësit për vitet e ardhshme do të synojë në zhvillimin e hapsirave të gjelbëruara, përmirësimin e mbledhjeve të mbeturinave, klasifikimin, transportimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane. Gjithashtu ne do të monitorojmë ndotjen e ajrit në mjedis duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë me subjektet të cilat kanë ndikim në ndotjen e mjedisit. Parandalimi i ndotjes së ajrit do të jetë një detyrim ndaj çdo banori të qytetit tonë.

Lehtësimi i efekteve urbane dhe mjedisore. Facilitojë integrimin e sistemeve të mobilitetit dhe logjistikës të qytetit, nëpërmjet kompensimit dhe lehtësimit të efekteve urbane dhe mjedisore.

Projekt i monitorimit të ndotjes së ajrit dhe mjedisit. Promovim i një studimi fisibiliteti në lidhje me kushtet e mjedisit të zonës urbane që kryqëzohet me autostradën dhe rrugë të tjera kryesore. Për shkak të kryqëzimit të shumë rrugëve kombëtare në qytetin e Durrësit, është i nevojshëm një projekt i monitorimit të ndotjes së ajrit dhe mjedisit. Një projekt i tillë duhet të përfshihet në monitorim më të gjërë në shkallë urbane të ndotjes së ajrit. Bashkia e Durrësit do të punojë për hartimin e një rregullore të re për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në qytet. Një Strategji e re e Mjedisit do të fillojë të përpunohet së shpejti .

Mbrojtja e peisazheve. Bashkia do të mbështesë aktivitetet për ndërtimin e godinave Institucionale, për të harmonizuar normat kombëtare me standartet e Bashkimit European për mbrojtjen e peisazhit.

Gjelbërimi i kopshteve, qendrave të edukimit, ndërtesave Publike. Sigurimi i masave të përshtatshme për mbajtjen e kriterëve mjedisore përreth shkollave, kopshteve, qendrave të edukimit dhe ndërtesave publike. Bashkia e Durrësit ka planifikuar mbjelljen e 6000 pemëve në vitet në vijim, duke synuar të dyfishojë edhe hapsirat e gjelbërta në qytet. Një nga prioritetet e Bashkisë së Durrësit do të jetë dhe ndërtimi i një brezi të gjelbër përgjatë rrugës paralel me Portin gjatë ndërtimit të rrugës të re “ **Mars 91**”.

PROFILI I ZHVILLIMIT TË QYTETIT TË DURRESIT

Ri-natyrizimi i brezit të gjelbër të Kodër –Vilës për të shmangur erozionin e tokës është një tjetër projekt i rëndësishëm që pret zbatimin këto katër vite .

Ripërtëritjen e mjedisit në Porto Romano. Bashkia e Durrësit ka në program të saj ripërtëritjen e mjedisit në Porto Romano, e cila synon në gjelbërimin e zonës së “ Durrësit të Ri”, Shkozetit dhe Spitallës. Gjithashtu do të punojë për ndërtimin e 2 parqeve të gjelbërta në zonën e Durrësit të Ri dhe Spitallës.

Promovim i programit për lehtësimin e efekteve që rrjedhin nga parku industrial dhe energjitik. Projekti duhet realizohet nga sponsorë, promotorët dhe investitorët e Parkut Industrial dhe Linja e Prodhimit të Energjisë nën mbikëqyrjen e autoriteteve kombëtare dhe vendore.

Jemi një nga Bashkitë e para që ka hartuar, në bashkëpunim me Ndërkombëtarët, Planin Lokal të Menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe një rregullore e re do të vihet në zbatim së shpejti me miratimin e këtij plani, me qëllim përmirësimin e cilësisë të pastrimit të qytetit dhe për një menaxhim të integruar të mbetjeve urbane . Në sajë të iniciativës të stafit të Bashkisë, nga ky plan po përfitojnë edhe komuna të tjera të Qarkut Durrës me përcaktimin e një landfilli sanitar, ku potencialin më të madh e ka Bashkia e Durrësit.

DEMOGRAFIA

Qyteti i Durrësit, sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile deri në Dhjetor të vitit 2015, ka një popullsi prej 214.559 banorë, nga të cilët 107.092 janë meshkuj që përbëjnë 49.9% dhe 107467 janë femra që përbëjnë 50.1%. Më poshtë po paraqesim të dhënat demografike në vite për qytetin e Durrësit:

Vitet	Popullsia banuese në fund të vitit	M	F	Të ardhur	Të larguar	Lindje	Vdekje	Nr. Familjeve	Nr. Martesave
2005	189.592	95.651	93.941	14.562	5.371	1.404	732	45.915	1.245
2006	195.160	98.552	96.608	11.688	6.793	1.350	735	46.617	1.179
2007	197.699	99.915	97.784	5.397	3.128	1.291	829	47.450	1.075
2008	200.315	101.157	99.159	4.394	2.416	1.424	786	48.433	1.216
2009	203.550	102.741	100.809	5.429	2.668	1.241	763	49.290	1.028
2010	206.243	104.064	102.179	2.885	711	1.309	887	50.140	899
2011	203.943	102.337	101.606					61.177	
2012	205.818	103.403	102.415	1.079		2.106	928	61.769	732
2013	208.026	104.146	103.880	803		1.973	1.041	62.757	1.154
2014	210.285	105.081	105.204	721		2.421	1.154	64.377	1.247
2015	214.559	107.092	107.467			2.239	1.101	67.523	1.223


Të dhënat për popullsine banuese nga viti 2001-2015 në Durrës

Vitet	Popullsia banuese	Rritja ne %
2001	158.713	
2002	166.874	5.1%
2003	174.111	4.3%
2004	179.246	2.9%
2005	189.592	5.8%
2006	195.160	2.9%
2007	197.699	1.3%
2008	200.315	1.3%
2009	203.550	1.6%
2010	206.243	1.3%
2011	203.943	
2012	205.818	1.1%
2013	208.026	1%
2014	210.285	1%
2015	214.559	2%

Burimi i te dhënave: Gjendja Civile

DEMOGRAFIA

Popullsia banuese në qytetin e Durrësit për vitet 2001 -2015, grafikisht paraqitet si më poshtë:



Nga tabela dhe paraqitja grafike e mësipërme, vërejmë se në vitet e fundit kemi një rritje të qëndrueshme vit pas viti me rreth 1% - 2%.

Përsa i përket demografisë për Bashkinë e madhe në bazë të ligjit mbi ndarjen e re territoriale, sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile deri në Dhjetor të vitit 2015, numri i popullsisë për këtë Bashki, është 309.190 banorë dhe numri i familjeve është 92.365 familje.

Në tabelën e më poshtme, po paraqesim të dhënat demografike për vitin 2015, mbi popullsinë banuese dhe numrin e familjeve për cdo Njesi Administrative që përbëjnë Bashkinë Durrës.

Njësia Administrative	Popullsia banuese	Nr. Familjeve
Bashkia Durrës	214.559	67.286
Bashkia Manëz	11.744	3.058
Bashkia Sukth	27.841	7.330
Komuna Ishëm	8.938	2.389
Komuna Katundi Ri	15.896	4.306
Komuna Rrashbull	30.212	7.996
Bashkia Durrës	309.190	92.365

TREGU I PUNES

PUNESIMI

Sipas Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve në Tiranë, për vitin 2013- 2014 forcat aktive të punës në Qarkun e Durrësit, llogariten sipas tabelës së më poshtme:

Punësimi në vitet 2013-2014 për Qarkun e Durrësit

Vitet	Të punësuar ne Sektorin shtetëror	Të punësuar ne Sektorin jo bujqësor	Të papune të rregjistruar
Viti 2013	11.754	36.825	9.001
Viti 2014	11.700	38.000	9.734

Burimi i te dhenave: Shërbimi Kombëtar i Punësimit Tirane

Gjithashtu, sipas INSTAT, nuk disponohen të dhëna për të punësuarit në sektorin bujqësor.

PAPUNESIA

Në fund të vitit 2015, sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Punësimit në Durrës, për Qarkun e Durrësit, numri i punëkërkuessve të papunë të rregjistruar gjithsej arrin në 9.060 persona, nga të cilët 4.657 janë femra dhe 4.403 janë meshkuj, kurse për qytetin e Durrësit arrin në 7.029 persona, nga të cilët 3.681 ose 52.4 % janë femra dhe 3.348 ose 47.6% janë meshkuj.

Të dhënat për punëkërkuess të papunë sipas gjinisë, grupmoshave dhe nivelit arsimor të rregjistruar në Zyrën e Punësimit për qytetin e Durrësit në vitet 2001-2014, po i paraqesim në tabelat e mëposhtme:

Të ndarë sipas gjinisë, të papunët e rregjistruar, për qytetin e Durrësit paraqiten si më poshtë:

Vitet	Të papunë të rregjistruar gjithsej	Femra	%	Meshkuj	%
Viti 2001	5419	2901	53.5	2518	46.5
Viti 2002	5997	3208	53.5	2789	46.5
Viti 2003	6100	3158	51.8	2942	48.2
Viti 2004	5660	2863	50.6	2797	49.4
Viti 2005	5583	2758	49.4	2825	50.6
Viti 2006	5182	2403	46.4	2779	53.6

Viti 2007	5132	2936	57.2	2196	42.8
Viti 2008	5029	2871	57.1	2158	42.9
Viti 2009	5635	3182	56.5	2453	43.5
Viti 2010	6024	3436	57.0	2588	43.0
Viti 2011	6131	3472	56.6	2659	43.4
Viti 2012	6060	3161	52.2	2899	47.8
Viti 2013	6354	3323	52.3	3031	47.7
Viti 2014	6514	3157	48.5	3357	51.5
Viti 2015	7031	3681	52.4	3348	47.6

Nga tabela e mësipërme, vërejmë se numrin më të madh të papunëve të rregjistruar në qytetin e Durrësit, për vitin 2015 e përbëjnë femrat, në ndryshim me vitin 2014, ku numërin më të madhë e përbënin meshkujt.

Të ndarë sipas grupmoshave, punëkërkues të papunë të rregjistruar, për qytetin e Durrësit për vitet 2001-2010, paraqiten si më poshtë:

Vitet	Të papunë të rregjistruar	Sipas grupmoshave						
		nen 25 vjec	15-19	20-24	25-34	mbi 34	35-44	mbi 44
2001	5419	937	362	575	1540	2942		
2002	5997	1092	377	715	1288	3617		
2003	6100	1086	400	686	1262	3752		
2004	5660	568	217	351	1114		1503	2475
2005	5583	600	227	373	975		1459	2549
2006	5182	411	141	270	760		1368	2643
2007	5132	599	174	425	767		1426	2340
2008	5029	640	213	427	767		1371	2251
2009	5635	767	253	514	883		1294	2691
2010	6024	691	206	485	1011		1190	3132

Për vitin 2011-2015, punëkërkues të papunë të rregjistruar, të ndarë për qytetin e Durrësit paraqiten si më poshtë:

Viti	Të papunë të rregjis.	Sipas grupmoshave								
		deri 25	15-19	20-24	25-29	30- 34	35-39	40- 44	45-50	mbi 50
2011	6131	728	222	506	583	525	541	634	935	2185
2012	6060	826	306	520	538	494	547	625	838	2192
2013	6354	773	377	396	573	552	612	636	939	2269
2014	6514	1318						2746		2450
2015	7031	830			627	494	422	822	1363	2473

TREGU I PUNES

Të ndarë sipas nivelit arsimor, punëkërkuës të papunë të rregjistruar, për qytetin e Durrësit për vitet 2001-2015, paraqiten si më poshtë:

Vitet	Të papunë të rregjistruar	Sipas nivelit arsimor			
		8/9 vjecar	Mesme e përgjithshme	Mesme Profesionale	Universitar
2001	5419	2810	1492	944	937
2002	5997	3458	1687	625	1092
2003	6100	3662	1459	764	1086
2004	5660	3389	1265	793	213
2005	5583	3345	1192	843	203
2006	5182	3108	1047	811	216
2007	5132	3051	1462	398	221
2008	5029	3039	1476	242	272
2009	5635	3146	1981	208	300
2010	6024	3301	1630	693	400
2011	6131	3317	1606	766	442
2012	6060	3347	1616	733	364
2013	6354	3624	1664	724	342
2014	6514	3096	2589		829
2015	7031	3399	1986	960	686

Burimi i te dhenave: D. R.Sh P Durrës

TREGU I PUNES PENSIONET

Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dega Durrës, deri në muajin Dhjetor 2015, për Bashkinë e Re Durrës, janë rregjistruar gjithsej 43,505 pensionistë.

Më poshtë po paraqesim të dhënat mbi pensionistët e rregjistruar për vitin 2015 për qytetin e Durrësit dhe për cdo komunë apo Bashki që i është bashkëngjitur Bashkisë Durrës pas organizimit të ri të Qeverisjes Vendore me ndarjen e re territoriale:

Të dhëna mbi pensionistët e rregjistruar në vite për rajonin e Durrësit

Njësi Administrative	Pensione gjithsej:		Pension pleqërie		Pension familjar		Pension invaliditeti		Pensione (të tjera)	
	Persona	%	Persona	%	Persona	%	Persona	%	Persona	%
Bashkia Durrës	36777	100	27170	73.9	2960	8.0	4766	13.0	1881	5.1
Bashkia Sukth	3714	100	2811	75.7	352	9.5	540	14.5	11	0.3
Mashkia Manëz	871	100	713	81.9	83	9.6	74	8.4	1	0.1
Komuna Kat. Ri	729	100	581	79.7	85	11.6	60	8.2	3	0.4
Komuna Ishëm	833	100	644	77.3	105	12.6	77	9.3	7	0.8
Kom. Rrashbull	581	100	462	79.5	78	13.4	38	6.6	3	0.5
Bashkia Durrës	43505	100	32381	74.4	3663	8.4	5555	12.8	1906	4.4

Burimi i te dhenave: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës

Në tabelën e më poshtëme po paraqesim të dhënat mbi pensionistët e rregjistruar në vitet e fundit për qytetin e Durrësit:

Të dhëna mbi pensionistët e rregjistruar në vite për qytetin e Durrësit

Vitet	Pensione gjithsej:		Pension pleqërie		Pension familjar		Pension invaliditeti		Pensione(të tjera)	
	Persona	%	Persona	%	Persona	%	Persona	%	Persona	%
2008	34161	100	26122	76.5	3892	11.4	4147	12.1	0	0
2009	34881	100	26249	75.2	4041	11.6	4575	13.1	16	0.1
2010	28423	100	21468	75.5	2698	9.5	3183	11.2	1074	3.8
2011	28109	100	20450	72.7	2575	9.2	3521	12.5	1563	5.6
2012	27774	100	20350	73.3	2429	8.7	3406	12.3	1589	5.7
2013	28503	100	20838	73.1	2417	8.5	3615	12.7	1633	5.7
2015	36777	100	27170	73.9	2960	8.0	4766	13.0	1881	5.1

Burimi i te dhenave: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës

STEMA E BASHKISE SE DURRESIT

Qyteti i Durrësit ka emblemën e tij, e cila është zbërthyer në flamur, në vulë e medalion. U bë i mundur mbas shpalljes së konkursit për emblemën e qytetit, hapur nën kujdesin e Drejtorisë së Muzeut. Mbas konkursit dhe debatit shkencor me pjesëmarrjen e autoriteteve lokale, intelektualëve, forcave krijuese artistike e arkitektëve, fitoi maketi i paraqitur nga piktori Nikolett Vasia dhe nga konsulenti historian Sali Hidri. Medalioni me stemën e Bashkisë, u realizua në Monopoli të Italisë.

Stema e Bashkisë u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr 41 dt 05.06.1995. Ajo paraqet tre momente të rëndësishme të zhvillimit historik të qytetit, dhënë nëpërmjet simboleve: Anija Liburne, Muri Rrethues i kohës së Perandor Anastasit I (491-518) dhe Luani i stemës së Karl Topisë që i dha pavarësi politike qytetit të Durrësit.



HISTORIKU I BASHKISE DHE I KRYEBASHKIAKEVE TE DURRESIT

Periudha 1900-1920

Kjo periudhë përkon me krijimin e disa shoqatave kulturore dhe patriotike, lëvizjet e të cilave propozuan kandidaditin e parë nga Durrësi.

Kryetari i parë i administratës shqiptare ishte Hafiz Ali Podgorica.

Periudha 1920-1924

Gjatë kësaj periudhe Kryetare të Bashkisë së Durrësit kanë qenë:

- | | | | |
|---|---------------|-----------------|-----------------------------|
| o | Mehmet | Gruda | 1920-1921 |
| o | Kost | Paftali | 1922-1924 |
| o | Hysen | Myshketa | Qershor-Dhjetor 1924 |

Periudha 1925-1939

Ky hark kohor përfshin periudhën e qeverisë së Ahmet Zogut.
Kryetarë të Bashkisë së Durrësit gjatë kësaj periudhe kanë qenë:

- | | | | |
|---|---------------|--------------------|------------------|
| o | Jahja | Ballhysa | 1926 |
| o | Abedin | Nepravishta | 1927-1928 |
| o | Ahmet | Dakli | 1929-1937 |
| o | Rustem | Ymeri | 1937-1939 |

Periudha 1939-1943

Përfshin periudhën e pushtimit fashist.
Kryetarë të Bashkisë së Durrësit gjatë kësaj periudhe kanë qenë:

- | | | | |
|---|----------------|----------------|------------------|
| o | Shefqet | Celkupa | 1939-1940 |
| o | Llazar | Tuni | 1940-1943 |

Periudha 1943-1944

Kryetarë të Bashkisë së Durrësit gjatë kësaj periudhe kanë qenë:

- | | | | |
|---|---------------|--------------|----------------------------|
| o | Spiro | Truja | Tetor 1943-Maj 1944 |
| o | Mahmut | Cela | Maj-Nentor 1944 |

HISTORIKU I BASHKISE DHE I KRYEBASHKIAKEVE TE DURRESIT

Periudha 1944-1990

Kryetarët e Bashkisë së Durrësit gjatë kësaj periudhe kanë qenë:

o	Nikolle	Tirana	1944-1947
o	Qirjako	Notidhi	1947-1948
o	Vlash	Prifti	1948-1949
o	Nasi	Driza	1949-1952
o	Zeqir	Duma	1953-1956
o	Petraç	Titani	1957-1959
o	Haki	Kokomani	1959-1961
o	Ramazan	Vogli	1961-1962
o	Bajram	Thermia	1962-1971
o	Halit	Nova	1972-1974
o	Bajram	Hasa	1975-1979
o	Mihallaq	Bushamaku	1979-1983
o	Sotir	Luarasi	1983-1989
o	Ymer	Balla	1989-1990
o	Petraç	Koto	Janar-Gusht 1991

Periudha 1991-2005 (vazhdim)

Kjo periudhë është periudha e demokratizimit të vendit.

Gjatë kësaj periudhë, Kryetarë të Bashkisë së Durrësit kanë qenë:

o	Nevruz	Cela	Tetor 1991- Mars 1992
o	Shkelzen	Jakova	Mars-Shtator 1992
o	Tomor	Golemi	1992-1996
o	Arqile	Gorea	1996-2000
o	Miri	Hoti	2000-2003
o	Lefter	Koka	2003-2007
o	Vangjush	Dako	2007-2011
o	Vangjush	Dako	2011-2015
o	Vangjush	Dako	2015 në vazhdim

KESHILLI BASHKIAK



Këshilli Bashkiak i dalë nga zgjedhjet vendore të 21 qershorit të vitit 2015, ka një mandat kohor për një periudhë 4-vjecare.

Këshilli Bashkiak ushtron funksionet e tij sipas nenit 26 te ligjit Nr.8452 dt.31.07. 2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore „.

Këshilli Bashkiak i Durrësit përbëhet nga 51 këshilltarë, nga të cilët 35 këshilltarë janë të koalicionit të djathtë dhe 16 këshilltarë janë të koalicionit të majtë.

Kryetar i Këshillit Bashkiak për këtë mandat u zgjodh z. A.Rahmoitaj dhe zv/kryetar, z. A.Bujari.

PASQYRA E KESHILLIT BASHKIAK

Nr	FORCA POLITIKE	KESHILLTARET				
		Nr. Këshilltarëve	Meshkuj	Femra	Koalicioni djathtë	Koalicioni majtë
1	Partia Socialiste e Shqipërise	16	8	8		16
2	Partia Socialiste e Moderuar	2	1	1		2
3	Levizja Socialiste për Integrim	13	6	7		13
4	Partia Drejtësi Integrim Unitet	2	1	1		2
5	Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet	1	-	1		1
6	Fryma e Re Demokratike	1	1	-		1
7	Partia Demokratike	14	7	7	14	
8	Partia Republikane	2	1	1	2	
	TOTALI:	51	25	26	16	35

KESHILLI BASHKIAK

Paraqitja grafike e këshilltarëve sipas gjinisë paraqitet si më poshtë:

Paraqitja grafike e këshilltarëve sipas gjinisë



Duke iu referuar pasqyrës së mësipërme dhe paraqitjes grafike, numri i antarëve të Këshillit Bashkiak në qytetin e Durrësit është 51, nga të cilët 25 antarë janë meshkuj që përbëjnë 49% dhe 26 antare janë femra që përbëjnë 51%, që do të thotë së numri i antareve femra, ka përmbysur shifrat në krahasim me mandatet e kaluara, ku dominonin antarët meshkuj. Krahasuar me antarët e Këshillit Bashkiak në mandatin e mëparshëm, i cili përbëhej nga 45 anëtarë, ku numri i antarëve meshkuj ishte 36 antarë ose 80%, dhe 9 antare femra ose 20%, do të thotë së numri i antareve femra, për këtë mandat është rritur me 31%, kurse e antarëve meshkuj është ulur me 31%.

KESHILLI BASHKIAK

Pasqyra e komisioneve të Këshillit Bashkiak

Në përbërjen e Këshillit Bashkiak, funksionojnë 10 komisione, të paraqitura si më poshtë:

Nr	EMERTIMI I KOMISIONEVE	Nr. antareve	Subjekti Politik
1	Komisioni i Mandateve	5	2(PS)+1(PD)+1(PDIU)+1(LSI)
2	Komisioni Financë-Buxhet dhe Taksave-Tarifave	9	4(PS)+3(PD)+1(PR)+1(LSI)
3	Komisioni i Strehimit, Shërbi. Pub. dhe i Brendshëm	9	3(PS)+3(PD)+1(PR)+1(PDS)+1(LSI)
4	Komisioni Mbrojtja Civile dhe Siguria Publike	5	2(PS)+2(PD)+1(PDV91)
5	Komisioni Pronat Publ, Transp. dhe Trafikut Rrugor	7	1(PD)+4(PS)+1(PDIU)+1(LSI)
6	Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	7	3(PS)+1(PD)+2(PDIU)+1(LSI)
7	Komisioni Kulturë-Arsim-Sport-Kom.Fetare	7	2(PD)+3(PS)+1(PR)+1(LSI)
8	Komisioni Politikave të Zhvillimit Ekonomik	7	2(PD)+3(PS)+1(PDK)+1(PDS)
9	Komisioni Politikave të Zhvillimit të Turizmit	7	4(PS)+2(PD)+1(PDIU)
10	Komisioni Marrëdhënieve me Jashtë	7	1(PD)+4(PS)+2(PDIU)

Burimi të dhënave: Sekretaria e Këshillit Bashkiak

Miratimi i vendimeve në Këshill Bashkiak në vite është si më poshtë:

Për vitin 2003, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 108 vendime.

Për vitin 2004, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 93 vendime.

Për vitin 2005, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 64 vendime.

Për vitin 2006, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 58 vendime.

Për vitin 2007, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 58 vendime.

Për vitin 2008, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 73 vendime.

Për vitin 2009, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 62 vendime.

Për vitin 2010, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 60 vendime

Për vitin 2011, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 42 vendime

Për vitin 2012, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 83 vendime

Për vitin 2013, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 54 vendime

Për vitin 2014, Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 61 vendime

Për vitin 2015 , Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 81 vendime

KESHILLI BASHKIAK


Në tabelën e më poshtëme, po paraqesim numërin e vendimeve të miratuara në Këshill Bashkiak.

Vitet	Nr. Vendimeve te miratuara
2003	108
2004	93
2005	64
2006	58
2007	58
2008	73
2009	62
2010	60
2011	42
2012	83
2013	54
2014	61
2015	81

Burimi te dhenave: Sekretaria e Keshillit Bashkiak

Ecuria e miratimit të VKB në vite paraqitet grafikisht si më poshtë:

Paraqitja grafike e vendimeve të miratuara në vite



KESHILLI BASHKIAK

Vendimet e miratuara të Këshillit Bashkiak për vitin 2015, janë si më poshtë:

Vendimi nr. 239 datë 14/01/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për muajin Janar 2015”.

Vendimi nr. 240 datë 14/01/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të pikës 1 të VKB Nr.201 dt.10.07.2014 “Për krijimin e Këshillit Kulturor pranë Bashkisë Durrës”.

Vendimi nr. 241 datë 14/01/2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Këshillimor për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit pranë Bashkisë Durrës ”.

Vendimi nr. 242 datë 14/01/2015 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2016”.

Vendimi nr. 243 datë 22/01/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike të muajit Janar 2015 dhe Pagesa e paaftësisë për muajin Janar 2015”.

Vendimi nr. 244 datë 19/02/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike të muajit Shkurt 2015 dhe Pagesa e paaftësisë për muajin Shkurt 2015”.

Vendimi nr.245 datë 19/02/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-29.02.2015 ”.

Vendimi nr.246 datë 23/03/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për muajin Mars 2015”.

Vendimi nr. 247 datë 23/03/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike të muajit mars 2015 dhe Pagesa e paaftësisë për muajin Mars 2015”.

Vendimi nr. 248 datë 10/04/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të fituesve për ndarjen e banesave sociale me qera me strukturë 2+1 dhe 1+1”.

Vendimi nr. 249 datë 10/04/2015 “Për miratimin e ushtrimit të funksioneve të Njesisë së Menaxhimit të Banesave Sociale me Qera, nga Njësia e Zbatimit të Projektit PIU dhe miratimin e rregullores përkatëse ”.

Vendimi nr. 250 datë 10/04/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e vlerave të qerasë për secilën tip apartamenti sipas tabelës së qerave për banesat sociale sesioni I”.

Vendimi nr.251 datë 10/04/2015 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet në nevojë që kërkojnë të trajtohen me banesa sociale me qera Sesioni II”.

KESHILLI BASHKIAK

Vendimi nr. 252 datë 10/04/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa të Paketës Fiskale, miratuar me VKB Nr 178, dt.29.01.2014 i ndryshuar”.

Vendimi nr. 253 datë 22/04/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike të muajit Prill 2015 dhe Pagesa e paaftësisë për muajin Prill 2015”.

Vendimi nr. 254 datë 22/04/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-30.04.2015 ”.

Vendimi nr. 255 datë 18/05/2015 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit Faktik të vitit 2015 të Bashkisë Durrës”.

Vendimi nr. 256 datë 18/05/2015 “Për miratimin e Buxhetit shtesë të vitit 2015 të Bashkisë Durrës”.

Vendimi nr. 257 datë 18/05/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31.05.2015 ”.

Vendimi nr. 258 datë 18/05/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit shtesë prej 4.7659.560 Lek, për objektin: Ndërtim i rrugës paralele me murin e Portit ”.

Vendimi nr. 259 datë 18/05/2015 “Për miratimin e stacioneve të linjave urbane brenda territorit të qytetit të Durrësit të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus”.

Vendimi nr. 260 datë 18/05/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit shtesë prej 1.7970.872 Lek, për financimin e shërbimit të projektimit të punimeve që lidhen me zbatimin e projektit: Kualifikimi i hapsirave midis kuatallit nga rruga Skënderbej deri në rrugën Marsi 91 dhe hapsira deri tek rruga e Portit si dhe shërbimi i ujrave të bardha deri tek Ura e Dajlanit, Bashkia Durrës” .

Vendimi nr. 261 datë 18/05/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit shtesë prej 12.7000.000 Lek, për objektin: Rikonstruksion i segmentit, Bulevardi Dyrrah-Sheshi Liria” .

Vendimi nr. 262 datë 18/05/2015 “Për miratimin e privatizimit të banesës me sipërfaqe S= 71 m2, e ndodhur në L.13 Plazh në emër të z. Tom Preka”.

Vendimi nr. 263 datë 18/05/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike të muajit Maj 2015 dhe Pagesa e paaftësisë për muajin Maj 2015”.

Vendimi nr.264 datë 18/05/2015 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 9.954.000 Lek për vitin 2015 të Njësisë së Menaxhimit të Banesave Sociale me Qera ”.

KESHILLI BASHKIAK

Vendimi nr. 265 datë 18/05/2015 “Për miratimin për privatizim të dy objekteve të Ndërmarrjes Parku i Mallrave të Eksportit, pronë e Bashkisë”.

Vendimi nr. 266 datë 18/05/2015 “Për ndryshimin e emërtesës së administratores të QMF në Nish Tulla”.

Vendimi nr. 267 datë 12/06/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit shtesë prej 16.603.560 Lek për pagesën e mbikqyrjes dhe kolaudit të objekteve financuar nga FZHR për vitin 2015 ”.

Vendimi nr. 268 datë 12/06/2015 “Për dhënie titulli:“Qytetar Nderi ” Fan S. Noli”.

Vendimi nr. 269 datë 12/06/2015 “Për miratimin e hartës së ndarjeve të Plazheve në varësi të gjerësisë së terrenit në qytetin e Durrësit ”.

Vendimi nr. 270 datë 12/06/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-30.06.2015 ”.

Vendimi nr. 271 datë 12/06/2015 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Qershor 2015 dhe Pagesa e Paaftësisë për muajin Qershor 2015 ”.

Vendimi nr. 272 datë 23/07/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31.07.2015 ”.

Vendimi nr. 273 datë 23/07/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Korrik 2015 dhe pagesa e paaftësisë për muajin Korrik 2015 ”.

Vendimi nr. 274 datë 23/07/2015 “Për verifikimin e mandateve të këshilltarëve pjesmarrës në Këshillin Bashkiak Durrës”.

Vendimi nr. 275 datë 03/08/2015 “Mbi zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak”.

Vendimi nr. 276 datë 03/08/2015 “Mbi zgjedhjen e zv/ Kryetarit të Këshillit Bashkiak „.

Vendimi nr. 277 datë 03/08/2015 “Për zgjedhjen e anëtarëve që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut Durrës”.

Vendimi nr. 278 datë 25/08/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31.08.2015 ”.

Vendimi nr. 279 datë 25/08/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Gusht 2015 dhe pagesa e paaftësisë për muajin Gusht 2015 ”.

Vendimi nr. 280 datë 09/09/2015 “Për miratimin e mandatit të këshilltarit z. Arsian Muka në Këshillin Bashkiak Durrës ”.

KESHILLI BASHKIAK

Vendimi nr. 281 datë 09/09/2015 “Për miratimin e punonjësve të Bashkisë Durrës, institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative ”.

Vendimi nr. 282 datë 09/09/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit shtesë për pagesën e antarëve të Këshillit Bashkiak që shtohen si rrjedhojë e ligjit Nr. 301 të vitit 2015”.

Vendimi nr. 283 datë 09/09/2015 “Për krijimin e komisioneve të përhershme pranë Këshillit Bashkiak Durrës”.

Vendimi nr. 284 datë 09/09/2015 “Për miratimin e ndryshimit të destinacionit të fondit prej 300.000 (mijë lek) në buxhetin e Klubit të Futbollit Teuta ”.

Vendimi nr.285 datë 09/09/2015 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB Nr. 178 dt. 29.01. 2014 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit, i ndryshuar ”.

Vendimi nr. 286 datë 23/09/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-30.09.2015”.

Vendimi nr. 287 datë 25/09/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2015 dhe pagesa e paaftësisë për muajin Shtator 2015 ”.

Vendimi nr. 288 datë 15/10/2015 “Për miratimin e buxhetit tranzitor të Njësive Vendore që shkrihen për periudhën 7 Korrik -31 Dhjetor 2015, që i shtohet buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2015 të miratuar me VKB Nr.242 dt 14.01.2015 ”.

Vendimi nr. 289 datë 15/10/2015 “Për miratimin e marrjes së nismës për hartimin e Planifikimit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës ”.

Vendimi nr. 290 datë 15/10/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 208 dt. 04.08.2014, për ndryshimin e VKB Nr. 169 dt.02.12.2013 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit, i ndryshuar ”.

Vendimi nr. 291 datë 15/10/2015 “Për miratimin për dhënie me qera të ambjentit palestra sportive me sip.=473m², nga kjo sip. ndërtimi =450m², në administrim të K. Shumësporteve Teuta, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 3-vjekar, nëpërmjet procedures së konkurimit”.

Vendimi nr. 292 datë 15/10/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit prej 805.067 Lek për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri tek Banesat Sociale, Seksioni I ”.

Vendimi nr. 293 datë 15/10/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31.10.2015 ”.

KESHILLI BASHKIAK

Vendimi nr. 294 datë 15/10/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e fondit prej 958.764 Lek për kryerjen e punimeve emergjente nga rrëshqitja e dheut në kodrën pas Shkëmbit të Kavajës”.

Vendimi nr. 295 datë 15/10/2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të zgjedhjes së Kryesisë dhe Kryetarit të Kryepaqësve të fshatrave si dhe përcaktimin e numrit të anëtarëve të Kryesisë për cdo fshat të Bashkisë Durrës”.

Vendimi nr. 296 datë 15/10/2015 “Këshilli Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 8652, shqyrtoi dorheqjet e bëra nga këshilltarët e Aleancës për Demokraci dhe Solidaritet si dhe listën shumëemrore të subjektit politik”.

Vendimi nr.297 datë 15/10/2015 “Këshilli Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 8652, shqyrtoi dorheqjet e bëra nga këshilltarët e LSI, si dhe listën shumëemrore të subjektit politik”.

Vendimi nr.298 datë 15/10/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Tetor 2015 dhe pagesa e paafëtisë për muajin Tetor 2015”.

Vendimi nr.299 datë 26/11/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës shumëemrore të nxënësve të Konvikteve të Shkollës së Mesme Profesionale “B.Cela” dhe Shkollës së Mesme Profesionale “B. Qeraxhi”, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar bursë për vitin shkollor 2015-2016”.

Vendimi nr. 300 datë 01/12/2015 “Këshilli Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 8652 dt.31.07.2000, shqyrtoi dorheqjet e bëra nga këshilltari, A.Tragaj i LSI, si dhe listën shumëemrore të subjektit politik”.

Vendimi nr. 301 datë 01/12/2015 “Për emërimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Durrës”.

Vendimi nr. 302 datë 01/12/2015 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”.

Vendimi nr. 303 datë 01/12/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes sëfondit prej 68.000.000 Lek për realizimin e studimeve: Projekt –zbatim i i sheshit publik para hyrjes së Portit dhe projekt-zbatimi i sheshit publik dhe godina shërbimi pranë Mauzeleumit të Dëshmorëve”.

Vendimi nr. 304 datë 01/12/2015 “Për shpalljen e emergjencës mjedisore për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë Durrës dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës”.

KESHILLI BASHKIAK

Vendimi nr. 305 datë 01/12/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-30.11.2015 ”.

Vendimi nr. 306 datë 01/12/2015 “Për miratimin e kalimit të shërbimit të pastrimit në territorin e Bashkisë Durrës me sipërmarrje private“.

Vendimi nr. 307 datë 01/12/2015 “Për miratimin për dhënien me qera të objektit : Baza Prodhuese e Arsimit me sip.=842m2, nga kjo sip. ndërtimi =620m2, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 4-vjecar, nëpërmjet procedurës së konkurimit“.

Vendimi nr. 308 datë 01/12/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Nëntor 2015 dhe pagesa e paaftësisë për muajin Nëntor 2015 ”.

Vendimi nr. 309 datë 01/12/2015 “Për miratimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjimore dhe Dhunën në Familje“.

Vendimi nr. 310 datë 01/12/2015 “Për dhënien e titullit : “ Qytetar Nderi ” z. Moikom Zeqo.

Vendimi nr. 311 datë 01/12/2015 “Për miratimin e listës emërore të familjeve që kërkojnë të përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti për strehim „.

Vendimi nr. 312 datë 15/12/2015 “Për propozim për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31.12.2015 ”.

Vendimi nr. 313 datë 15/12/2015 “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Dhjetor 2015 dhe pagesa e paaftësisë për muajin Dhjetor 2015 ”.

Vendimi nr. 314 datë 18/12/2015 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 281, dt.09.09.2015 Mbi miratimin e numërit të punonjësve të Bashkisë Durrës, institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative“.

Vendimi nr. 315 datë 18/12/2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të klasifikimit për ndarjen e banesave sociale me qera, me strukturë 2+1 dhe 1+1”.

Vendimi nr. 316 datë 18/12/2015 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 168, dt.02.12.2013 Mbi miratimin e komisionit të posacëm për dhënien e Licensave Profesionale“.

KESHILLI BASHKIAK

Vendimi nr. 317 datë 18/12/2015 “Për miratimin për aplikimin dhe ndjekje procedurash nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës pranë Entit Rregullator për ndryshimin e tarifave të shitjes me shumicë dhe pakicë të ujit për konsum publik”.

Vendimi nr. 318 datë 18/12/2015 “Për miratimin e ndryshimit të anëtarëve të komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike, në komisionin e Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës”.

Vendimi nr. 319 datë 18/12/2015 “Për miratimin e listës emërore të studentëve që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin 2015”.

BURIMET NJEREZORE

Në bazë të organizimit të ri të ndarjes territoriale, me zgjerimin e Bashkisë së Durrësit, u rrit dhe numri i punonjësve të administratës së kësaj Bashkie.

Sipas të dhënave të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Durrësit, numri i punonjësve dhe shkalla e arsimimit të administratës së kësaj Bashkie në 3 vitet e fundit, paraqitet si më poshtë:

Të dhëna për punonjësit e administratës në vite

Emertimi	Viti								
	2013			2014			2015		
Nr. I punonjesve gjithesej, nga keto:	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F
	258	143	115	226	112	114	356	205	151
Me arsim te larte	164	79	85	160	71	89	223	115	108
Me arsim te mesem	81	58	23	53	35	18	94	67	27
Me arsim te ulet	13	6	7	13	6	7	39	23	16

Burimi i te dhënave: Burimet Njerëzore


Të dhëna për personelin në vite

Vitet	Nr. Punonjesve	M	F	Masa disiplinore	Konkurse
Viti 2004	177	108	69	29	6 me 169 konkurent
Viti 2005	181	95	86	16	5 me 83 konkurent
Viti 2006	197	102	95	9	2 me 27 konkurent
Viti 2007	217	119	98	18	1 me 30 konkurent
Viti 2008	228	122	106	11	1 me 36 konkurent
Viti 2009	260	135	125	4	-
Viti 2010	263	146	117	10	12 me 70 konkurent
Viti 2011	262	144	118	26	-
Viti 2012	262	147	115	3	-
Viti 2013	258	143	115	5	1 me 102 konkurues
Viti 2014	226	112	114	-	1me 26 konkurues
Viti 2015	356	205	151	1	6 me 27 konkurues

Burimi i te dhënave: Burimet Njerëzore

BURIMET NJEREZORE

Paraqitja grafike e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë në vite



Sipas të dhënave dhe paraqitjes grafike, vëmë re se numri i punonjësve të administratës së Bashkisë nga viti 2004-2009, ka ardhur duke u rritur. Në vitet 2010-2012, numri i punonjësve është pothuajse i njëjtë dhe për vitin 2013-2014, numri i punonjësve është ulur. Po të krahasojmë vitin 2014, me vitin 2004, numri i punonjësve është rritur 27.7%, krahasuar me vitin 2005 është rritur 24.9%, krahasuar me vitin 2006 është rritur 14.7% , krahasuar me vitin 2007 është rritur 4.1% , krahasuar me vitin 2008, është ulur 0.9%, krahasuar me vitin 2009, është ulur 13%, krahasuar me vitet 2010, 2011 dhe 2012 numri i punonjësve është ulur me 13.7% dhe krahasur me vitin 2013, është ulur me 12.4%.

Për vitin 2015, me zgjerimin e Bashkisë së Durrësit, bazuar në ligjin Nr. 115/2014 dt. 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, numëri i punonjësve të Administratës së Bashkisë Durrës arriti në 356 punonjës, nga të cilët, 205 punonjës janë meshkuj ose 57.6% dhe 151 punonjëse janë femra që përbëjnë 42.4%.

BURIMET NJEREZORE

Paraqitja grafike e punonjësve të Administratës së Bashkisë sipas gjinisë, paraqitet si mëposhtë:



Në tabelën e mëposhtëme, po paraqesim të dhëna mbi punonjësit që kanë fituar statusin e nëpunësit civil.

Punonjës që kanë fituar statusin e Nëpunësit Civil

Viti	Numri i punonjësve që kanë fituar statusin
2002	37
2003	37
2004	98
2005	110
2006	119
2007	121
2008	133
2009	133
2010	145
2011	145
2012	145
2013	130
2014	40
2015	138

MARRREDHENIET ME PUBLIKUN DHE INSTITUCIONET

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë e Durrësit, funksionon sipas modelit të njohur perëndimor “One Stop Shop”. Nëpërmjet kësaj zyre, merren në konsideratë opinionet e qytetarëve dhe të biznesit mbi shërbimet që Bashkia e Durrësit ofron.

Bashkia, nëpërmjet Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet, është në kontakt të përditshëm me qytetarët e saj.

Ky sektor, frekuentohet nga një numër i madh bashkëqytetarësh që vijnë për të zgjidhur problemet që ata i shqetësojnë si dhe për marrjen e shërbimeve të ndryshme që ofron Bashkia e Durrësit.

Krahas punonjësve të kësaj zyre, për dhënie të informacioneve të ndryshme, për zgjidhje të kërkesë-ankesave, për mbledhje aplikimesh nga qytetarët etj, jepen edhe nga punonjës të sektorëve të tjerë, sipas grafikut pranë kësaj zyre.

Nëpërmjet Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e Bashkisë, ofrohen shërbime të tilla si: dhënie informacioni, shpërndarje formularësh, pranim dokumentash etj.

Bashkëpunimi i këtyre Drejtorive në Bashki me stafin e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun është domosdoshmëri, për të përcjellë tek qytetarët gjithë informacionin e nevojshëm në një formë sa më të thjeshtë.

Ndërkohë që një pjesë e madhe e kërkesave për informim jepen verbalisht nga specialistët e këtij sektori, shumë informacione të tjera janë paraqitur në stendat e ndodhura pranë kësaj zyre.

Korrespondenca e ardhur në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet, për vitet 2005-2015 paraqitet sipas tabelës si më poshtë:

MARREDHENIET ME PUBLIKUN DHE INSTITUCIONET

Korrespondenca e ardhur në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet

Viti	Numri i Kërkesë-ankesave të trajtuara
2005	6,261
2006	4,264
2007	7,164
2008	1,235
2009	1,278
2010	1,442
2011	1,856
2012	1,952
2013	3,018
2014	1,946
2015	3,511

Burimi i të dhënave: Zyra e Marrëdhënieve me Publikun

Nga tabela e mësipërme për vitin 2015, korespondenca kërkesë-ankesa krahasuar nga viti 2008 ka ardhur duke u rritur. Ndër kohë që shumë nga këto problematika zgjidhen duke u pritur publiku nga vetë përfaqesues të Drejtorisë së Urbanistikës, të Shërbimeve, të Ndihmës Ekonomike, të Tatim-Taksave etj, për të cilat dhe nevojat e komunitetit janë më të mëdha.

Përsa i përket vitit 2015, nga 3511 kërkesë-ankesa, 3313 kërkesë-ankesa i janë adresuar Drejtorisë së Shërbimeve dhe nga këto 3013 janë në lidhje me aplikimet për banesat sociale, dhe 300 leje transporti.

Gjithashtu, nga kjo zyrë, janë trajtuar dhe 198 kërkes-ankesa, nga të cilat:

- Kryetarit 93
- Drejtorisë Urbanistike 50
- Drejtoria Ligjore 30
- Gjendja Civile 25

MARREDHENIET ME PUBLIKUN DHE INSTITUCIONET

Një fluks i madh pune në këtë zyrë, janë dhe aplikimet e qytetarëve në fillim të cdo viti e më pas për gjithë muajt në vazhdim, për subjektet ekzistuese ato të rejat, qofshin biznese të vogla apo të mëdha, mbyllje apo ndërprerje aktiviteteve që i përkasin Drejtorisë së Tatim-Taksave në Bashki, që për vitin 2015, numri i aplikimeve arriti në 4500.

Më poshtë po paraqesim tabelën përmbledhëse të aplikimeve të qytetarëve për bizneset e tyre për 8 vitet 2008-2015 të kryera nga zyra e Marrëdhënieve me Publikun.

Emërtimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Sub.ekz.te B. i vogel	3215	1348	3452	3240	3152	3170	3270	3460
Sub.ekz. të B. i madh	160	241	752	450	435	500	450	440
Sub. i ri i B. të vogel	706	427	500	650	521	279	200	240
Sub. i ri iB. të madh	64	98	418	350	300	100	60	60
Vërtetime	870	783	953	850	913	56	50	70
Mbyllje	236	124	150	200	230	30	45	60
Ndërprerje	112	93	99	120	149	17	17	40
Rishikim xhiro	108	46	30	15	10	8	40	60
Kërkesë për zhp	33	64	29	70	85	5	-	20
Gjithsej:	5504	3224	6383	5945	5795	4165	4132	4500

Burimi i te dhenave: Zyra e Marrëdhënieve me Publikun

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Për vitin 2015 shpenzimet faktike në programin e shërbimeve sociale kapën vlerën 73.485 mijë lekë ose 3.4% të totalit të shpenzimeve faktike.

Në bazë të ligjit mbi ndarjen e re territoriale, sipas të dhënave të Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, nga muaji Gusht i vitit 2015, fondit të përdorur për persona me aftësi të kufizuar dhe fondit të Ndihmës Ekonomike për qytetin e Durrësit, i janë bashkëngjitur dhe fondet për 5 Njësiti Administrative si: Bashkia Sukth, Bashkia Manëz, Komuna Rrashbull, Komuna Ishëm dhe Komuna Katund i Ri.

Fondi i përdorur për persona me aftësi të kufizuar, si dhe fondi i ndihmës ekonomike në vite për qytetin e Durrësit, jepet në tabelat dhe grafikët e mëposhtme:

Fondi për personat me aftësi të kufizuar

000/leke


Vitet	Të paaftë		Kujdestare		Fondi gjithsej
	Numri	Vlera	Numri	Vlera	
Viti 2004	1326	110,810	121	9,641	120,450
Viti 2005	1482	126,873	139	20,245	147,118
Viti 2006	1613	140,403	153	12,952	153,354
Viti 2007	1790	173,315	227	23,894	197,209
Viti 2008	2022	196,931	310	29,365	226,296
Viti 2009	2127	237,439	345	29,410	266,849
Viti 2010	2150	267,231	419	46,888	314,119
Viti 2011	2325	259,132	496	58,631	317,763
Viti 2012	2486	350,354	570	68,212	418,566
Viti 2013	2763	455,065	643	78,132	537,197
Viti 2014	2063	225,225	211	24,091	249,316
Viti 2015	1932	207,433	235	25,807	233,240

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Paraqitja grafike e Fondit në vite për personat me aftësi të kufizuar

000/leke



Duke parë tabelën dhe grafikun e fondit për personat me aftësi të kufizuar në vite, vëmë re se ky fond ka ardhur duke u rritur nga viti në vit nga 2004-2013. Për vitin 2014, ky fond në krahasim me vitin 2013, është ulur me 287,881 mijë lek ose me 53% më pak, ndërsa fondi për personat me aftësi të kufizuar për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, është ulur me 16,067 lekë ose 6.4% më pak. Kjo ka ardhur pasi është ulur si numri i personave me aftësi të kufizuar dhe ai i kujdestarëve.

Fondi për të verbërit për qyteti e Durrësit për vitet 2014- 2015 është si më poshtë:

Fondi për të verbër

000/lek

Vitet	Të verbër		Kujdestare		Fondi gjithsej
	Numri	Vlera	Numri	Vlera	
Viti 2014	533	80,144	137	18,217	98,361
Viti 2015	523	78,996	129	20,245	99,241

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Fondi për paraplegjikët për qytetin e Durrësit për vitet 2014- 2015 është si më poshtë:

Fondi për paraplegjikë

000/lek

Vitet	Paraplegjikë		Kujdestare		Fondi gjithsej
	Numri	Vlera	Numri	Vlera	
Viti 2014	323	103,333	321	38,666	141,999
Viti 2015	310	101,687	309	47,781	149,468

Fondi për invalidët e punës për vitet 2007-2015 jepet sipas tabelës së mëposhtëme :

Fondi për Invalidët e punës

000/lek

Vitet	Invalid pune	
	Numri	Fondi
Viti 2007	2450	70,753
Viti 2008	2700	84,905
Viti 2009	2795	98,895
Viti 2010	3038	105,000
Viti 2011	3256	118,381
Viti 2012	3476	125,618
Viti 2013	3749	132,609
Viti 2014	3848	140,317
Viti 2015	4119	148,771


Burimi i te dhenave: Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

Paraqitja grafike për fondin e Invalidëve te punës për qytetin e Durrësit në vite është si më poshtë:

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Paraqitja grafike e Fondit të Invalidëve të Punës

000/leke



Fondi për invalidët e punës, sic vihet re nga tabela dhe grafiku i mësipërm ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Për vitin 2015, në krahasim me vitin 2014, fondi për invalidët e punës është rritur në masën 6%.

Familjet që përfitojnë Ndihmë Ekonomike dhe fondi gjithsej

Për vitin 2015, për Bashkinë e madhe Durrës, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga shteti është 354 familje me fond page 19.208.368 lekë, ndërsa numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga Bashkia është 66 familje me fond page 2.527.500 lekë. Pra në total, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike për vitin 2015, është 420 familje me fond page 21.735.868 lekë.

Nga këto: për qytetin e Durrësit, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga shteti është 328 familje me fond page 16.734.528 lekë dhe për 5 Njësitë Administrative të bashkëngjitur qytetit të Durrësit nga muaji Gusht të vitit 2015, janë 26 familje të trajtuara me një fond page 2.473.840 lekë.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Tabela dhe grafiku i më poshtëme paraqet fondin gjithsej, d.m.th fondin e ndihmës ekonomike nga shteti dhe fondin e vecantë nga Bashkia për 394 familje të qytetit të Durrësit


000/leke

Vitet	Fondi gjithsej	
	Numri	Vlera
Viti 2004	929	40,994
Viti 2005	830	32,220
Viti 2006	735	23,334
Viti 2007	594	25,287
Viti 2008	548	25,939
Viti 2009	513	24,458
Viti 2010	490	23,445
Viti 2011	493	23,461
Viti 2012	440	19,165
Viti 2013	430	17,992
Viti 2014	485	24,900
Viti 2015	394	19,262

Burimi i te dhenave: Drejtoria e Ndhimes Ekonomike

Paraqitja grafike e fondit të ndihmës ekonomike për vitet 2004-2015 është si me poshtë:

000/leke



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Sic vihet re nga tabela e mësipërme, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, për qytetin e Durrësit për vitet 2004-2015, ka pësuar ulje e ngritje.

Më poshtë po paraqesim dy tabela me fondin total të Ndhmës Ekonomike, paaftësisë, të verbër, paraplegjik dhe invalid për vitin 2015 për Bashkinë Durrës, ku nga muaji Gusht janë përfshirë dhe Njësitë Administrative: Sukth, Rrashbull, Katund i Ri, Manëz dhe Ishëm.

leke

Viti 2015	Ndihma Ekonomike	Fondi i vecante	Paaftesi	Perkujdesje	Te verber	Perkujdesje
Janar	1.425.780	224.900	16.736.100	2.058.600	6.748.200	2.058.600
Shkurt	1.395.800	183.500	19.014.750	2.157.750	6.694.350	2.157.750
Mars	1.534.920	177.300	18.135.600	2.098.800	6.579.900	2.098.800
Prill	1.482.860	179.300	17.965.500	2.256.600	6.590.900	2.256.600
Maj	1.439.700	205.000	18.444.192	2.178.000	6.542.387	2.178.000
Qershor	1.288.860	223.700	18.106.398	2.197.800	6.311.763	2.197.800
Korrik	1.396.528	219.700	16.076.592	2.192.850	6.446.698	2.192.850
Gusht	1.974.100	226.900	23.531.240	3.172.950	9.511.923	2.261.250
Shtator	1.867.100	222.900	23.883.470	3.468.945	9.515.818	2.322.860
Tetor	1.912.000	221.900	24.548.670	3.139.705	9.281.918	2.255.220
Nentor	1.888.100	219.900	26.686.398	3.580.605	9.449.633	2.300.780
Dhjetor	1.602.620	222.500	26.329.742	3.123.695	9.737.053	2.357.730
Total:	19.208.368	2.527.500	249.458.652	31.626.300	93.410.543	26.638.240

Viti 2015	Paraplegjik	Perkujdesje	Invalid
Janar	8.811.050	3.327.850	12.131.900
Shkurt	8.731.850	3.202.900	12.107.800
Mars	8.841.750	3.431.550	11.601.400
Prill	8.388.550	3.192.800	11.808.800
Maj	7.914.700	3.099.200	12.503.700
Qershor	7.637.060	3.016.000	12.551.200
Korrik	9.129.160	3.265.600	12.706.600
Gusht	12.969.820	16.188.400	4.960.550
Shtator	12.957.794	16.037.700	4.958.330
Tetor	12.642.694	16.206.900	4.906.330
Nentor	13.022.364	16.094.900	5.073.770
Dhjetor	14.198.456	16.134.300	5.346.380
Total:	125.245.248	103.193.100	166.073.600

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pra, për Bashkinë e re për vitin 2015, kemi këto të dhëna si më poshtë::

leke

Viti 2015	Fondi gjithsej	
	Numri	Vlera
Invalid te pergjithshem	2846	249,458,652
Kujdestare	391	31,626,300
Te verber	751	93,410,543
Kujdestare	205	26,638,240
Paraplegjik	477	125,245,248
Kujdestare	477	103,198,100
Invalid pune	5209	166,073,600

Burimi i te dhenave: Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

**Të dhëna statistikore mbi numrin e personave me aftësi të kufizuar, mendor, fizik etj.
sipas grup sëmundjeve për vitin 2015**

Emërtimi	Total	Me kujdestari	Përfitues të rinj	Sëmundje	
				Të lindur	Të fituar
Persona sipas gr.sëmundjeve	2372	232	31	905	1467
- probleme të shëndetit mendor	329	12	1	85	244
-aftësi të kufizuar mendor	488	28	3	172	316
-aftësi të kufizuar fizik	667	96	7	249	418
-aftësi të kufizuar të përzier	794	27	17	305	489
-me autizem	93	69	3	93	-
-HIV-AIDS	1	-	-	1	-

Burimi i te dhenave: Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

Nga analiza e bërë në vite **situatës sociale** të qytetit të Durrësit, vihet re një rritje në sasi dhe cilësi e këtyre shërbimeve, kjo si pasojë e ndjeshmërisë që pushteti vendor ka për problematikat e mprehta të këtyre programeve, por edhe sepse në strukturat e Bashkisë funksionojnë:

- Zyra për Barazinë Gjinore.
- Zyra për mbrojtjen e fëmijëve.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Këto zyra ofrojnë shërbimet e tyre në fushat përkatëse duke zgjeruar spektrin e përkujdesit për kategoritë e grave dhe të fëmijëve, si dhe duke lobuar për mbrojtjen e të drejtave dhe përfaqësimin e barabartë të këtyre grupeve vulnerabël.

Programi i kujdesit social parashikon hartimin e programeve lokale të kujdesit social për të gjitha shtresat në nevojë: si familje, të moshuar apo të rinj.

Barazia Gjinore

Një vëmendje të vecantë Bashkia Durrës i ka kushtuar dhe problemit të dhunës ndaj grave si dhe përkujdesit ndaj tyre.

Gjatë vitit 2015, Zyra për Barazinë Gjinore, ka kryer këto aktivitete:

- 1. Për festën e 8 Mars-Manifest:** U organizua në Qytetin e Durrësit, në sheshin Taulantia, Misioni i ndërgjegjësimit për të drejtat e grave dhe promovimit të barazisë gjinore. Këngëtarët - Ambasadorë të Fushatës Kundër Dhunës me bazë gjinore Manifest, ngritën peshë zemrat e njerëzve me këngën “Zbrite Diellin”- Himni i Barazisë Gjinore, dhe solli së bashku, aktorë të qeverisë dhe shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, aktivistë dhe artistë, mediat dhe publikun e gjerë.
- 2. "Viti i Familjes":** Në përmbyllje të një fushate informimi dhe ndërgjegjësimi disa ditore që është zhvilluar në zona të ndryshme të qytetit të Durrësit, në kuadër të mbylljes së një programi 2-vjeçar "Viti i Familjes", është organizuar një aktivitet, me qytetarët e Durrësit për të promovuar familjen e shëndetshme si një njësi ku njerëzit e duan njëri-tjetrin, komunikojnë, dhe përpiqen sëbashku për të ndërtuar të mirat dhe për të kapërcyer vështirësitë.
- 3.Fushata sensibilizuese dhe debati social “Kosto e dhunës në qytetin e Durrësit”.**
Në Durrës, nën nismën e UN Women dhe UNDP (Program i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim), u organizua më 23 Prill 2015 nga Bashkia Durrës dhe partneri vendor, Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, fushata “Kosto e dhunës në qytetin e Durrësit”. Qëllimi i fushatës njëditore ishte sensibilizimi qytetar dhe debati social rreth kostove që një viktimë e dhunës ka për secilin institucion dhe për shoqërinë, si dhe rëndësia e buxhetimit të këtyre kostove në të gjitha hallkat e saj.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Kjo fushatë ndërthuri ndërgjegjësimin qytetar, mediatik dhe diskutimet e institucioneve përkatëse mbi kostimin e viktimave të dhunës. Në kuadër të kësaj fushate, Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” bëri informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve, ku aktorët e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës, si Policia, Zyra e Përmbaramit, Drejtoria Arsimore, Drejtoria e Shëndetit Publik, Shërbimet Sociale dhe Shoqëria Civile, diskutuan sfidat që përballen në koordinimin e rasteve, si dhe kostot që secili institucion duhet të buxhetojë për adresimin e nevojave që viktimat e dhunës kanë. “Kosto e dhunës në qytetin tënd” është një fushatë kombëtare, iniciuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara, UN Women, e cila shtrihet përgjatë një dite, në të gjitha Bashkitë kryesore të vendit, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe strukturave qeverisëse, mbi koston që viktimat apo të dëmtuarit nga dhuna me bazë gjinore, kanë për ekonominë lokale dhe atë kombëtare.

4.Gjatë ditëve të dhunës 25 Nëntor-10 Dhjetor 2015 janë organizuar aktivitetet:

- Takime me antarë të komunitetit dhe përfaqësues të RKK pranë 5 njësive Administrative përkatësisht: Manëz, Rrashbull, Katund i Ri, Sukth dhe Ishëm. Në këto takime kishte përfaqësues si: punonjës social edhe staf të njësive përkatëse, përfaqësues të Bashkisë Durrës, Drejtorisë së Shëndetit Publik, Qendrës për Zhvillimin Komunitar Sot për të Ardhmen. Në këto njësi u prezantua puna e bërë nga Bashkia përsa i përket menaxhimit të rasteve të dhunës dhe çështjeve të barazisë gjinore, për të treguar që funksionon një rrjet që do të ketë shtrirje edhe në këto njësi.
- U zhvilluan trajnime në tre gjimnazet e Durrësit: Leonik Tomeo, Gjergj Kastrioti dhe Naim Frashëri. Këto aktivitete u realizuan në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare për Shërbime Komunitare. Këto takime kishin në fokus të tyre informimin e të rinjve ndryshimet ligjore, rëndësinë e të jetuarit në një shoqëri të shëndosh. Në këto takime edhe aktorë të tjerë prezantuan rolin dhe funksionet në menaxhimin e rasteve .
- Vendosja e fjongos në Gjykatën e Durrësit ishte aktiviteti i radhës në kuadër të ditëve të dhunës, ku stafi i Qendrës për Zhvillim Komunitar, pranë cdo institucioni ka bërë të mundur vendosjen e kësaj fjongoje , simbol kundër dhunës.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjithashtu, u zhvillua një takim me gjyqtaret, me përfaqësues të Pushteti Qëndror, Pushtetit Vendor, Shoqërisë Civile edhe antarë të komunitetit.

- Në mbyllje të fushatës, përpara Bashkisë Durrës u vendos “Pema Portokalli” me mesazhe sensibilizuese, të cilat u lexuan nga burrat e institucioneve Publike. Gjatë aktivitetit pati një pjesëmarrje të gjërë nga institucionet qendrore, vendore dhe shoqëria civile.
5. Rastet e menaxhuara nga secili prej antarëve të Reagimit të Koordinuar, gjatë vitit 2015, janë:

Drejtoria Rajonale e Punësimit: në lidhje me mbështetjen e ofruar personave me rrezik të dhunës në familje ka realizuar këto të dhëna:

- a. Janë përfshirë në trajnimet që zhvillohen në Zyrën e Këshillimit për të rinjtë 7 persona
- b. Janë kandiduar dhe kanë ndjekur kurset profesionale në Qendrën e Formimit Profesional Publik 21 persona
- c. Janë kandiduar 7 punëkërkuues në rrezik të dhunës në familje dhe janë punësuar 2 persona
- d. Janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit 9 punëkërkuese të papuna femra.
- e. Janë përfshirë në programin “ Cikli i këshillimit” 3 punëkërkuese.

Spitali Rajonal Durrës: Rastet e trajtuara pranë këtij institucioni:

- a. janë trajtuar 2 raste pranë urgjencës, kanë qënë të seksit femër dhe të moshës 15-49 vjece, ndaj viktimave është ushtruar dhunë psikologjike.

Drejtoria e Shëndetit Publik:

- a. Pranë këtij institucioni numri i viktimave të dhunës në familje të paraqitura ka qënë 0, ndërkohë sa i përket bashkëpunimit, pjesëmarrjes në takimet e grupit apo aktivitete të ndryshme, institucioni i Shëndetit Publik me stafin e vet ka qënë gjithmonë aktiv.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Drejtoria e Policisë së Qarkut:

a. Janë evidentuar 741 raste të dhunës në familje më 741 autorë nga të cilat:

- 574 Kërkes-padi për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes me 574 autorë të cilët ndiqen në gjendje të lirë.
- 167 raste janë vepra penale me 167 autorë, nga të cilët 48 autorë janë arrestuar në flagrancë dhe 106 ndiqen në gjendje të lirë si dhe 13 janë shpallur në kërkim.

b. Nga rastet e kërkesë padive, rezulton se personat që kanë pësuar dhunë sipas marrdhënieve familjare janë si më poshtë:

- Në 269 raste është ushtruar dhunë ndaj bashkëshortës,
- Në 22 raste është ushtruar dhunë ndaj bashkëshortit,
- Në 17 raste është ushtruar dhunë ndaj motrës,
- Në 18 raste është ushtruar dhunë ndaj vëllait,
- Në 28 raste është ushtruar dhunë ndaj fëmijës,
- Në 76 raste është ushtruar dhunë ndaj prindit,
- Në 144 raste kanë lidhje familjare.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës

Për 6-mujorin e parë të 2015 nga ky institucion janë dhënë 253 vendime të UMM. Raste të cilat janë menaxhuar gjatë 3-mujorit të parë janë 127 dhe 3-mujorit të dytë 133 raste. Nga këto:

- 212 raste dhunë në qytet
- 34 raste në periferi
- 14 në fshat
- 14 raste prej tyre janë raste dhune të përsëritura

Prokuroria e Rrethit Durrës:

Nga ky institucion për 6 mujorin e parë të 2015 janë regjistruar:

- 45 procedime Penale
- 43 Persona nën hetim
- 3 persona me masën detyrim paraqitje
- 17 persona të arrestuar

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

- 30 procedime janë dërguar për Gjykim, nga këto 16 persona gjykata ka dalë më një vendim, 12 janë nën hetim.

Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”:


Ofron mbështetje psikologjike nëpërmjet:

1. Numrit të Gjeltër 08009888.
2. Këshillimin Juridik ballë për ballë për të gjitha viktimat.
3. Këshillimin Psikologjik ballë për ballë për të gjitha viktimat e Dhunës në Familje, të dhënat përkatëse për këto shërbime janë si më poshtë:

- Rastet e mbështetura nëpërmjet Numrit të Gjeltër **08009888** janë 245 telefonata në total të klasifikuara si më poshtë:
 - **114** telefonata për këshillim (telefonata ku ofrohet këshillim psikologjik për viktimat e dhunës në familje)
 - **95** telefonata për informacion (Telefonata ku kërkohet informacion mbi shërbimet e ofruara nga numri i gjeltër apo mbi çështje të tjera në lidhje me dhunën në familje)
 - **11** telefonata për arsye “të tjera” (Në këtë kategori hyjnë ato telefonata qëllimi i të cilave nuk mund të përmbushet nga numri i gjeltër)
 - **25** telefonata testuese (Në këtë kategori hyjnë telefonatat e heshtura etj)

- **Mbështetje juridike dhe psikologjike ballë për ballë**

Viktima të dhunës në familje me mbështetje juridike e psikologjike janë 49 raste.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Shërbimet për fëmijët

Bashkia Durrës ka pasur gjithnjë një vëmendje të vecantë ndaj respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve. Në këtë kuadër që nga viti 2008 në Bashki funksionon zyra për “Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Problematikat më të hasura që trajtohen nga kjo zyrë në shërbim të fëmijëve janë:

1. Fëmijë me aftësi të kufizuar.
2. Fëmijë të braktisur dhe të rrugës.
3. Fëmijë që punojnë.
4. Fëmijë të trafikuar.
5. Fëmijë të dhunuar në familje, shkollë dhe komunitet.
6. Fëmijë të pa rregjistruar nga lindja.

Gjatë vitit 2015 në Zyrën për Mbrojtjen e Fëmijëve janë menaxhuar 43 raste, nga të cilat 35 janë raste të reja, për të cilët janë hapur dhe dosjet përkatëse.

1. Numri i rasteve të reja paraqitet si më poshtë të specifikuara sipas:

Grupmoshës			Gjinisë		Etnisë		
0-6 vjec	7-14 vjec	15-18 vjec	Femra	Meshkuj	Rom	Egjiptian	Të tjere
10	22	3	20	15	16	6	13

2. Për vitin 2015, numri i rasteve të mbyllura është 0. Në rastet e mbyllura përfshihen:

- Kur fëmija është mbi 18 vjec
- Kur ndërhyrjet e ndërmara e kanë reduktuar nivelin e rrezikut
- Kur fëmija vdes
- Kur fëmija transferohet në një zonë tjetër.

3. Numri i rasteve të fëmijëve sipas nivelit të rrezikut në situata emergjente të menaxhuara nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve për vitin 2015 janë:

- I mesëm 21 raste
- I lartë 18 raste.
- Emergjent 4 raste

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

4. Numri i vizitave të kryera në familje është 36.
5. Numri i fëmijëve të referuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve në struktura të tjera është 5 raste.
6. Rastet sipas problematikave janë:
 - dhunë në familje 5 raste
 - fëmijë në situatë rruge 15 raste
 - probleme ekonomike 14 raste
 - dhunë seksuale 1 rast
 - sistemim në institucion 6 raste
7. Sipas llojit të abuzimit janë:
 - Abuzim fizik 5 raste
 - Abuzim seksual 1 rast
 - Abuzim psikologjik 2 raste

Gjatë vitit 2015, grupi teknik multidisiplinor është mbledhur çdo muaj për të trajtuar rastet. Problematikat më të shumta, hasen gjatë implementimit të planit të veprimit për fëmijët në situatë rruge, sepse për trajtimin e këtyre rasteve, nuk ofrohen shërbime specifike dhe aktorët e grupit e kanë të vështirë të hartojnë një plan veprimi. Gjithashtu, akoma më e vështirë është trajtimi dhe hartimi i një plani pune për rastet që vijnë nga qytetet e tjera.

Aktivitetet dhe veprimtaritë e tjera të zhvilluara gjatë vitit 2015 kanë qenë:

- Fushatë dhe punë në terren në kuadër të planit: “Në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge.
- Organizimi i aktivitetit me rastin e 1 Qershorit në të cilën morën pjesë fëmijë nga komunitet vulnerabel dhe u promovuan të drejtat e fëmijëve dhe rëndësia e tyre .
- Organizimi i aktivitetit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve me 20 Nëntor, ku fëmijët e qytetit u takuan me Kryetarin e Bashkisë Durrës.
- Takimi ndërinstitutional, në kuadër të zbatimit të planit kombëtarë të veprimit: “Ndhmë për familjet dhe fëmijët në situatë rruge” organizuar nga Bashkia Durrës me mbështetjen e Agjensisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

- Takime me përfaqësuesit e institucioneve lokale si dhe OJF-ve, në kuadër të implementimit të projektit të USAID “Të bashkuar kundër trafikimit të fëmijëve”.
- Vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, UNICEF, Terre des Hommes dhe Maestral International.

Në shërbim të fëmijëve të qytetit të Durrësit krahas zyrës për: “Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” bashkëpunues është dhe Shtëpia e Fëmijës Durrës.

Shtëpia e Fëmijës Durrës



Eshtë një tjetër Institucion që mbështetet nga Bashkia Durrës. Shtëpia e Foshnjës Durrës ka filluar të funksionojë si e tillë që në vitin 1957. Nga viti në vit cilësia e shërbimit ka pësuar ndryshime progresive si në strukturë ashtu edhe në cilësinë e shërbimeve për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të abandonuar.

Në vitin 1997 shoqata “Hope and homes for children” në kuadër të decentralizimit, ka kontribuar për rikonstruksionin e godinës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Cështjeve Sociale kanë bërë të mundur ndryshimin dhe ristrukturimin e godinës në Shkozet për të qenë më afër standarteve bashkëkohore. Në vitin 2005 Shërbimi Social Shtetëror ka miratuar dhe dy shërbime të tjera në ndihmë të komunitetit.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Qëllimi i këtij Institucioni është jo vetëm trajtimi i fëmijëve, integrimi i tyre në shoqëri, por birësimi i fëmijëve, kthimi i tyre pranë familjeve biologjike, kur është e mundur gjetja e një vatre të ngrohtë familjare për fëmijët e braktisur.

Ky institucion, ofron tre shërbime:

- Shërbime 24 orë për fëmijët rezidencial të moshave 0-6 vjec
- Qendër Ditore për fëmijët 3-6 vjec nga familjet më vulnerabël të zonave rurale të Durrësit
- Shërbimi i Mbështetjes në Familje

-Në shërbimin rezidencial (shtëpi-familje), trajtohen, fëmijët që vijnë nga lindjet jashtë martesore, jetim biologjik, jetim social dhe fëmijë të braktisur në maternitet.

-Qendra ditore trajton fëmijët që vijnë nga familje vulnerabël të qytetit të Durrësit me probleme të mëdha social-ekonomike, fëmijë me një prind, fëmijë të komunitetit rom, familje numerozë, vajza-nëna.

-Shërbimi i Mbështetjes në familje, ka për qëllim, të ndihmojë fëmijët në distancë, duke i ofruar atyre mbështetje psikologjike, sociale dhe ekonomike.



Të rrisim dhe edukojmë fëmijë të shëndetshëm dhe të lumtur

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Objektivat kryesore jane :

- Parandalimi i Institucionalizimit të fëmijëve
- Mirërritja dhe edukimi i fëmijëve
- Kthimi në familje biologjike
- Përkujdesje Shëndetsore
- Advokacia (Per mbrojtjen e femijeve)
- Birësimi


Ky i fundit si alternativa më e mirë e mundshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës.

Institucioni ka një staf prej 28 punonjësish.

Personeli i shtëpisë së fëmijës, është një staf i trainuar në fushën e shërbimeve sociale për një shërbim sa më të mirë dhe efikas për fëmijët.

Pamje nga shërbimet në Shtëpinë e Fëmijës

Fëmijët Rezidencial



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Shërbimi mbështetës i familjes



Pamje nga Festa e 20 Majit-Dita Kombetare e Femijeve Jetim, ne Qendren Ditore



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Qendra Komunitare Multifunkionale – Nishtulla



Qendra Komunitare Multifunkionale - Nishtulla, është një qendër, e cila ka hapur dyert e saj për grupet në nevojë, në Nëntor të vitit 2013, në zonën e Nish tullës-Durrës.

Kjo qendër ka si qëllim të përmirësojë aksesin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në shërbimet sociale nëpërmjet regjistrimit civil, përfshirjes në kurse profesionale si dhe vendosjes dhe forcimit të rrjeteve të mediatorëve Romë në fushën e shëndetit, arsimit, mbrojtjes së fëmijëve .

Kjo qendër, synon të përmirësojë cilësinë e jetës të grupeve në nevojë, nëpërmjet fuqizimit të komunitetit në tërësi dhe integritetit të tij në jetën e qytetit, duke ofruar shërbime të ndryshme si dhe duke krijuar mundësinë për më shumë ndërveprime mes banorëve dhe institucioneve.

Shërbimet që ofron kjo qendër janë:

- Shërbimin shëndetësorë përfshirë (shërbimin pediatrik dhe konsultorin e fëmijës, injeksione dhe shërbimet patologjike të përgjithshme)
- shërbimin psikosocial (fëmijë, të rinj, gra dhe të moshuar)
- shërbimet me bazë zhvillimin dhe integritetin e komunitetit të marxhinalizuar përfshirë, informim , ndërmjetësim dhe advokasi për formime të ndryshme profesionale.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

- Fuqizimi i të rinjve dhe pjesëmarja e tyre në proceset politike dhe vendimarrëse
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet lokale/vendore dhe OJF të ndryshme midis institucioneve dhe komunitetit
- Ofrimi i mundësive për aktivitete argëtuese
- Ndërmarja e fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere të ndryshme mbi të drejtat e njeriut dhe mobilizimin e komunitetit
- Advokasi, lobim dhe ndërmjetësim për probleme të ndryshme të komunitetit;

Përfituesit:

- Të rinjtë që kanë nevojë për t'u integruar dhe që kanë dëshirë për të qënë aktiv dhe për të sjellë ndryshime pozitive në komunitetin e tyre.
- Fëmijët me probleme të ndryshme sociale dhe shëndetsore;
- Nënata e reja dhe gratë në përgjithësi që kanë nevojë për shërbime shëndetsore dhe suport psiko-social.
- Komuniteti Rom dhe Egjyptian i zonës së Nishtullës në tërësi.

Aktivitete dhe veprimtari specifike

Gjatë vitit 2015, kjo qendër ka organizuar këto aktivitete:

Shkurt 2015:

-Qendra Komunitare MultifunkSIONALE-Nishtulla dhe Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, me mbështetjen e Organizatës Terre des Hommes, organizuan aktivitetin mbi Vullnetarizmin, me studentë nga Fakulteti i Edukimit. Ky aktivitet kishte si qëllim përcjelljen e ndjesive dhe modeleve pozitive mbi punën vullnetare, lehtësimin e praktikave studentore në vazhdimësi, si dhe krijimin e një grupi vullnetarësh nga studentët e UAMD, bazuar në dëshirat dhe vullnetin e tyre të lirë, për të kontribuar në komunitete me probleme të ndryshme sociale.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE



-Instituti i Kulturës Rome në bashkëpunim me Qendrën Komunitare në Nishtulla, organizuan aktivitetin "Nxitja dhe Përfshirja e të rinjve Rom në Art dhe në Arsim"



Mars 2015:

-U organizua pranë Qendrës Komunitare Multifunksionale Nishtulla, tema e trajnimit: “Mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve” me grupin e studentëve vullnetarë, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE



-Qendra komunitare Multifunktionale Nishtulla, në bashkëpunim me Programin e OKB/UNDP dhe MMRS, organizuan tryezën e rrumbullakët me temën: “Rritja e aksesit të grave rome dhe egjiptiane në shërbimet sociale”,

Në këtë takim ishin prezent dhe përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Durrës, Organizatat Terre des Hommes dhe Shoqata e grave me Probleme Sociale, ku prezantuan punën dhe politikat e ndjekura për facilitimin e aksesit të këtij komuniteti në shërbime.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Prill 2015:

-Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, Qendra Komunitare Multifunktionale, në bashkëpunim dhe me organizata Rome apo që kanë si fokus të tyre komunitetin Rom, organizuan në Pallatin e Kulturës “Aleksandër Moisiu”, konferencën multitematike: “Integrimi dhe fuqizimi Rom, histori, akses në të drejta dhe promovim Kulturor”



Maj 2015:

-Qendra Komunitare Multifunktionale, në kuadër të Javës së Familjes dhe në bashkëpunim me një sërë partnerësh të tjerë, organizuan me dt. 08. Maj 2015 në zonën e Nishtullës, aktivitetin sensibilizues-ndërgjegjësues: "Mbrojtja dhe Lumturia fillon në Familje".



**MBROJTJA
FILLON NË
FAMILJES**

Bashkohu me ne nesër me 08 Maj 2015 ora 13:00, në Nishtulla, përball me shkollën 9-vjecare "Isuf Ferra", të promovojmë së bashku vlerat e FAMILJES!

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Në kuadër të shkollës "Qendër Komunitare", nxënësit e gjimnazit "Gjergj Kastrioti" në Durrës në bashkëpunim me Qendrën Komunitare Multifunksionale, organizuan aktivitetin "Nxënësit për komunitetin". Gjatë këtij aktiviteti nxënësit diskutuan me prindër dhe fëmijë të zonës, për edukimin dhe shkollimin e fëmijëve të tyre. Falë iniciativës së tyre humane, nxënësit shpërndanë disa dhurata të përgatitura nga vetë ata për familjet që kishin më shumë se një fëmijë në shkollë.



-Takime në qendër me Kryetarin e Bashkisë, të rinjëve, fëmijëve dhe komunitetit, me fokus: problemet që shqetësojnë banorët e grupmoshave të ndryshme, kërkesat e tyre dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor, si dhe kontributin e përbashkët për një jetesë dhe të ardhme më të mirë.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Qershor 2015:

Qendra Komunitare Multifunkionale organizoi Koncertin e bamirësisë "Melodia e Shpresës, Kontribuo edhe ti!", në bashkëpunim me Rexhino Lufta and Band; Qendra Kulturore e Fëmijëve, Durrës; Kolegji Turgut Ozal dhe bashkëpunëtorë të tjerë



"Si të kujdesemi për lulet dhe si ta mbajmë mjedisin sa më pastër". Kjo temë kishte si qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve që të kujdesen për mjedisin e tyre ku jetojnë, luajnë dhe shkollohen si dhe të jenë miq të ngushtë të luleve.



Me rastin e 12 Qershorit, Ditës Botërore Kundër Punës së Fëmijëve, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Bashkinë Durrës, Drejtorinë Rajonale Durrës, dhe Qendrën Komunitare Multifunkionale organizuan në Rrugën Tregtare "Egnatia" Durrës, marshimin nën moton "Jo punës dhe shfrytëzimit të fëmijëve, po arsimit cilësor".

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Fëmijë të moshave të ndryshme dhe nga shkolla të ndryshme të qytetit të Durrësit së bashku me vullnetarë të tjerë iu bashkuan këtij marshimi nëpërmjet pikturave të realizuara nga ata vetë, fletë palosjeve, pankartave që përcillnin mesazhe ndërgjegjësuese, referuar shfrytëzimit dhe punës së detyruar të fëmijëve.



Gjatë mbrëmjes së bamirësisë, autoritete të larta lokale dhe qendrore, dhuruan donacione për fëmijët në situatë rruge në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Punës dhe Shfrytëzimit të Fëmijëve. Aktiviteti u organizua nga Bashkia Durrës (QKMN, NJMF), mbështetur nga USAID, Terre des Homes, Agjensia Kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe Hotel Palace.



Grupi i vajzave praktike/vullnetare pranë Qendrës Multifunktionale në Nishtulla, mundësuan për fëmijët që frekuentojnë qendrën, realizimin e një feste surprizë me tullumbaca, ëmbëlsira etj. Kjo mbështetje erdhi si kontribut i disa të rinjëve nga qyteti i Aostas në Itali, ku falë një bashkëpunimi, të rinjtë mbuluan të gjitha shpenzimet e kësaj feste.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE



Korrik 2015:

“Dreka shijohet më shumë kur hamë bashkërisht”. Qëllimi i aktivitetit ishte afrimi më i madh i komunitetit me qendrën, njohja e tyre me studentët dhe shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme.



Kampi Veror: “Keep Calm and Love It”, ku pjesë ishin aktivitetet në qendër, eskursionet, lojra të ndryshme argëtuese dhe plazhi me rreth 60 fëmijët e zonës së Nish Tullës dhe vullnetarë.




NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Gjatë muajit Korrik, stafi i qendrës, së bashku me vullnetarët e qendrës, ka qenë pjesë e skuadrave të terrenit për identifikimin dhe intervistimin e fëmijëve në situatë rruge, në zona të ndryshme dhe të nxehta të qytetit. Rastet e identifikuara dhe që janë nga zona e nishtullës, nga kontaktet e mara do të afrohen në qendër dhe do të mbështeten me ndihma ushqimore si dhe në bazë të nevojave do të shihet mundësia për ndërmjetësim, punësim dhe strehim.



Tetor 2015:

"Info Point" për ndergjëgjësimin e qytetarëve në Luftën Anti-Trafik. "Asnjë fëmijë në rrugë për punë dhe lypje". Stop, trafikimit të qenieve njerëzore!



Qendra Komunitare Multifunktionale mirëpriti disa miq nga Organizata Terre des Hommes në Afrikë, për të shkëmbyer eksperiencë profesionale lidhur me shërbimet psiko-sociale si dhe metodologjinë e përdorur në punën me fëmijët dhe komunitetin.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE



Nentor 2015:

Me rastin e mbylljes së muajit anti-trafik, muaji Tetor, në Qendrën Komunitare Multifunkionale Nishtulla, në bashkëpunim me Organizatën Terre des hommes, Shkollën 9-vjecare Isuf Ferra, përfaqësues nga Zyra Rajonale e Punësimit Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Durrës, Njësisë së Mbrotjes së Fëmijëve dhe përfaqësues së YWCA për Durrësin, u organizua aktiviteti përmbyllës me tematikë: "Stop trafikimit të qenieve njerëzore"!



-Takim me përfituesit e programit të Gjenerimit të të Ardhurave, mbi ngritjen e "bizneseve" nga vetë banorët e zonës dhe mbështetur nga Organizata Terre des hommes Albania & USAID.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Dhjetor 2015:

"Të drejtat tona = Lumturia jonë" aktivitet ky, i organizuar me shkollën 9 vjecare I. Ferra Nish Tulla, Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Qendrën Komunitare Multifunksionale Nishtulla, Bashkia Durrës për të folur me nxënësit mbi rëndësinë që kanë të drejtat, respektimi i tyre si dhe roli i institucioneve, ku fëmijët mund të kërkojnë mbrojtje ndaj shkeljes së të drejtave.



Me rastin e festave të fundvitit, vajzat vullnetare dhuruan për fëmijët frekuentues të qendrës, rroba dhe lodra për ti bërë ata sa më të lumtur!



Festat e fundvitit "Festojmë së bashku", organizuar nga Qendra Komunitare Multifunksionale për anëtarët e komunitetit Rom, prindërit dhe fëmijët.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Qendra Komunitare, me rastin e festave të fundvitit dhuroi për familjet më në nevojë të komunitetit Rom, 60 pako me ushqime, me qëllim që dhe ata të kenë mundësi të festojnë si të gjitha familjet. Këto pako ushqimore u mundësuan nga “Misioni pa Kufi”.



Shërbimet që ofron kjo qendër janë:

- Shërbimin shëndetësorë përfshirë (shërbimin pediatrik dhe konsultorin e fëmijës, injeksione dhe shërbimet patologjike të përgjithshme)
- shërbimin psikosocial (fëmijë, të rinj, gra dhe të moshuar)
- shërbimet me bazë zhvillimin dhe integrimin e komunitetit të marxhinalizuar përfshirë, informim , ndërmjetësim dhe advokasi për formime të ndryshme profesionale
- Fuqizimi i të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në proceset politike dhe vendimarrëse
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet lokale/vendore dhe OJF të ndryshme midis institucioneve dhe komunitetit
- Ofrimi i mundësive për aktivitete argëtuese
- Ndërmarrja e fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere të ndryshme mbi të drejtat e njeriut dhe mobilizimin e komunitetit
- Advokasi, lobim dhe ndërmjetësim për probleme të ndryshme të komunitetit;

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Aktivitetet dhe veprimtari ditore në qendër

Workshope me tematika të ndryshme



Diskutime të lira me grupin e të rinjëve mbi kurset e reja dhe mënyrën e funksionimit të tyre



Mbështetje edukative dhe suport në përgatitjen e detyrave dhe mësimëve me fëmijët.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Lojra të ndryshme sportive dhe argëtuese si pjesë e aktivitetit ditor të qendrës



Kursi i gjuhës angleze për dy grupmosha të ndryshme



Kursi muzikës i cili zhvillohet 3 herë në javë, për fëmijët që janë frekuentues të Qendrës Komunitare Multifunkionale nga 2 profesorë shumë të talentuar, Rexhino dhe Shaban Lufta.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE


Pjesë e programit të Qendrës Komunitare Multifunkionale në Nishtulla, janë edhe prindërit. Ata vazhdimisht janë pjesë e aktiviteteve duke bërë të mundur punën paralele me fëmijët dhe prindërit njëkohësisht. Pjesë e pandarë është dhe programi për Prindërimin e mirë, program ky, i iniciuar dhe mbështetur nga organizata Terre des Hommes. Fotot janë mbi Sesionin I, mbajtur në qendër me tematikë: Prindërimi i mirë".



Takime konsultative me anëtarët e zonës së Nish Tullës për të diskutuar mbi nevojat, sfidat dhe mundësitë, me qëllim zhvillimin e aktiviteteve me karakter informues dhe ndërgjigjësues.



Shërbime mjekesore të përgjithshme dhe eko zemre në qendrën shëndetsore në nishtulla, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik Durrës dhe mbështetjen e kardiologes Klodiana Spahiu që dhuroi aparaturën e ekos dhe kryerjen e vizitave prej saj, për komunitetin.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Trajnime dhe kualifikime të stafit

Shkurt 2015:

Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit dhe Caritas Shqiptar, zhvilluan në Durrës workshopin me temë: “Forcimi i kapaciteteve të strukturave shtetërore në mbrojtje të viktimave të trafikimit të personave”.



Trajnimi mbi "Ngritjen dhe mirëfunksionimin e modelit të shërbimeve psiko-sociale pranë Qendrave Komunitare", mbështetur nga Organizata Terre des Hommes Albania.



Mars 2015:

Në vijim të punës, për Planin e Veprimit për Fëmijët në situatë ruge, në qytetin e Durrësit, me mbështetjen e MMRS, Ministrisë së Brendshme, Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e fëmijëve, Organizatës Arsis dhe Bashkisë Durrës, u organizua workshopi në nivel specialistësh me temë: “Puna me Fëmijët në Situatë Ruge dhe Udhëzuesi Procedural për Identifikimin, Ndhmën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Ruge”.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE




Tetor 2015:

"Trafikimi i fëmijëve" Rritja e kapaciteteve të KRAT në adresimin e trafikimit të fëmijëve, organizuar nga Terre des Hommes në Hotel Mondial, Tiranë.



Në vijim të aktiviteteve të muajit antitrafik Institucioni i Prefektit në bashkëpunim me organizatën Terre Des Hommes dhe USAID organizuan tryezën e përbashkët me temë: “Trafikimi dhe mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve”. Të ftuar për të shkëmbyer eksperiencë ishin përfaqësues të TDH nga Afrika e veriut, Hungaria dhe Zvicra.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Qendra Komunitare Multifunkionale-Bashkia Durrës, edhe këtë vit ishte pjesë mbështetëse e fushatës së Parandalimit dhe Ndërgjegjësimit të Kancerit të Gjirit, mbështetur nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës dhe shumë partnerëve të tjerë.



Nentor 2015:

"Aktivizmi i organizatave me bazë komunitare dhe roli që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe grupeve që përfaqësojnë", organizuar nga Shërbimi Ligjor Tiranë, me mbështetjen e Civil Rights Defenders.



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Kujdesi ndaj moshës së tretë (Qendra Ditore e të Moshuarve)

Qendra Ditore e të Moshuarve, ushtron veprimtarinë e saj që nga viti 2002. Ajo ka si synim dhënien e shërbimeve sociale për të moshuarit e vetmuar dhe me probleme sociale në moshë pensioni dhe koordinon me zyrën e shërbimeve sociale në Bashkinë e Durrësit aktivitetin e saj të përditshëm për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Misioni i Qendres është ofrimi i shërbimeve sipas standarteve bashkohore, evidentimi dhe plotësimi i nevojave bazë të të moshuarve, respektimi i të drejtave, përmirësimi cilësisë së jetës dhe integrimi në shoqëri me qëllim shmangien e përjashtimit social.

Qendra Ditore e të Moshuarve ka arritur ta implementojë me sukses konceptin e vizionit dhe misionit të saj të menaxhimit, që nënkupton:

- Shërbimet t'ia ofroj sa më afër të moshuarve
- Shërbimet të jenë cilësore dhe të shpejta sipas standarteve bashkohore.

Kjo qendër ofron falas për perfituesit e saj:

- Shërbim psiko-social
- Shërbim shëndetësor
- Vakte ushqimore (2 vakte ne dite)
- Qendër informacioni
- Aktivitete kulturore, psiko-sociale

Institucioni aktualisht frekuentohet nga 109 të moshuar nga të cilët 56 gra dhe 53 burra.

Gjatë vitit 2015, kërkesat për antarsim në Qendër janë rritur mesatarisht 5-6 kërkesa cdo muaj dhe vendet bosh janë plotësuar menjëherë duke bërë që Qendra të punojë me kapacitet të plotë.

Gjatë vitit 2015 janë bërë : 17 pranime, 6 largime dhe 8 raste vdekje.

Mbështetje psiko-sociale

Në këtë qendër shërbejnë 4 punonjës social. Aktualisht planet individuale të të moshuarve janë hartuar së bashku me të moshuarit dhe punonjës social përgjegjës.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Cdo punonjës social ka një grup prej 27 të moshuarish në kujdesje. Puna e cdo punonjësi social konsiston në:

- Interesimin për të moshuarit në raste mungesash cdo ditë
- Verifikimin në familje për të vlerësuar kushtet social-ekonomike
- Organizimin e takimeve me grupe të moshuarish me qëllim njohjen e problematikave. Këto problematika janë ndjekur dhe rezultatet e arritura i janë shënuar në cdo plan individual.
- Referimin e rasteve të vecanta tek mjeku apo infermieri
- Monitorimin gjatë përgatitjes dhe servirjes së ushqimit për të moshuarit
- Biseda në grup me të moshuarit për çështje të ndryshme

Shërbim mjeksor

Në këtë qendër shërbejnë një infermiere dhe një mjek part-time. Gjatë kësaj periudhe të gjithë të moshuarit kanë përfituar shërbim mjeksor. Në regjistrin e shërbimit mjeksorë regjistrohen të gjitha rastet e dhënies së ndihmës mjeksore dhe cdo i moshuar është i pajisur me kartelën mjeksore personale. Ky shërbim përfshin:

- Vizita mjeksore, diskutime mbi tema të ndryshme mbi shëndetin
- Matje TA
- Injeksione
- Mjekime

Ushqim (caj dhe dreka)

Gjithashtu, në këtë qendër shërbejnë një kuzhinierë dhe një ndihmës kuzhinierë. Të moshuarit kanë përfituar 100% fondin e tyre ushqimor. Të moshuarve i ofrohet pirja e kafes ose cajit në mëngjes dhe dreka. Dreka përgatitet në bazë të menisë javore e cila afishohet cdo fillim jave. Në hartimin e menisë mbahen parasysh sygjerimet e mjekes dhe mendimet e të moshuarve. Këto vakte merren sipas orarit të caktuar nga Qendra: mëngjesi në orën 10:00-10:30 dhe dreka 12:00-13:30.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Shërbim sanitar

Qendra ka një nivel të mirë hapsirash, pajisjesh dhe mundëish për të ofruar shërbime. Ambjenti i Qendrës është funksional me drita, ujë të rrjedhshëm dhe ngrohje për të moshuarit. Për higjenën e Qendrës kujdesen 2 sanitare.

Aktivitetet social-kulturore brenda dhe jashtë institucionit dhe shërbimet e ofruara në këtë Qendër Ditore gjatë vitit 2015 janë:

- Organizimi i sesioneve psiko-sociale individuale ose në grup me përfituesit.
- Sigurimi i kontrollit mjekësor mujor për të gjithë përfituesit
- Doktor i qendrës organizon sesione informative shëndetësore bazuar në kërkesat dhe nevojat e përfituesve.
- Organizimi i aktiviteteve ditore të integritetit dhe kreative brenda qendrës ditore, ku, grupe të caktuara kulturore krijohen në bazë të interesave dhe prirjeve të të moshuarve si grupi i shahut apo grupi letrar etj.
- Të moshuarit festojnë së bashku ditëlindjet, festat tradicionale të cilat shoqërohen edhe me dhurata dhe koncerte.
- Të moshuarve ju ofrohet kafe, çaj, dreka , shtyp i ditës.
- Janë trajtuar tema të ndryshme sociale me të moshuarit e institucionit.

Qendra Ditore e të Moshuarve feston të gjitha festat zyrtare dhe jo zyrtare sipas një kalendari vjetor të festave. Disa nga aktivitetet argëtuese të realizuara në qendër gjatë vitit 2015 janë:

- Qendra është vizituar shpesh nga vullnetarë si dhe nga studentë të cilët kërkojnë të bëjnë praktikë në QDM. Këta vullnetarë, përveç bisedave me të moshuarit për t'i njohur më nga afër, kanë organizuar dhe lojra e aktivitete të ndryshme brenda qendres si: Dita e filmit, kampionati i dominosë, muzikë në Qendër etj.
- Vajzat e grupit Reyhan vizitojnë shpeshherë të moshuarit dhe realizojnë aktivitete të ndryshme argëtuese si dhe disa herë kanë sjellë për të moshuarit disa ushqime suplementare, të cilat kanë pasuruar menunë e Qendrës si: byrek, fruta dhe lëngje frutash.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

- Qendra është vizituar edhe nga nxënësit e Shkollës jo Publike “Kasa”, të cilët kryejnë studime profesionale në degën Infermieri, ku janë njohur me problematikat e gjithë sejcilit prej të moshuarve.
- Është festuar 8 Marsi ku Grupi rinor i FRESH- Durrës, solli ëmbëlsira, pije freskuese dhe lule për të moshuarat.
- Janë organizuar aktivitete festive me rastin e 28 – 29 Nëntorit, Dita e Pavarësisë dhe Festa e Flamurit, në bashkëpunim me nxënësit e shkollave, të cilët dhanë një shfaqje për të moshuarit dhe shpërndanë pako ushqimore për ta.
- Gjithashtu një grup të rinjsh amerikan organizuan koncert për të moshuarit dhe i dhuruan nga një shampo dhe një libër për Qendrën.
- Studentë norvegjezë kanë vizituar Qendrën dhe të moshuarit, dhe janë njohur me problematikat e tyre.
- Gjithashtu janë shpërndarë 40 batanije nga një shoqate humanitare nga Katari.
- Qendra vizitohet shpesh nga përfaqësues të Kishës Ortodokse Durrës, ku për çdo festë fetare sjellin dhurata për të moshuarit.
- Në kuadër të festës së 1 Tetorit- Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, Qendra Ditore e të Moshuarve Durrës realizoi këto aktivitete:

-Në datën 1 Tetor u shtrua një drekë për të moshuarit në një nga restorantet e qytetit të Durrësit. Të moshuarit përvec se shijuan ushqimin dhe bregdetin u argëtuan duke kërcyer dhe u shoqëruar me njeri tjetrin. Ky aktivitet u mundësua nga Bashkia Durrës.

-Në datën 2 Tetor, Deputetja e Durrësit Znj. Esmeralda Shkja vizitoi të moshuarit e qendrës dhe i shpërndau lule dhe nga një pako për të gjithë të moshuarit.

- Aktivitet me përfaqësues të Drejtorisë së Shëndetit Publik me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Diabetit, i cili ka si qëllim informimin dhe sensibilizimin e komunitetit mbi këtë sëmundje që po prek njerëz të çdo moshe. Për këtë në ambientet e dhomës mjekësore të QDM-së u kryen ekzaminime falas për matjen e nivelit të glicemisë në gjak.

NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Gjithashtu u zhvillua edhe një seksion informues për parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje.

- Në kuadër të festave të Fundvitit, Qendra Ditore e të Moshuarve Durrës realizoi këto aktivitete:
 - Janë shpërndarë pako ushqimore për 110 të moshuarit të dhuruara nga Misioni Pa Kufi.
 - Janë shpërndarë pako ushqimore nga vetë Qendra.
 - Nga Ferra & Co, janë shpërndarë cdo vit 110 pako sheqer për të moshuarit.
 - Nga **Peta Tetova** janë dhuruar 110 pako peta për të moshuarit.
 - Të moshuarit janë vizituar gjithashtu nga përfaqësues të Kishes Ortodokse Durrës të cilët sollën caj dhe biskota për një ditë ndryshe me të moshuarit.
 - Eshtë festuar dita e Pashkëve Ortodokse duke iu shpërndarë të moshuarve nga një pako ushqimore nga vetë qendra.
 - Po me rastin e kësaj feste të moshuarit janë vizituar nga përfaqësues të Kishës Ortodokse të Durrësit, të cilët shpërndanë vezë të kuqe, molto, kafe, sheqer për të moshuarit.
 - Bashkëpunime të vazhdueshme ka patur edhe me Qendrën TIC, e cila ofron përkrahje dhe mbështetje për grupet në nevojë. Në kuadër të festave të fundvitit, vullnetarët dhanë një shfaqje për të moshuarit dhe dhuruan zbukurime për pemën e Vitit të Ri.

Gjatë vitit Qendra e Formimit Profesional Durrës ka shtruar dy dreka për të moshuarit e QDM me rastin e diplomimit të kursanteve të degës kuzhinë.

Janë organizuar aktivitete jashtë QDM si shëtitje në plazh, vizitë në Pezë, vizitë në varrezat e Dëshmorëve Durrës, kafe në plazh dhe shtrimi i dy drekave në restorante.

Një mënyrë jetese e përshtatëshme, përfshirja në familje dhe shoqëri, mjedisi mbështetës për një moshë të kaluar, të gjitha këto ruajnë mirëqënien. Politikat e QDM synojnë pakësimin e pabarazive sociale dhe varfërinë, që janë thelbësore për plotësimin e mbështetjes së individit drejt plakjes aktive. Hartimi i programeve ndër-breznore dhe aktiviteteve komunitare mundësojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe pjesëmarrje të barabartë mes brezit të ri dhe të të moshuarve që është dhe një nga synimet e kësaj qendre. Më poshtë janë paraqitur disa pamje nga aktivitetet e Qendrës Ditore të të Moshuarve.

NDIHMJA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pamje nga aktivitetet e Qendrës Ditore të Moshuarve



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pamje nga aktivitetet e Qendrës Ditore të Moshuarve



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pamje nga ambjentet e Qendrës Ditore të Moshuarve



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pamje nga aktivitetet e Qendrës Ditore të Moshuarve



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET SOCIALE

Pamje nga aktiviteti i Dites Nderkombetare te Diabetit



Pamje nga aktiviteti i festave te fundvitit



NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

Për Aftësinë e Kufizuar.

Në qytetin e Durrësit vepron vetëm një qendër rezidenciale e sektorit publik për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar. Kjo mbulon sistemin arsimor dhe një pjesë shërbimesh për këtë kategori.

Në kuadër të Strategjisë Lokale për personat me aftësi të kufizuar, janë organizuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse me biznese lokale dhe shërbim ofrues.

Bashkia Durrës në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional ngritën disa grupe kursesh për personat me aftësi të kufizuar. Në vazhdimësi janë organizuar takime nëpër qendra pune dhe me përfaqësues biznesesh për të nxitur punësimin e kësaj kategorie.

Gjithashtu janë organizuar takime me donatorë për të nxitur ngritjen e një qendre multifunksionale informuese, orientuese e këshilluese për PAK dhe familjarët e tyre.

Tregues dhe aktivitete në shërbime sociale

Disa nga treguesit statistikorë gjatë vitit 2015 në drejtim të përkujdesjes shoqërore për grupet në nevojë për Bashkinë e re janë si më poshtë:

Viti 2015	Fondi gjithsej	
	Numri	Vlera ne leke
Invalid te pergjithshem	2846	249,458,652
Kujdestare	391	31,626,300
Te verber	751	93,410,543
Kujdestare	205	26,638,240
Paraplegjik	477	125,245,248
Kujdestare	477	103,198,100
Invalid pune	5209	166,073,600

Burimi i te dhenave: Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

- Për vitin 2015, për Bashkinë e madhe Durrës, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga shteti është 354 familje me fond page 19.208.368 lekë, ndërsa numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga Bashkia është 66 familje me fond page 2.527.500 lekë. Pra në total, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike për vitin 2015, është 420 familje me fond page 21.735.868 lekë.

INFRASTRUKTURA SHERBIME PUBLIKE

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Në infrastrukturën rrugore përfshihen ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimi i blloqeve të banimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

Fondet e shpenzuara për infrastrukturën rrugore të qytetit për vitin 2015, kapën vlerën faktike **1.109.216 mijë lekë ose 50.7%** të totalit të shpenzimeve të përgjithëshme. Ato renditen të parat në totalin e buxhetit faktik të vitit 2015 dhe rezultojnë 43 % më të larta se viti 2014. Kjo rritje vjen nga investimet.

Këto shpenzime përfshijnë fondet për funksionimin e Ndërmarrjes së Rrugëve, investimet që kryen Bashkia në infrastrukturën rrugore në të gjitha elementet e saj, si dhe fondet për infrastrukturën rrugore nga fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime paraqiten si më poshtë :

000/lekë

Programi i Infrastruktures Rrugore	Vlera faktike
Ndërmarrja e rrugëve	63.880
Shpenzime personeli	34.001
Investime	29.879
Bashkia Durrës	1.045.333
Studim projekttime	9.971
Investime	385.647
Investime nga Fondi Zhv. Rajoneve për infrastruktur. rrugore	649.715
TOTALI:	1.109.216

Ndërmarrja Rruga Durrës, zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e qytetit, në zonën e Spitallës, Plazhit dhe Shkozetit.

Nga kjo ndërmarrje për vitin 2015, është punuar për realizimin e shërbimeve publike sa më cilësore në të gjithë mjedisin urban të qytetit, në mirëmbajtjen e sipërfaqeve të rrugëve e trotuareve, në disiplinimin e sinjalistikës, përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve të brendëshme të lagjeve, në mirëmbajtjen e objekteve mbrojtëse e fortifikuese, në shërbimin dekorativ si dhe në mirëmbajtjen e ndricimit të linjave që përshkojnë rrugët e qytetit.

INFRASTRUKTURA SHERBIME PUBLIKE

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Shërbimi i Mirëmbajtjes është i organizuar në të gjithë sipërfaqen e rrugëve që ndërmarrja ka në administrim në rrugë, trotuare, sheshe dhe kuartalla, duke realizuar të gjitha hallkat e shërbimeve si: germime dherash, skarifikime, shtresa me inertet, hedhje rrafshim dhera, shtresë asfalti, furnizim vendosje riparime pllakash dhe bordura dhe shtrese betonimi të rrugëve.

Punimet e realizuara në infrastrukturën e qytetit për mirëmbajtjen e rrugëve për vitin 2015, është bërë në bazë të preventivave për çdo rrugë, ku do të kryhet ndërhyrje në sasi dhe në vlerë. Realizimi i këtyre punimeve, përfshin territorin nga Ura e Dajlanit deri në Spitallë. Punimet janë si më poshtë:

Punimet e mirëmbajtjes

Emertimi i proceseve	Sasia
Mirembajtje, meremetim e vendosje pllakash me sip.	1868 m2
Asfaltim i siperfaqes prej	13.230 m2
furnizim vendosje bordurash ne rruge me nje sip,	403 ml
Ngritje pusete	20 cope
Shtrese stabilizant	7.389m2
Prishje shtres betoni	259m2
Sperkatje me leng bituminoz	16.031m2
Skarifikim shtrese asfalti	9.602m2
Ndërtim kornize pemesh	13 cope
Shtrese betoni	2.100 m3
Germime dherash me mjete	606 m3
Transport dherash	606 m3
Shtrese e perpunuar me kuarc	160 m2
Hapje kanali	120 ml
Riparim kollona kufizuaese	41 cope
Shtrese granili	2.216 m2
Ndertim muri mbrojtës	17 m2

Gjithashtu, nga kjo ndërmarrje për vitin 2015 është punuar dhe nga **sektori i sinjalistikës** dhe në shërbimet e **vend strehimeve** si më poshtë:

INFRASTRUKTURA

SHERBIME PUBLIKE

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Sektori i sinjalistikës dhe shërbimeve në vendstrehime

Gjithashtu, nga kjo ndërmarrje për vitin 2015 është punuar dhe nga sektori i sinjalistikës dhe në shërbimet e vend strehimeve si më poshtë:

Punimet nga sinjalistika

Emertimi i proceseve	Sasia
Lyerje tabelash	130 m2
Vijezime stacion autobuzi dhe taksi (horizontale)	687 m2
Lyerje boje hidromat	1.268 m2
Lyerje me llak	120 m2
Lyerje me boje vaji	270 m2
F.V. Tabele dhe Riparime tabelash	70 cope

Punime në shërbime për vendstrehime

Emertimi i proceseve	Sasia
Hegje uji dhe pastrim në vendstrehime	5.530 m3

Sektori i Dekorit

Për vitin 2015, shpenzimet e përgjithëshme për dekorin e qytetit kapën vlerën 6.996 mijë lekë.

Sektori i Dekorit ka punuar në bazë të kalendarit festiv për realizimin me sukses të dekorit të qytetit për të gjitha festat. Punimet e kryera janë si më poshtë :

Punime të kryera për dekorin

Emertimi i proceseve	Sasia
Zhvendosje palma dhe shtylla ndricimi	166 cope
Zmontim lule dekorative nga shtylla ndricimi	114 cope
Zmontim vargje dekorative nga shtylla ndricimi	67 cope
Zmontim linje burim energjie	2500 ml
Punime ndihmese	300 ore

INFRASTRUKTURA

SHERBIME PUBLIKE

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Sektori i Ndricimit

Shpenzimet e pergjitheshme per mirembajtjene ndricimit rrugor per vitin 2015 kapen vleren 9.119 mije leke. Sektori i Ndricimit, ka realizuar gadishmerine teknike te mirembajtjes se sistemit te ndricimit dhe dekorit te qytetit si me poshte:

Punime te kryera nga sektori i ndricimit dhe dekorit

Emertimi i proceseve	Sasia
Shtrim linja tokesore dhe ajrore me kablllo te ndryshme	5.516 ml
Kontroll rrjeti ndricimi	1.328 ore
Riparim kuadri kryesor komandimi	35 cope
Zevendesim me llampa ndricimi	834 cope
Riparim i sistemit te ndricimit me zevendesim me koka ndricimi	169 cope
Perdorim autoklulle	446 ore
Betonim pusete elektrike	8 cope
Prerje shtylle	63 cope
Vendosje shtylle	6 cope
Montim spote	40 cope
Zmontim e riparim leshuesi	12 cope
Heqje pusetash plastike	26 cope
Zevendesim pakete elektronike	5 cope
Zevendesim drozeli	22 cope
Zevendesim rele komplet	10 cope
Zevendesim k/komandues automat	37 cope
Kontroll, riparim i pjesshem i shtyllave	59 cope
Heqje reklama ne shtylla	53 cope
Kontroll, riparim kuti lidhese shtylla	692 cope
Zevendesim fotoelement	12 cope
Kontroll pusete	8 cope
Zevendsim automati 25A	75 cope
Montim Drozeli	28 cope

Montim injector ndezes	6 cope
Zevendesim leshuesi	24 cope
Montim koke e re	18 cope
Zevendesim klema	45 cope
Zevendesim injektor	5 cope
Betonim pusete tub Sr. 32	41 cope
Montim boks komplet	3 cope
Hapje gropa tub plastik	1 cop
Shtrim linje toksore	564 ml
Pergatitje krah ndricimi	92 cope
Zevendesim automat 40	7 cope
Hapje grope, zevendesim tubi	5 cope
Zevendesim portollampe	3 cope
Kontroll rrjeti ndricimi	2.164 ore
Zevendesim spote	40 cope
Riparim shtylle	138 cope

Burimi të dhënave: Ndërmarrja e Rrugëve

Përsa i përket shpenzimeve për energjinë e ndricimit rrugorë për vitin 2015, kapën vlerën 71.673 mijë lekë.

Shpenzimet kapitale faktike të realizuara për përmirësimin e infrastrukturës rrugore të qytetit për vitin 2015 kapën vlerën **1.075.212 mijë lekë**. Nga këto **649.715 mijë lekë** janë investime nga Fondi Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën rrugore. Nga fondet e buxhetit të Bashkisë u realizuan **415.526 mijë lekë** investime.

Situata e këtyre shpenzimeve paraqitet si më poshtë :

- Për Ndërmarrjen e Rrugëve janë blerë 29.879 mijë lekë asfalto beton binder që janë përdorur për asfaltime rrugësh dhe për sinjalistikën rrugore.
- Objektet në proces nga viti 2014 janë gjithsej 14 në vlerën 487.730 mijë lekë të ndara :
-Fonde të mbartura nga 2014 në vlerën 271.514 mijë lekë .
-Fonde të celura në 2015 për financimin e plotë të 14 objekteve në vlerën 216.216 mijë lekë.

Këto objekte u financuan plotësisht sipas situacioneve faktike. Gjendja në Thesar nga këto fonde në 31 dhjetor 2015 rezulton 2.988 mijë lekë.

- Gjatë vitit 2015 Bashkia e Durrësit ka përfituar fonde në vlerën **555.526 mijë lekë** në programin e infrastrukturës vendore nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për 8 objekte.

INFRASTRUKTURA
SHERBIME PUBLIKE
INFRASTRUKTURA RRUGORE

Gjatë vitit 2015 u tenderuan 4 objekte për të cilat u lidhën kontratat me vlerë 415.907 mijë lekë, nga këto janë likujduar 161.856 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme po japim në mënyrë më të hollësishme reaalizimin e gjendjes faktike të këtyre objekteve :

000/ leke

	Fondi Zhvillimit te Rajoneve per infrastrukturen vendore	Vlera e projektit	Vlera e kontrates	Celur ne thesar per 2015	Financuar fakt 2015	Mbetet gjend.thesar
1	Rikualifikim i hapësirave në të dyja anet e rruges Pavaresia dhe sistemimet e rruges dalese në plazh LOTI I		228.271	245.000		245.000
2	Rikualifikim fasada në qytet		74.413	74.413	48.634	25.779
3	Rikonstruksion i pishines publike		39.600	39.600	39.600	-
4	Rruge mbi kanalin kullues K192 Plazh		73.623	73.623	73.623	-
5	Rritja e sigurisë së qytetareve përmes monitorimit dixhital	74.413	Ngurtesuar	54.889		54.889
6	Rikualifikim fasada bllokut përballë rruges paralele me portin	100.000	Kontraktuar në 2016	20.000		20.000
7	Rik. rrugë fshati Rinia	120.000	“	24.000		24.000
8	Rik. rruga Perlat-Hamallaj Hidrovor	120.000	“	24.000		24.000
			415.907	555.526	161.856	393.668


Përsa i përket financimit për infrastrukturën rrugore për rikonstruksione rrugësh, për studime-projektme dhe blerje pajisjesh për rikonstruksion rrugësh nga Ndërmarrja e Rrugëve për vitet 2010-2015, janë paraqitur në tabelën si më poshtë:

Kontributi i Bashkise per 3Projekte te IPA	8.780	850	850	850	850	-90,3	100
Totali i shpenzimeve	1.891.163	1.712.801	2.998.210	2.666.458	2.188.072	15,7	73

Shpenzimet kapitale (investime) për vitin 2015 ishin 1.167.099 mijë lekë. Nga keto 649.716 mijë lekë janë investime të alokuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore. Krahasuar me vitin 2014 ato rezultojnë 23,7 % më të larta .

Tendenca e këtyre shpenzimeve për infrastrukturën vendore (në vitet 2005-2015) paraqitet në grafikun e mëposhtëm :

000/leke



AKTIVITETI EKONOMIK

Shpenzimet kapitale nga të ardhurat e veta të Bashkisë Durrës për vitin 2015

Plani i shpenzimeve kapitale nga të ardhurat e veta të Bashkisë , për vitin 2015, të miratuar me VKB si dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit, arriti shumën 1.7825.860 mijë lekë të ndara për :

- studime projekte 42.808 mijë lekë
- investime 1.783.052 mijë lekë.

Realizimi faktik i shpenzimeve kapitale kapi vlerën 1.167.099 mijë lekë të ndara për :

- studime projekte 22.632 mijë lekë
- investime 1.144.467 mijë lekë.

Shpenzimet kapitale të realizuara për vitin 2015 të ndara sipas programeve i rendisim si më poshtë:

000 leke

Shpenzimet kapitale sipas Programeve	Fakt 2014	Fakt 2015
Programi i Administratës Vendore	5.378	470
Programi i Infrastrukturës Rrugore	742.432	1.075.217
Ndertim Ura		5.254
Programi i Shërbimeve Publike	88.995	64.605
Programi i Rinise e Sportit	80	300
Programi i Infrastrukturës Arsimore	6.265	7.473
Programi i Shërbimeve Sociale		
Programi strehimit social	100.000	13.780
TOTALI	943.144	1.167.099

AKTIVITETI EKONOMIK

Shpenzime kapitale nga granti konkurues i infrastruktures vendore

Fondet e grantit konkurues për infrastrukturën vendore gjatë vitit 2015 paraqiten si më poshtë:

1. Fonde per 14 objektet e konkuruara në vitin 2014 në vlerën 487.730 mijë lekë të ndara :
 - Fonde të mbartura nga 2014 në vlerën 271.514 mijë lekë.
 - Fonde të celura në 2015 për financimin e plotë të 14 objekteve në vlerën 216.216 mijë lekë.

Këto objekte u financuan plotësisht sipas situacioneve faktikedhe gjendja në Thesar nga këto fonde në 31 dhjetor 2015 rezulton 2.988 mijë lekë.

2. Fonde për objektet e konkuruara në vitin 2015

Gjatë vitit 2015 Bashkia e Durrësit ka përfituar fonde në vlerën 555.526 mijë lekë në programin e infrastrukturës vendore nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për 8 objekte. Gjatë vitit 2015 u tenderuan 4 objekte për të cilat u lidhën kontratat me vlerë 415.907 mijë lekë, nga këto janë likujduar 161.856 mijë lekë.

Në tabelën e mëposhtëme po japim në mënyrë të detajuar :

000/leke

	Fondi Zhvillimit te Rajoneve per infrastrukturën vendore	Vlera e projektit	Vlera e kontrates	Celur ne thesar per 2015	Financuar fakt 2015	Mbetet gjend.thesar
1	Rikualifikim i hapesirave ne te dyja anet e rruges Pavaresia dhe sistemimet e rruges dalese ne plazh LOTI I		228.271	245.000		245.000
2	Rikualifikim fasada ne qytet		74.413	74.413	48.634	25.779
3	Rikonstruksion i pishines publike		39.600	39.600	39.600	-
4	Rruge mbi kanalin kullues K192 Plazh		73.623	73.623	73.623	-

5	Rritja e sigurise se qytetareve permes monitorimit dixhital	74.413	Ngurtesuar	54.889		54.889
6	Rikualifikim fasada bllokut perballe rruges paralele me portin	100.000	Kontraktuar ne 2016	20.000		20.000
7	Rik. rruge fshati Rinia	120.000	“	24.000		24.000
8	Rik. rruga Perlat-Hamallaj Hidrovor	120.000	“	24.000		24.000
			415.907	555.526	161.856	393.668

Shpenzimet kapitale nga buxheti i shtetit

Për vitin 2015 fondi i alokuar nga buxheti i shtetit ishte vetëm 30.000 mijë lekë, alokuar nga FZHR për arsimin parauniversitar vetëm për një objekt: Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare B.Curri si më poshtë:

000/leke

Objekti	Burimi i financimit	Celur ne thesar për vitin 2015	Fakt 2015
Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Bajram Curri	MASH (Fondi për zhvillimin e rajoneve)	30.000	29.980
Totali:		30.000	29.980

- Objekti **“Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare B. Curri”** është nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për projektet e arsimit .Vlera e kontraktuar për këtë objekt është 96.564 mijë lekë. U financua në 2015 për 29.980 mijë lekë, mbetet për t’u financuar në 2016 për diferencën prej 66.584 mijë lekë.

Realizimi i buxhetit sipas programeve

Shpenzimet faktike të buxhetit vendor të Bashkisë Durrës për vitin 2015 të ndara sipas programeve, paraqiten si më poshtë :

AKTIVITETI EKONOMIK

000/ leke

PROGRAMET	buxhet 2015	celur ne thesar	fakt	Realizimi ne strukture ne %
Programi i admin.vendore	382.149	313.900	287.750	13.1 %
Programi i infrastruktures rrugore	1.621.436	1.510.003	1.109.216	50.7 %
Programi i sherbimeve publike	576.903	530.937	499.455	22.8%
Programi i sportit	61.466	56.084	54.922	2.5 %
Programi i kultures e turizmit	60.888	60.588	57.568	2.72 %
Programi i arsimit parauniversitar	100.041	92.270	82.780	3.8%
Programi i sherbimit social	80.095	78.979	73.485	3.4 %
Programi strehimit social	118.419	22.323	21.521	0.98 %
TOTALI	3.001397	2.665.084	2.186.698	100%

Në mënyrë të përmblledhur, realizimi i buxhetit të Bashkisë në vite jepet si më poshtë:

Realizimi i buxhetit të Bashkisë në vite


000/leke

Vitet	Buxheti i pavarur		
	Shpenzime korrente	Investime	Gjithsej
Viti 2003	461,150	306,194	767,344
Viti 2004	499,249	291,436	790,685
Viti 2005	536,799	509,635	1,046,434
Viti 2006	566,090	336,716	902,806
Viti 2007	612,531	365,472	978,003
Viti 2008	739,237	336,032	1,075,269
Viti 2009	845,265	451,950	1,297,215
Viti 2010	908,491	961,617	1,870,108
Viti 2011	922,208	758,978	1,681,186
Viti 2012	893,804	261,352	1,155,156
Viti 2013	886,364	216,314	1,102,678
Viti 2014	948,019	943,144	1,891,163
Viti 2015	1,020,973	1,167,099	2,188,072

Burimi i te dhenave: Drejtoria Ekonomike

AKTIVITETI EKONOMIK

Paraqitja grafike e realizimit të Buxhetit të pavarur në vite



Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është struktura përgjegjëse për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore.

Bashkia e Durrësit ushtron veprimtarinë e saj fiskale duke u mbështetur në bazë ligjore si në:

- Ligjin nr. 9920 datë 18.05.2008 “ Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me:
- Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar me ligjin 181 dt.28.12.2013.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.178 datë 29.01.2014”Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në qytetin e Durrësit “, i ndryshuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.285 dt.9.9.2015 .

Bashkia e Durrësit, garanton funksionimin e saj, nëpërmjet taksave të parashikuara në ligj sipas akteve ligjore, si dhe taksave të përkohëshme dhe tarifavet, të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

AKTIVITETI EKONOMIK

Sipas të dhënave të fundvitit 2015 në rregjistrin vendor të Drejtorisë së Tatim Taksave, rezulton se në Bashkinë e Durrësit kanë ushtruar aktivitetin e tyre 9904 subjekte tregtare. Lëvizjet e numrit të subjekteve gjatë vitit 2015 janë si më poshtë:


Subjekte te pezulluara	Subjekte te rregjistruara	Subjekte pasive	Subjekte aktive
1411	5295	1158	9904

Gjatë vitit fiskal 2015 në sistemin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, lista e subjekteve të rregjistruara aktive, fakt mbi të cilin janë realizuar të ardhurat për zërin “biznes”, rezulton si më poshtë. Tabela e mëposhtëme paraqet të dhëna mbi strukturën e numrit të subjekteve aktive, në fund të vitit fiskal 2015.

Viti 2015

Bizneset sipas kategorisë	Nr. i subjekteve gjithsej	%
Biznesi Vogël	6451	65.1
Ambulant	923	9.3
Biznesi Madh	2530	25.5
Totali:	9904	100

Grafikisht paraqiten si më poshtë:




AKTIVITETI EKONOMIK

Numri i subjekteve paguese sipas llojit të biznesit krahasuar në vite, paraqitet si më poshtë:

Emertimi	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Biznesi i vogel	3123	3325	3998	3632	3493	2635	4034	2685	4074	6451
Biznesi i madh	683	926	1010	1114	1273	1142	1582	1358	1018	2530
Te tjere ambulante	530	1103	910	876	1461	1269	949	1781	1847	923
Totali:	4524	5639	5918	5622	6227	5046	6565	5824	6939	9904

Burimi i te dheneve: Drejtoria e Tatim Taksave

Grafikisht, numri i subjekteve paguese të biznesit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Durrës në vite, paraqitet si më poshtë:



Nga tabela dhe grafiku i mësipërm vëmë re se në vitin 2015 numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në qytetin e Durrësit, krahasuar me vitin 2014, ka pësuar një rritje prej 2965 subjekte më shumë ose e shprehur në përqindje është rritur 42.7%. Gjithashtu vëmë re se numrin e subjekteve nga viti 2004-2008 ka ardhur duke u rritur, ndërsa nga viti 2008 deri në vitin 2015, numrin e subjekteve paguese, vit pas viti, ka pësuar ulje dhe ngritje.


Për vitet 2009- 2015 bizneset sipas llojit të aktivitetit që ato ushtrojnë janë si më poshtë:

AKTIVITETI EKONOMIK

Bizneset sipas aktivitetit	Numri i njesive						
	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Njesi prodhimi	377	381	287	829	325	241	766
Njesi sherbimi	912	1290	972	1284	558	863	1960
Tregti	2503	2882	2361	2750	3607	3858	4067
Transport	536	400	308	463	311	550	964
Ndertim	69	73	72	121	98	110	136
Profesione te lira	385	385	398	499	272	291	460
Librari+gazetari	37	34	29	38	28	29	36
Institucione	31	30	29	36	27	28	46
Bar-bufe-restorant	694	672	524	467	523	892	1393
Hotel	39	39	26	37	28	35	37
Banka	39	41	40	41	47	42	39
Total:	5622	6227	5046	6565	5824	6939	9904

Burimi i te dhenave: Drejtoria e Tatimit dhe Taksave

Më poshtë po paraqisim grafikisht sektorët kryesorë që operojnë (Bizneset sipas aktivitetit) për vitin 2015:



Sa më sipër, si nga tabela dhe paraqitja grafike, për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, vihet re një rritje në numër në të gjithë sektorët e biznesit. Kjo ka ardhur si nga ndarja territoriale, ku Bashkisë së Durrësit iu shtuan dhe 5 komunat, por dhe reformave të qeverisë dhe kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Taksave.

AKTIVITETI EKONOMIK

Për vitin fiskal 2015 u miratua plani vjetor me vlerë **1.253.000.000** lekë. Duke u nisur nga ky parashikim, Bashkia Durrës punoi maksimalisht për realizimin e këtyre të ardhurave, duke u fokusuar dhe duke u përqëndruar si në faktorët pozitiv, ashtu dhe në analizën kohë pas kohe të faktorëve negativë që ndikonin në mos realizimin e të ardhurave, që kishin efekt negativ në realizimin e objektivave të vitit 2015, si dhe duke mos anashkaluar bashkëpunimin korrekt me subjektet dhe qytetarët.

Të ardhurat e Bashkisë Durrës për vitin 2015, arritën në vlerën prej **1.039.407.726** lekë ose rreth 83 % e planit të buxhetit të parashikuar, dhe duke u krahasuar me faktin e vitit 2014, u realizuan 156.369.171 lekë më shumë në vlerë monetare ose 11.8%, të cilat për vitin 2014 arritën 883.038.555 lekë.


Ecuria e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në vite, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Të ardhurat nga taksat dhe tarifave	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Të trashëg. nga viti me pare	376.311	598.632	882.713	400.012	93.586	57.423	116.816	44.416
Të ardhurat nga taksat dhe tarifave të vitit korent	884.624	1.104.264	982.905	933.351	840.660	801.837	883.038	1.039.408
Të ardhurat e veta	1.260.935	1.702.896	1.865.618	1.333.363	934.246	859.260	999.854	1.083.824

Grafikisht dinamika e rritjes së të ardhurave në vitet 2007-2015 paraqitet si më poshtë :


000/leke



AKTIVITETI EKONOMIK

Të ardhurat e veta të Bashkisë nga taksat dhe tarifat për vitin 2015 arritën vlerën 1.039.408 mijë lekë ose 83% të nivelit të programuar prej 1.253.000 mijë lekësh.

Në mënyrë grafike realizimi i të ardhurave për vitin 2015 paraqitet si më poshtë:



Të ardhurat e Bashkisë Durrës përbëhen nga:

- Të ardhurat nga Taksat
- Të ardhurat nga Tarifat
- Të ardhurat nga të tjerët

Taksat dhe Tarifat mbi të cilat realizohen të ardhurat e Bashkisë Durrës janë si më poshtë :

1. Taksa mbi pasurinë
2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël
3. Taksa e fjetjes në hotel
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme
6. Taksa për zënien e hapësirave publike
7. Taksa e tabelës

AKTIVITETI EKONOMIK

8. Taksa e perkohshme e tregut
9. Tarifa e gjelberimit
- 10 Tarifa e pastrimit dhe e largimit te mbeturinave
11. Tarifa e plazheve private
12. Tarife per leje per perdorim strukture
13. Tarifa e parkimit te automjeteve
14. Tarifa e ndricimit
15. Tarifat e sherbimit administrativ te Bashkise
16. Tarifa per transportin publik
17. Tarifa e autorizimeve per tregtim karburanti
18. Tarifa e autorizimeve per qarkullimin ne qytet
19. Tarifa per dhenien e lejeve ushtrim veprimtarie
20. Tarifa e sherbimit veterinar
21. Tarifa e urbanistikes
22. Tarifa e institucioneve te Bashkise
23. Taksa te administruara nga agjentet tatimor

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat ndahen në dy grupe kryesore :

1. Të ardhura tatimore
2. Të ardhura jo tatimore.

Te ardhura tatimore.

Janë të ardhura që vijnë nga burime të taksueshme dhe për vitin 2015 arritën në 753.055.342 lekë kundrejt planit prej 845.180.000 lekë ose e shprehur në përqindje 89 % e nivelit të programuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014 rezultojnë 108.770.973 lekë më shumë.

TE ARDHURAT JO TATIMORE (tarifa+te ardhura të tjera)

Këto të ardhura vijnë nga burime jo të taksueshme dhe për vitin fiskal 2015 kanë arritur në vlerën 286.352.384 lekë ose 70 % të e nivelit të programuar vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014 rezultojnë 47.598.198 lekë më shumë.

AKTIVITETI EKONOMIK

Ecuria e realizimit të të ardhurave të Bashkisë Durrës për periudhën 2011- 2015 , vihet re që në vitin fiskal 2015 kemi një rritje pozitive të të ardhurave vjetor të faktit me vitin fiskal 2014.

Ecuri e të ardhurave për periudhën 2011-2015 paraqitet si më poshtë:

leke

TE ARDHURAT E VETA	Fakti 2011	Fakti 2012	Fakti 2013	Fakti 2014	Fakti 2015
Të ardhurat tatimore	705.147.343	929.280.000	609.557.519	644.284.369	753.055.342
Të ardhurat jo tatimore	228.203.531	299.420.000	192.279.484	238.754.185	286.352.384
Totali:	933.350.874	1.228.700.000	801.837.003	883.038.555	1.039.407.726

Më poshtë po paraqesim një detajim më të hollësishëm të realizimit të të ardhurave të veta të Bashkisë të vitit 2015.

Taksa mbi Pasurinë

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi.

Kjo taksë për nga rëndësia, është një nga prioritetet e Bashkisë, si për menaxhimin ashtu edhe për vjeljen e saj, si për kategorinë “ Ndërtesa Biznesi” , ashtu dhe për kategorinë “Ndërtesa për Popullatën, ku në vjeljen e kësaj takse është caktuar si agjent, ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve Durrës. Në vitin fiskal 2015 nga kjo taksë janë vjelur rreth 26.930.586 lekë , ndërkohë, nga kjo taksë për vitin 2014 janë vjelur rreth 20.147.832 lekë. Realizimi i kësaj takse për vitin fiskal 2015 arriti 32% të planit, ndërsa krahasuar me faktin 2014, arriti 6.782.754 lekë.

Mos realizimi i kësaj takse në raport me numrin e familjeve, vjen, sepse në qytetin e Durrësit është tepër i ndjeshëm fenomeni emigrimit si dhe mos jetesa e shumë familjeve në këtë qytet për gjatë gjithë vitit, gjë e cila rrit vlerën e pritshmërisë së të ardhurave në planifikim, pasi janë pjesë e Gjendjës Civile në këtë qytet, në bazë të së cilave, ne planifikojme të ardhurat për familjarët.

AKTIVITETI EKONOMIK

Taksa e Pasurise nga Biznesi

Sipas të dhënave të regjistrit vendor (subjektet taksapagues) rezultojnë se për vitin 2015 janë të regjistruara për taksën e ndërtesës 5551 subjekte si dhe 1328 subjekte të shtuara nga Njësitë e reja Administrative pra gjithësej 6879 subjekte taksapaguese.

Kjo taksë për specifikën e saj, është shumë e lidhur me ndërtimet e reja në qytetin e Durrësit si dhe përshtatshmërinë që i bëhet pronave për t'i dhënë me qera në shërbim të aktiviteteve ekonomike. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në bashkëpunim me subjektet si dhe me Zyrën e Rregjitrimit të Pasurive të Paluajtshme, arriti që për vitin fiskal 2015 të rrisi ndjeshëm të ardhurat për këtë zë, duke kapur vlerën 258.388.507 lekë, duke realizuar rreth 112% të planifikimit vjetor. Këto të ardhura janë rritur ndjeshëm në krahasim me faktin e viti paraardhës

fiskal 2014, duke realizuar 61.859.134 lekë më shumë, pasi në vitin fiskal 2014 të ardhurat për këtë zë ishin 196.529.373 lekë, si rezultat i punës së mirë të kryer nga ana e Drejtorisë së Taksave për të identifikuar në terren aktivitetet tregtare dhe duke luftuar informalitetin.

Gjithashtu në realizimin e vlerës së taksës së pasurisë ka ndikuar edhe shtimi në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2015 të subjekteve të ish komunave dhe bashkive, si dhe shtimi në këtë zë i taksës mbi tokën bujqësore, e cila për gjashtëmujorin e dytë arriti shifren **4.187.745** lekë.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim:

- nga 2 deri në 8 milionë lekë, është 7.5 % dhe,
- për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 2 milionë lekë, është 25 000 lekë në vit.

AKTIVITETI EKONOMIK

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, vepron si agjent tatimor, i ngarkuar në mbledhjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata tatimore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, dhe për shërbimin që kryen si agjent tatimor, merr një komision, i cili është në masën 1% dhe derdhet në llogari të administratës tatimore. Komisioni si agjent tatimor kalon në llogari të buxhetit të shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të “Pullave të tatimit”.

Tatimi i thjeshtuar i fitimit të biznesit të vogël me qarkullim 2-8 milion lekë në vit paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 Dhjetor të vitit fiskal. Ndërsa Bizneset me qarkullim vjetor deri në 2 milion lekë e kryejnë pagesën gjashtë mujorin e parë të viti fiskal.

Gjatë vitit fiskal 2015 kjo taksë u menaxhua nga Drejtoria Tatimore Durrës e cila realizoi shumën 141.777.004 lekë. Planifikimi për këtë zë ishte 160.000.000 lekë , planifikim i cili u bë nga pushteti vendor, pra u realizua 89 % e saj.

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar.

Fakti i vitit fiskal 2015 ka regjistruar shumën 92.161.960 lekë të arkëtuar nga kjo taksë, kundrejt një planifikimi prej 86.000.000 lekë. Pra, ka arritur realizimn 107 % të planifikimit.

AKTIVITETI EKONOMIK

Taksa e Mjeteve të përdorura.

Për vitin fiskal 2015 nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor janë arkëtuar 68.404.608 lekë, për të cilat ishin planifikuar 60.000.000 lekë, me një realizim prej 114%. Edhe në këtë zë ka ndikim, bashkimi i njësive të reja administrative në 6/M e dytë të vitit.

Taksa e Tabelës për qëllime identifikimi

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Për vitin fiskal 2015 nga kjo taksë u realizua një e ardhur prej 959.700 lekë , ose 160% të planifikimit vjetor. Në këtë tejkallim, ndikim ka patur shtimi i subjekteve si në bashkinë ekzistuese ashtu dhe në njësitë e reja administrative.

Taksa e Tabelës për qëllime reklamimi

Taksa e reklamës është detyrim vjetor. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria Urbanistikës në momentin e zbardhjes së lejes së përkohshme të vendosjes së reklamave.

Kjo taksë aplikohet mbi të gjitha subjektet të cilët shfrytëzojnë hapsirat për të reklamuar produkte dhe shërbime të cilat lidhen me aktivitetin që kryejnë.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin fiskal 2015, arritën vlerën prej 2.556.780 lekë. Planifikimi i kësaj takse, është bërë duke u nisur nga sipërfaqet e reklamave që firmat reklamuese kanë vendosur në qytetin e Durësit dhe niveleve të percaktuara në ligj. Planifikimi për vitin 2015 ishte 5.000.000 lekë , që do të thotë se janë realizuar 51% të ardhurat, pasi kjo taksë është e varur nga kërkesat për reklama të subjekteve.

AKTIVITETI EKONOMIK

Taksa për zënien e hapësirave publike.

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Taksa për zënien e hapësirës publike përbëhet prej:

- Taksës për zënie të hapësirës publike, spektakle ose panairë të ndryshme
- Taksa për zënie të hapësirës publike (Përdorim trualli për tavolina)
- Taksës për zënie të hapësirës publike me mallra jashtë vendit të tregtimit
- Taksës për zënie të hapësirës publike me platforma, me kangjella, vazo, drurë dekorativ etj;

Për vitin 2015 u parashikua që nga taksa e zënies së hapësirave publike për veprimtari ekonomike të ishte 3.100.000 lekë, nga e cila u realizuan 11.798.543 lekë ose rreth 381% e saj dhe për taksën e zënies së hapësirave për tavolina u parashikua për vitin fiskal 2015, rreth 2.000.000 lekë dhe u realizua 245% , e barabartë kjo me vlerën prej 4.890.678 lekë. Krahasuar me vitin fiskal 2014, kjo taksë ka një rritje pozitive prej 2.371.088 lekë më shumë.

Taksa e përkoheshme e tregut

Kësaj takse i nënshtrohen të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregjet publike në administrim të Bashkisë Durrës.

Baza e kësaj takse është sipërfaqja në m² për tregtimin e artikujve të ndryshëm dhe kjo taksë llogaritet si detyrim mujor.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2015 ishin planifikuar në vlerën 12.7480.000 lekë dhe e ardhura nga kjo taksë arriti në vlerën 12.411.100 lekë, rreth 99% të planifikimit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi, si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

AKTIVITETI EKONOMIK

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është, Drejtoria e Urbanistikës.

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë e ka bazën në të ardhurat që realizohen nga pagesa për zbardhjen e lejeve të ndërtimit të miratuara nga K.RR.T-ja pranë Bashkisë së Durrësit në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave në qytetin e Durrësit” dhe kërkesave të subjekteve për leje ndërtimi. Për vitin fiskal 2015, u realizua rreth 122.615.005 lekë, ose 61 % e planifikimit, ku një vend kryesor zënë të ardhurat nga Aluizni, të cilat për këtë vit fiskal, u realizuan në masën 60.005.435 lekë ose krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje prej 46.449.862 lekë, pasi në vitin paraardhës realizimi i këtij zëri ishte vetëm 13.555.573 lekë.

Taksa e Fjeties në Hotel.

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i Taksës në të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie. Niveli i taksës është 2.5 % e çmimit të fjetjes.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Durrës.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2015 arritën shifrën 5.973.2126 lekë, ose 299% të planifikimit të saj 2.000.000 lekë. Krahasuar me vitin fiskal 2014 kemi një rritje të kësaj të ardhure, me 3.957.873 lekë. Në këtë tejkallim, ndikim ka patur shtimi i subjekteve si në bashkinë ekzistuese ashtu dhe në njësitet e reja administrative.

Taksa e fjetes në hotel vazhdon ende të jetë një taksë me problematikën e saj specifike, pasi ka ende më shumë punë për të ulur informalitetin e hoteleve sezonale “ dhoma me qera”, si dhe duke rritur bashkëpunimin me Drejtorinë Tatimore dhe strukturat e tjera të pushtetit vendor.

AKTIVITETI EKONOMIK

Tarifa e gjelbërimit

Tarifa e gjelbërimit, paguhet nga të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Durrësit. Kjo taksë është vjetore dhe likuidimi i saj detyrimisht bëhet brenda 20 Prillit të çdo viti.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës së përkohshme të gjelbërimit nga subjektet, është Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës për subjektet që marrin leje ndërtimi.

Agjenti tatimor për mbledhjen e taksës së përkohshme të gjelbërimit për kategorinë e familjarëve është Ndermarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve.

Realizimi i Tarifës së Gjelbërimit për vitin fiskal 2015 , është si më poshtë vijon:

- Nga kategoria e biznesit, u arrit vlera 22.009.589 lekë dhe u realizua rreth 119 % të planifikimit prej 18.500.000 lekë. N.q.s, do të krahasojmë realizimin faktit të vitit 2015 me vitin fiskal 2014, kemi një rritje prej 16 % të të ardhurave nga ky zë, ose 3.055.845 lekë më shumë, pasi në vitin fiskal 2014 u realizuan 18.953.744 lekë.
- Nga kategoria familjare u arrit vlera 2.646.066 lekë ose 22% të planifikimit 12.100.000 lekë. Mos realizimi i kësaj tarife në mënyrë të ndjeshme vjen vetëm nga fakti që kemi një planifikim buxhetor tepër të lartë për shkak të numrit të madh të familjarëve të regjistruar në sistemin e Gjendjes Civile të rrethit Durrës, që nuk jetojnë në këtë qytet, ose jetojnë vetëm për disa ditë ose muaj (sezonale). Pra kemi një dispropocion midis faktit të sistemit të Gjendjes Civile dhe faktit real të familjeve që jetojnë në qytetin e Durrësit.

Gjithesesi në bashkëpunim me U.K D është arritur që të kemi një rritje të ndjeshme, krahasuar me vitin fiskal 2014, ku për vitin 2015 u realizuan 17 % më shumë të ardhura, pasi në vitin 2014 nga kjo tarifë u arritën 1.434.664 lekë, ose 378.402 lekë më shumë.

AKTIVITETI EKONOMIK

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

Tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave i nënshtrohen të gjithë : familjet, personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, të cilët banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të qytetit të Durrësit.

Agjentët për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjarët për vitin 2014 janë Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizemeve, për te gjithë subjektet e tjera. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës për subjektet që marrin leje ndërtimi..

Realizimi për " Tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave" për vitin 2015 është **114.878.094** lekë ose **23.778.361** lekë më shumë se në vitin 2014, ku realizimi i kësaj tarife ka qenë **91.099.733** lekë .Ky zë ka në përbërjen e tij:

- "Tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga biznesi" që për vitin 2015 është realizuar në vlerën 97.739.741 lekë ose 94% të planifikimit. Për vitin 2014, realizimi i kësaj tarife ishte 74.741.560 lekë. Në krahasim me vitin 2014, kjo tarifë është rritur në masën 24% të të ardhurave. Apo në vlerë 17.998.181 lekë.
- " Tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga popullata" që për vitin 2015, është realizuar 22.138.353 lekë ose 20% e planifikimit prej 109.000.000 lekë. Ky mosrealizim vjen nga të njëjtat argumenta që përmendëm më sipër, por gjithësesi duhet të theksojmë faktin që kemi një rritje të ndjeshme me faktin fiskal 2014, pra, 35 % ose 5.780.180 lekë më shumë të ardhura se viti 2014, vit në të cilën kjo tarifë u realizua në vlerën 16.358.173 lekë.

Tarifa e plazheve Private

Kjo tarifë aplikohet mbi të gjitha subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqen e rërës në vijën bregdetare për plazhe private gjatë periudhës së sezonit turistik.

Të ardhurat nga kjo tarifë për vitin fiskal 2014 janë realizuar në shumën 3.200.000 lekë ose 27% të planifikimit vjetor. Gjatë vitit fiskal 2014 u realizua shuma prej 13.100.000 lekë, pra krahasuar me faktin e vitit 2014 , kemi një rënie rreth 10.400.000 lekë.

AKTIVITETI EKONOMIK

Tarifa e parkimit.

Në parashikimin e kësaj të ardhure janë marr në konsideratë si të ardhurat që vilen nga Drejtoria e Shërbimeve ashtu edhe nga të ardhurat që vilen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Realizimi i kësaj Tarife për vitin fiskal 2015 është 17.298.170 lekë , realizim prej 105% të planifikimit me vlerën 16.500.000 lekë. Krahsuar me faktin e të ardhurave për vitin fiskal 2014, kemi një realizim 20 % më shumë se të ardhurat e vitit 2014, një rritje prej 2.878.237 lekë.

Tarifa e ndricimit

Objekt i kësaj tarife do të jenë të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Durrësit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së ndricimit nga subjektet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Agjenti tatimor për mbledhjen tarifës së ndricimit për kategorinë e familjarëve është Drejtoria Ujësjiellës - Kanalizimeve.

Nisur nga rezultatet e deritanishme, për vitin fiskal 2015 u realizuan të ardhurat :

- Tarifa e ndricimit për bizneset arriti vlerën prej 23.487.611 lekë, ose 112% të planifikimit vjetor 21.000.000 lekë . Edhe në këtë tarifë kemi rritje të të ardhurave , në krahasim me faktin e vitit 2014, të cilat arritën shifrën 18.911.419 lekë , rreth 24% më shumë të ardhura, ose 4.576.192 lekë.
- Tarifa e ndricimit për popullatën, arriti vlerën prej 5.972.06 lekë, ose 20% të planifikimit. Duhet të theksojmë që kemi një rritje të mirë me faktin e vitit 2014, të cilat kapën vlerën prej 708. 541 lekë më shumë të ardhura ose 13%

AKTIVITETI EKONOMIK

Tarifa e transportit publik

Kjo tarifë përlogaritet nga Drejtoria e Shërbimeve dhe realizimi i kësaj të ardhure për vitin 2015 është 3.304.126 lekë, realizim 103% të planifikimit për këtë vit. Krahasuar me vitin 2014, në vitin 2015 kemi një rritje prej 435.136 lekë ose 15% më shumë.

Të ardhura nga tarifat e shërbimit

Kjo tarifë përlogaritet nga Drejtoria e Shërbimeve dhe realizimi i kësaj të ardhure për vitin 2015 është 2.023.166 lekë, ose 86% e planifikimit vjetor. Në vitin 2014 kjo tarifë u realizua në vlerën 1.037.560 lekë. Në vitin 2015 kemi një rritje prej 985.606 lekë më shumë të ardhura nga kjo tarifë ose 94%.

Tarifa e shërbimit veterinar

Realizimi i kësaj të ardhure llogaritet nga Sektori Veterinar pranë Drejtorisë së Shërbimeve dhe për vitin 2015 është realizuar në vlerën 662.060 lekë ose 88% të planifikimi vjetor prej 750.000 lekë, si dhe janë realizuara më pak të ardhura se fakti i vitit 2014, në shumën 153.410 lekë.

Tarifa e Përdorimit.

Me këtë tarifë ngarkohen të gjithë subjekte që marrin lejen e përdorimit. Kjo tarifë, për vitin 2015 u planifikua në vlerën 12.000.000 lekë dhe u realizua rreth 121% të saj, me një vlerë prej 14.513.947 lekë dhe ndiqet nga Drejtoria e Urbanistikës. Gjithashtu viti 2015 krahasuar me vitin fiskal 2014 ka një rritje prej 7.735.550 leke ose 114%.

Tarifa e Urbanistikës

Kjo tarifë për vitin 2015 u planifikua në vlerën 9.000.000 lekë për shërbimet që iu ofrohen firmave ndërtuese. Nga kjo tarifë u realizuan rreth 34% e të ardhurave, me vlerë prej 3.024.726 lekë. Në krahasim me realizimin e vitit 2014, në vitin 2015 kemi një rritje prej 458.733 lekë. Kjo tarifë llogaritet dhe mbledhet nga Drejtoria e Urbanistikës.

AKTIVITETI EKONOMIK

Të ardhura te tjera

Për zërin “ të ardhura të tjera”, për vitin 2015, u parashikuan të arkëtohen të ardhura në shumën 23.600.000 lekë dhe u realizuan rreth 163% e tyre, të cilat arritën vlerën prej 38.582.246 lekë. Detajimi i zërave është si më poshtë:

- Të ardhura nga veprimtaritë ekonomike (dhënie me qera) për vitin 2015 janë 6.436.235 lekë, krahasuar me planifikimin e këtij zëri prej 10.000.000 lekë ose 64% e planifikimit.
- Sponsorizime, planifikimi i vitit fiskal 2015 ishte 1.600.000 lekë, realizimi 2.831.599 lekë, ose 177% të planifikimit. Në krahasim me 2014 kemi një rritje prej 819.023 lekë.
- Të ardhura nga gjobat, planifikimi për vitin fiskal 2015 ishte 12.000.000 lekë, realizimi 18.684.533 lekë nga “gjoba DDTV” dhe 6.867.074 lekë nga zëri “të tjera gjoba” Në total 25.551.607 lekë. Krahasuar me vitin 2014, ku realizimi ka qenë 11.345.060 lekë për këtë zë, kemi një rritje pozitive prej 14.206.547 lekësh.
- N ë funksion të zbatimit të reformës territoriale dhe bashkimit të ish komunave dhe bashkive, (tani njësi administrative të Bashkisë Durrës), gjatë gjashtëmujorit të dytë në këtë zë kemi realizim edhe disa tregues të tjerë në vlerën 3.762.805 lekë, ku peshën kryesore e zë treguesi “dhënie me qera tokë bujqësore „.

Te ardhura nga instuticione

Planifikimi i të ardhurave nga Instuticionet për vitin 2015 ishte në vlerën 39.320.000 lekë dhe u realizuan 85% e tyre, me vlerë rreth 33.255.396 lekë. Të ndara sipas zërave janë si më poshtë:

- | | |
|--|------------------------|
| 1. Të ardhura nga pagesat e prindërve për cerdhe | 8.406.235 lekë (80%) |
| 2. Të ardhura nga pagesat e prindërve për kopshtet | 21.787.800 lekë (84%) |
| 3. Të ardhura nga pagesat për konviktet | 1.270.711 lekë (79%) |
| 4. Të ardhura nga instuticionet Kulturore-Sportive | 1.790.650 lekë (141%) |

AKTIVITETI EKONOMIK


Të ardhurat e veta të realizuara në total nga Bashkia për vitin 2015, janë 1.039.408 mijë lekë kundrejt 1.253.000 mijë lekë të planifikuara ose 83% të nivelit të programuar.

Më poshtë po paraqesim, realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në vite.

Të ardhurat në vite nga Taksat dhe Tarifat

Emertimi	Plani (000/lek)	Realizimi (000/lek)	Realizimi (%)
Viti 2003	709,156	791,595	111.6
Viti 2004	882,810	745,228	84.4
Viti 2005	963,856	1,002,612	104
Viti 2006	925,460	775,369	84
Viti 2007	768,281	801,170	104
Viti 2008	868,050	884,624	102
Viti 2009	1.045.000	1.104.264	106
Viti 2010	1.105.500	982.905	89
Viti 2011	1.300.000	933.351	72
Viti 2012	1.300.000	840.660	65
Viti 2013	1.104.000	801.837	72.6
Viti 2014	1.260.000	883.039	70
Viti 2015	1.253.000	1.039.408	83


Paraqitja grafike e të ardhurave në vite nga taksat dhe tarifat vendore



AKTIVITETI EKONOMIK

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në vite e shprehur në %, grafikisht është paraqitur si më poshtë:

Paraqitja grafike e realizimit të të ardhurave në vite nga taksat dhe tarifat vendore e shprehur ne %



AKTIVITETI LIGJOR

Gjatë vitit 2015, nga **Spektori Juridik pranë Drejtorisë Ligjor**, janë:

- Përgatitur 79 urdhëra dhe 8 vendime lidhur me ankesat e ardhura për procedurat e tenderimit të fondeve publike.
- Formuluar 17 akt-marrëveshje dhe kontrata.
- Përpiluar rreth 1300 shkresa kthim-përgjigje të paraqitura nga qytetarët dhe institucionet. Një pjesë e shkresave të ardhura nga institucionet janë thjesht të karakterit informues dhe nuk ka pasur nevojë për kthim përgjigje.
- Siguruar konsulencë juridike për të gjitha Drejtoritë e Institucionit për interpretimin e akteve ligjore në fuq në bazë të kërkesave të drejtorive përkatëse.
- Përgatitur , projekt-vendime që i paraqiten për miratim Këshillit në bazë të relacioneve të përgatitura nga Drejtoritë përkatëse. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 81 Vendime të Këshillit Bashkiak.
- Një pjesë të rëndësishme të punës në këtë sektor e ka zënë edhe kthimi i përgjigjeve kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve për probleme të ndryshme që ato i shqetësojnë, takimet me publikun, si dhe shkresa të ndryshme.
- Ndjekur 165 padi apo procese gjyqësore të ngritura ndaj Institucionit të Bashkisë, përkatësisht janë përfunduar 38 çështje dhe 127 çështje janë ende në vazhdim.


Tabelat e mëposhtëme, pasqyrojnë të dhënat statistikore në lidhje me këto procese gjyqësore në vite:

Vitet	Cështje gjyqësore të përfunduara	Cështje gjyqësore në vazhdim	Procese gjyqësore
Viti 2005	27	18	45
Viti 2006	17	38	55
Viti 2007	56	47	103
Viti 2008	34	51	85
Viti 2009	42	86	128
Viti 2010	20	94	114
Viti 2011	31	83	114
Viti 2012	41	51	92
Viti 2013	63	50	113
Viti 2014	57	68	125
Viti 2015	38	127	165

Burimi i te dhenave: Spektori Juridik

AKTIVITETI LIGJOR

Paraqitja grafike ne vite e proceseve gjyqesore



- Janë ndjekur dhe kanë përfunduar 38 procese gjyqësore nga të cilat:

29 çështje janë të fituara dhe janë humbur 9 çështje gjyqësore. Vlen të theksohet se nuk ka asnjë proces gjyqësor të humbur me dëm ekonomik.

Gjithashtu nga **Zyra e Gjendjes Civile pranë Drejtorisë Ligjore**, për vitin 2015 janë:

- Ndjekur 41 procese gjyqësore nga të cilat:

janë humbur 2 dhe janë ankimuar nga ana e jonë, janë fituar 2 çështje, 23 çështje janë të pushuara dhe 14 të tjera janë në vazhdim.

Objekti këtyre çështjeve gjyqësore kryesisht ka konsistuar si më poshtë:

AKTIVITETI LIGJOR

1. Në pavlefshmërinë e aktit të lindjes në rubrika të tilla si: Datëlindje, Kombësi, Kundërshtim Atësie, Vërtetim Fakti, Lindje, Vdekje etj.
2. Në plotësim të aktit të lindjes kryesisht në rubrikën “datëlindje”.
 - Ndjekur 348 praktika shkresore, duke i kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

Përsa i përket shkresave të drejtuara Sektorit të Gjendjes Civile janë trajtuar 348 praktika shkresore me problematikat të ndryshme duke iu kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

Gjatë vitit 2015, për procedurat e tenderimit, **Sektori i Prokurimeve Publike pranë Drejtorisë Ligjore:**

- Përgatit regjistrin e parashikimit të Prokurimeve publike sipas buxhetit të Bashkisë.
- Përgatit Urdhërat e Krijimit të Grupeve të specifikimeve teknike, Urdhërat e Prokurimeve, Urdhërat e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, Urdhëra për grupet e marrjes në dorëzim dhe Urdhëra të tjerë të ndryshëm .
- Përgatit të gjitha materialet e duhura për hartimin e dokumentave të tenderave duke kontrolluar ligjshmërinë e kërkesave të caktuara në to si dhe duke pasqyruar të gjithë ndryshimet që bëhen në legjislacion.
- Verifikon të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave duke kontrolluar në këtë mënyrë shkallën e përgatitjes së kandidatëve në bazë të kërkesave të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si dhe është punuar në drejtim të sistemit elektronik.
- Verifikon ligjshmërinë e ndjekjes së procedurave të tenderit gjatë zhvillimit të tij.
- Zbaton të gjitha detyrimet ligjore për afatet në njoftimin e klasifikimeve në procedura prokurimi si dhe në ankesat e paraqitura pranë autoritetit.
- Harton kontrata sipas klasifikimit të tyre në bazë të procedurës duke mbrojtur në cdo kohë interesat e Institucionit.
- Gjatë gjithë procedurës, mban fshehtësinë në përgatitjen e dokumentacionit, verifikimin e tij, deri në komunikimin zyrtar.

AKTIVITETI LIGJOR

Gjatë vitit 2015, Njësia e Prokurimeve ka realizuar detyrat e saj që i ngarkon ligji, duke mirëmenaxhuar fondet publike, gjë e cila duket dhe në kursimet që janë bërë, si rezultat i konkurrencës, në procedurat e prokurimeve, ku në përgjithësi, fituesit kanë dhënë ofertat më të ulta.

Prokurimet e realizuara gjatë vitit 2015, konsistojnë në: investime, shërbime, blerje dhe prokurime me vlerë të vogël:

Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për vitin 2015

Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës

Nr	Objekti i prokurimit	Fondi Limit (pa TVSH)	Vlera e Kontrates (pa TVSH)	Lloji i procedurës së prokurimit	Vlera e kursyer	Burimi financimit
1	Realizimi shatervanit ne sheshin Liria	8,333,000	8,290,000	Kerkesëper propozim	43,000	Buxh.Bash
2	Mbikqyrje punimesh Realizimi shatervanit ne sheshin Liria	168,000	88,000	Prokurim me vlere te vogel	80,000	“
3	Rikonstruksion kuartalla tek sustat	8,224,520	4,901,210	Kerkesëper propozim	3,323,310	“
4	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion kuartalla tek sustat	90,889	15,000	Prokurim me vlere te vogel	75,889	“
5	Rikonstruksion i rruges 26 Nentori	12,499,000	7,493,520	Procedurë e hapur	5,005,480	“
6	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion i rruges 26 Nentori	125,354	20,000	Prokurim me vlere te vogel	105,354	“
7	Studim projektim rikualifikim i fasadave ne qytet	2,249,300	2,238,000	Sherbime konsulence	11,300	“
8	Rikonstruksion rruga e Oslo	4,983,200	3,908,200	Kerkesëper propozim	1,075,000	“
9	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion rruga e Oslo	62,081	15,000	Prokurim me vlere te vogel	47,081	“
10	Rikonstruksion rruga "Sefer Efendiu"	4,166,240	2,936,500	Kerkesëper propozim	1,229,740	“
11	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion rruga "Sefer Efendiu"	54,025	7,000	Prokurim me vlere te vogel	47,025	“
12	Rikonstruksion kuartalla tek posta Shkozet	4,008,740	2,518,760	Kerkesëper propozim	1,489,980	“

13	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion kuartalla tek posta Shkozet	52,422	19,167	Prokurim me vlere te vogel	33,255	“
14	Rikonstruksion rruga "Kavaja" Shkozet	3,618,640	2,832,110	Kerkesëper propozim	786,530	“
15	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion rruga "Kavaja" Shkozet	53,620	15,000	Prokurim me vlere te vogel	38,620	“
16	Studim projektim rikualifikim hapsirave ne te dy anet e rruges “Pavarsia” dhe sistemimet e rrugeve dalese ne Plazh	8,333,000	8,312,000	Sherbime konsulence	21,000	“
17	Rikonstruksion rruga Marina	8,287,200	5,520,000	Kerkesëper propozim	2,767,200	“
18	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion rruga Marina	91,414	8,000	Prokurim me vlere te vogel	83,414	“
19	Rikonstruksion rruga "Ibrahim Kodra" Shkozet	4,014,100	2,677,625	Kerkesëper propozim	1,336,475	“
20	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion rruga "Ibrahim Kodra" Shkozet	52,477	9,000	Prokurim me vlere te vogel	43,477	“
21	Rikonstruksion rruga Niko Nishku Plazh	4,410,830	2,694,500	Kerkesëper propozim	1,716,330	“
22	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikonstruksion rruga Niko Nishku Plazh	56,400	200,000	Prokurim me vlere te vogel	-143,600	“
23	Rikonstruksion i pishines publike	41,622,900	33,000,100	Procedurë e hapur	8,622,800	Buxh.Shteti
24	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikonstruksion i pishines publike	800,000	235,000	Prokurim me vlere te vogel	565,000	Buxh.Bashk
25	Rruge mbi kanalin kullues K-192 Plazh, loti 1	83,499,400	61,352,140	Procedurë e hapur	22,147,260	Buxh.Shteti
26	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rruge mbi kanalin kulluesK-192 Plazh, Loti 1	499,505	99,000	Prokurim me vlere te vogel	400,505	Buxh.Bashk
27	Rikualifikim kuartalla ne rrugen M.Varoshi, rruga kunit dhe rr.Petra Boshnjaku	8,331,300	5,464,300	Kerkesëper propozim	2,867,000	“
28	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikualifikim kuartalla ne rrugen M.Varoshi,rruga Kunitdhe rr.Petra Boshnjaku	91,610	30,000	Prokurim me vlere te vogel	61,610	“
29	Ndricimi i jashtem i godines se Bashkise, Prefektures dhe Pallatit te Kultures	5,000,000	4,488,050	Kerkesëper propozim	511,950	“
30	Mbikqyrje punimesh per objektin: Ndricimi i jashtem i godines se Bashkise, Prefektures dhe Pallatit te Kultures	104,445	35,000	Prokurim me vlere te vogel	69,445	“
31	Rikonstruksion rruga I.Buzhiqi, rr.Arberve, rr.Cajupi, rr.T.Cela.	15,047,000	9,981,790	Procedurë e hapur	5,065,210	“
32	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikonstruksion rruga I.Buzhiqi, rr.Arberve,	144,286	44,444	Prokurim me vlere te	99,842	“

	rr.Cajupi, rr.T.Cela			vogel		
33	Rikonstruksione pjesore ne shkolla 9 vjecare	4,166,500	2,548,500	Procedurë e hapur	1,618,000	“
34	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikonstruksione pjesore ne shkolla 9 vjecare	87,196	15,000	Prokurim me vlere te vogel	72,196	“
35	Rikonstruksion rruga "Preng Jakova"	3,330,100	2,439,000	Kerkesëper propozim	891,100	“
36	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikonstruksion rruga Preng Jakova	44,707	6,600	Prokurim me vlere te vogel	38,107	“
37	Rikonstruksion rruga "Princesha Erudike" e rruga "Vace Zela" Shkozet	4,999,600	3,332,000	Kerkesëper propozim	1,667,600	“
38	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikonstruksion rruga Princesha Erudike e rruga Vace Zela	62,234	23,000	Prokurim me vlere te vogel	39,234	“
39	Mbyllje kanali nga rruga "Migjeni", shkozet	4,999,600	2,946,100	Kerkesëper propozim	2,053,500	“
40	Mbikqyrje punimesh per objektin: Mbyllje kanali nga rruga "Migjeni", Shkozet	62,235	8,000	Prokurim me vlere te vogel	54,235	“
41	Rikualifikim i fasadave ne qytet	89,948,000	62,011,050	Procedurë e hapur	27,936,950	Buxh.Shteti
42	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikualifikim i fasadave ne qytet	1,717,500	684,985	Kerkesë per propozim	1,032,515	Buxh.Bashk
43	Blerje materiale pastrimi dhe detergjente	3,439,870	3,395,345	Kerkesë per propozim	44,525	“
44	Blerje Ushqimesh	35,923,600	31,344,750	Procedurë e hapur	4,578,850	“
45	Rikualifikim i hapesirave ne te dy anet e rruges Pavaresia dhe sistemimet e rrugeve dalese ne plazh (Loti 1)	291,612,000	190,226,088	Procedurë e hapur	101,385,912	Buxh.Shteti
46	Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikualifikim i hapesirave ne te dy anet e rruges Pavaresia dhe sistemimet e rrugeve dalese ne plazh (Loti 1)	6,164,900	2,222,222	Sherbime konsulence	3,942,678	Buxh.Bashk
47	Ndertim i shkolles 9-vjecare Bajram Curri 2	120,287,000	67,058,652	Procedurë e hapur	53,228,348	Buxh.Shteti
48	Mbikqyrje punimesh per objektin: Ndertim i shkolles 9-vjecare Bajram Curri 2	1,867,000	777,000	Sherbime konsulence	1,090,000	Buxh.Bashk
49	Blerje kancelari dhe tonera	3,082,000	2,415,833	Kerkesë per propozim	666,167	“
50	Blerje dru zjarri per Q.E.A	5,600,000	4,400,000	Sherbime konsulence	1,200,000	“
51	Rikonstruksion rruga Vrine - Fshati Rinia	99,993,000	67,777,777	Procedurë e hapur	32,215,223	Buxh.Shteti

52	Rikonstruksion rruga Perlat-Hamallaj-Hidrovor	99,999,000	62,303,560	Procedurë e hapur	37,695,440	Buxh.Shteti
53	Rikualifikim fasada (Blloku perballe rruges paralele me murin e Portit)	83,331,000	49,095,770	Procedurë e hapur	34,235,230	Buxh.Shteti
	Studim projektim “Projekt zbatimi i sheshit publik para hyrjes se Portit”	25,000,000	29,868,000	Sherbime konsulence		Buxh.Shteti
	Studim projektim “Projekt zbatimi i sheshit publik dhe godina sherbimi institucionale prane Mauzoleumit te Deshmoreve”	30,400,000	36,348,000	Sherbime konsulence		
54	Blerje Hard Disk 4T	35,000	27,800	Prokurim me vlere te vogel	7,200	Buxh.Bashk
55	Blerje aparat fotografik	200'000	128,300	Prokurim me vlere te vogel	71,700	“
56	Blerje mirembajtje sherbimi Internetit	208,333	108,990	Prokurim me vlere te vogel	99,343	“
57	Blerje Tablet	50,000	50,000	Prokurim me vlere te vogel	0	“
58	Blerje materiale	60,000	60,000	Prokurim me vlere te vogel	0	“
59	Riparim kondicioneri dhe furnizimi me gaz	30,000	28,200	Prokurim me vlere te vogel	1,800	“
60	Riparim fotokopje Canon IR-2018	21,000	14,200	Prokurim me vlere te vogel	6,800	“
61	Blerje materiale per Keshillin Bashkiak	10,000	10,000	Prokurim me vlere te vogel	0	“
62	Blerje dhurata simbolike dhe dosje per konferenca	54,000	43,250	Prokurim me vlere te vogel	10,750	“
63	Blerje dhe montim Kondicioner Mural 12.000 BTU	43,000	42,000	Prokurim me vlere te vogel	1,000	“
64	Riparim i mjeteve metarge DR4387D, DR1513D te Policise Bashkiake	107,500	66,250	Prokurim me vlere te vogel	41,250	“
65	Blerje dhurate simbolike (pamje nga Durresi)	2,500	1,958	Prokurim me vlere te vogel	542	“
66	Pajisje me Police Sigurimi te detyrueshem per automjetin me targe DR2998D me afat nje vjeçar	14,000	11,667	Prokurim me vlere te vogel	2,333	“

67	Pajisje me Police Sigurimi te detyrueshem per automjetin me targe DR 6968 Eme afat nje vjeçar	29,350	24,167	Prokurim me vlere te vogel	5,183	“
68	Sherbimi dhe mirembajtja e Banesave Sociale Bashkia Durres, te kater ashensoreve dheambjenteve te perbashketa per kater seksione	250,000	245,000	Prokurim me vlere te vogel	5,000	“
69	Blerje Shtypshkrime	373,000	133,500	Prokurim me vlere te vogel	239,500	“
70	Blerje tre kompiutera	125,000	114,850	Prokurim me vlere te vogel	10,150	“
71	Riparim fotokopje Canon IR-2018	33,300	27,900	Prokurim me vlere te vogel	5,400	“
72	Blerje dy vula dixhitale	11,000	7,333	Prokurim me vlere te vogel	3,667	“
73	Blerje dhe montim kondicioner mural 12.000 BTU	50,000	43,000	Prokurim me vlere te vogel	7,000	“
74	Punime emergjente nga rreshqitjet e dheut ne kodren mbas shkembrit te Kavajes	798,570	630,000	Prokurim me vlere te vogel	168,570	“
75	Blerje e sherbimit te internetit per 1 vit kalendarik per godinen Bashkia Durres dhe Njesite Administrative (Rrashbull, Manez, Katund i Ri, Sukth, Ishem)	333,333	280,000	Prokurim me vlere te vogel	53,333	“
76	Blerje kartolina+zarfa per urimet e festave te fundvitit 5000 cope	250,000	225,000	Prokurim me vlere te vogel	25,000	“
	SHUMA:	1,092,880,826	726,623,013		366,257,813	
	TVSH 20%	218,576,165	145,324,603		73,251,563	
	TJTALI:	1,311,456,991	871,947,616		439,509,376	

Më poshtë po japim disa të dhëna statistikore të realizuar nga ky sektor për vitin 2015:

Janë zhvilluar gjithsej 76 tendera, ndër këto janë realizuar:

1. Vlerë e vogël 42
 2. Mallra 4
 3. Shërbime 6
 4. Punë Civile 24
- Gjithësej: 76


Nga vlera 1.311.456.826 lekë e parashikuar në Buxhet për prokurim, janë realizuar prokurime në vlerën 871.947.616 lekë, ku është kursyer një vlerë prej 439.509.376 lekë.

AKTIVITETI LIGJOR

Pasqyra e prokurimeve per vitin 2015

Viti 2015	Gjithesej	Nr. Procedurave sipas llojit te tenderimit			
		Mallra	Shërbime	Punë civile	Procedura me vlerë të vogël
	76	4	6	24	42

Grafikisht numëri i procedurave sipas llojit të tenderimit në përqindje paraqitet si më poshtë:



Blerjet e Vogla

Blerjet e vogla janë bërë nga komisioni i blerjeve të vogla, i ngritur për këtë qëllim sipas ligjit në fuqi.

Për vitin 2015 janë zhvilluar gjithsej 42 procedura prokurimi me vlerë të vogël, ku vlera e parashikuar është 5.268.356 lekë, vlera e prokuruar është 2.820.369 lekë, nga ku është kursyer një vlerë prej 2.447.987 lekë.

PROCEDURA PROKURIMI ME VLERE TE VOGEL 2015			
Realizuar	Fondi limit pa tvsh	Vlera e prokuruar pa tvsh	Vlera e kursyer
42	5.791.786	3.215.576	2.576.210
TVSH 20%	1.158.357	643.115	515.242
Totali:	6.950.143	3.858.691	3.091.452

AKTIVITETI LIGJOR

Prokurimet e realizuara në vite, nga Sektori i Prokurimeve Publike, jepen në tabelat e mëposhtëme:

Vlera e prokuruar në vite për tenderat sipas burimit të fondeve

Ne lek

Emertimi	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Prokur. me fonde nga të ardhur. e Bashkise	239,961,253	142,038,182	495,359,587	160,557,451
Prokurime me fonde buxhetore	-	-	1,010,636,786	711,390,165
Prokurime me fonde nga donacionet	-	-	3,466,666	-
Gjithsej:	239,961,253	142,038,182	1,509,463,039	871,947,616

Vlera e prokuruar në vite për fondet e prokuruar

Ne lek


Vitet	Nr. Tenderave	Fondi limit	Vlera e prokuruar	Kursyer
Viti 2004	23	1,335,246,114	1,276,261,911	58,984,203
Viti 2005	33	344,045,208	311,164,845	32,880,363
Viti 2006	34	846,236,713	803,747,260	36,369,453
Viti 2007	30	439,922,000	380,867,401	59,054,599
Viti 2008	42	676,221,904	547,787,277	128,434,627
Viti 2009	63	575,016,958	455,044,600	119,972,358
Viti 2010	43	1,414,216,873	1,124,569,348	289,647,525
Viti 2011	12	407,221,841	298,101,582	109,120,259
Viti 2012	25	567,948,700	239,961,253	327,987,447
Viti 2013	16	220,651,184	142,038,182	57,651,002
Viti 2014	50	1,963,569,914	1,509,463,039	454,106,875
Viti 2015	76	1,311,456,991	871,947,616	439,509,376

Burimi i te dhenave: Sektori i Prokurimeve Publike

Sic shihet nga tabela e mësipërme, vlera e prokuruar për cdo vit është më e vogël se fondi limit. Vetëm për vitin 2015, i janë kursyer Buxhetit të Bashkisë Durrës për 76 procedura prokurimi, rreth 439.509.376 lekë.

Grafikisht vlera e prokuruar në vite për fondet e prokuruar paraqitet si më poshtë

AKTIVITETI LIGJOR



Nga grafiku i mësipërm vihet re se vlera e prokuruar për fondet e vitit 2015 në krahasim me vitin 2014, ka pasur një ulje në masën 42%.

Gjithashtu nga **Zyra e Gjendjes Civile pranë Drejtorisë Ligjore**, për vitin 2015 janë:

Spektori i Pronave Publike dhe Menaxhimi i Aseteve, vepron në përbërje të Drejtorisë Ligjore dhe ka për detyrë:

- Menaxhimin e Aseteve të Bashkisë (dhënia me qera)
- Inventarizimin dhe regjistrimin në Z.V.R.P.P të Aseteve të Bashkisë.

Në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitoaze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 529, date 8.6.2011 “ Për përcaktimin e kritereve , të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitoaze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (aktualisht i shfuqizuar), janë ndjekur procedurat e dhënies me qira të objekteve të ndërmarrjeve, institucioneve të varësisë.

AKTIVITETI LIGJOR

Në kuadër të plotësimit dhe përmirësimit të dokumentacionit për dhënien me qira të objekteve është bashkëpunuar me drejtorinë e urbanistikës për përgatitjen dhe konfirmimin e genplaneve me qëllim saktësimin e sipërfaqeve të dhëna.

Në tabelat e mëposhtme, pasqyrohen të dhëna të detajuara mbi numrin e objekteve të dhëna me qera, sipërfaqeve, dhe të ardhurave që janë arkëtuar nga dhënia e këtyre objekteve për vitet 2014 dhe 2015 si dhe detyrimet dhe të ardhurat nga objektet e dhëna me qera nga Bashkia dhe ndërmarrjet e institucionet e varësisë, për vitet 2014 dhe 2015.

Emertimi i subjekteve	Nr. i objekteve te dhena me qera		Siperfaqja ne m2		Detyrim e në leke	Arketime në leke	Detyrime në leke	Arketime në leke
	Viti	'142015	2014	2015				
Objekte te Bashkise								
URT	7	5	1669.7	1246.7	2606281	2606281	2738690	2738690
Klubi Bashkise	1	1	36	36	68992	68992	84480	84480
Baza prodhuese								
Markata	2	2	204.5	204.5	438827	438827	484464	484464
Total:	10	8	1910.2	1487.2	3114100	3114100	3307634	3307634

Emertimi i subjekteve	Nr. i objekteve te dhena me qera		Siperfaqja ne m2		Detyri me në leke	Arketime	Detyrime në leke	Arketime në leke
Viti	‘14	2015	2014	2015	2014		2015	
Njesite vartese								
Qendra Kulturore	8	7	346.93	324.13	1408804	1375960	1408788	1408788
Qendra Ek.Arsimore								
Klubi shumsporteve	2	2	493.6	493.6	882144	882144	906192	906192
Nd. Komunale Plazh	1		41.6		33840	33840		
B.G.T	6	6	1303	1050	2002850	1952850	2049400	2049400
Parku Mall. Eksportit	11	12	1154.1	1223.58	2321574	2321574	2852237	2852237
Ndermarrja Rruga	8	6	315	191	446400	446400	365664	365664
Total:	36	33	3454.23	3282.31	7095612	7012768	7582281	7582281

Burimi i te dhenave: Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimi i Aseteve

AKTIVITETI LIGJOR

Nga tabelat e mësipërme shohim se për vitin 2015, të ardhurat e arkëtuara nga qerat e objekteve të Bashkisë si dhe të njësive vartëse janë realizuar në masën 100%.

-Dy ndërmarrjet: B.G.T dhe Parku i Mallrave të Eksportit, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014, të ardhurat, ndahen 50 % i merr Bashkia dhe 50% i ka ndërmarrja.

Të ardhurat e arkëtuara për vitin 2015 nga qerata e objekteve të Bashkisë dhe Njësive vartëse kapin vlerën në 000/lekë 10.890.

Të ardhurat e arkëtuara në vite nga dhënia me qera e objekteve janë si më poshtë:

000/lekë

Vitet	Të ardhurat nga arkëtimet
Viti 2005	4.284
Viti 2006	7.552
Viti 2007	7.097
Viti 2008	10.949
Viti 2009	10.571
Viti 2010	11.518
Viti 2011	10.629
Viti 2012	11.472
Viti 2013	10.307
Viti 2014	10.127
Viti 2015	10.890

2-Inventarizimi dhe regjistrimi i pronave

Në bashkëpunim me ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë, sipas kërkesave të përcaktuara nga ligji nr. 33/2012 “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme“, janë kryer veprime pranë Z.V.R.P.P.-së Durrës për rregjistrimin e aseteve që administrohen nga Bashkia, ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë. Po punohet për marrjen e dokumentave të pronësisë ku Bashkia është pronare.

Me VKM nr.536, datë 01.05.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave të pasurive të paluajtshme publike, shtetërore që i transferohen në pronësi ose përdorim Bashkisë Durrës.

AKTIVITETI LIGJOR

Me këtë vendim kanë kaluar në pronësi 938 prona dhe në përdorim 221 prona. Gjithsej 1159 prona. Deri në momentin e kontrollit nga ana e Bashkisë Durrës janë rregjistruar pranë Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme gjithsej 33 prona, e konkretisht:

1. Godina e Bashkisë	(6 prona në listë)
2. Rajoni Nr. 1,2,3,4,5	(8 prona në listë)
3. Shtëpia e Foshnjes	(1 pronë në listë)
4. Ndërmarrje BGT	(9 prona në listë)
5. Makina Impeks	(4 prona në listë)
6. Qendra Kulturore e Fëmijëve	(1 pronë në listë)
7. Klubi i Futbollit “Teuta”	(1 pronë në listë)
8. Vendstrehim	(1 pronë në listë)
9. Vendstrehim	(1 pronë në listë)
10. Pallati i Sportit “Ramazan Njala”	(1pronë në listë).

- Nga ana e zyrës së Administrit të Aseteve të Bashkisë ka vijuar puna për rregjistrimin e pronave që me VKM nr.536, datë 01.05.2008 kanë kaluar në pronësi, duke hartuar dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor dhe është aplikuar pranë ZVRPP-së Durrës për 168 prona që i përkasin **zërit ndërtim**, siç janë asetet:

1. E sistemit parashkollor, parauniversitar Q.E.A për 41 prona, nga ku 19 prona shkolla “8 vjecare”, 9 prona “shkolla të mesme”, 9 prona kopshte, 3 prona cerdhe si dhe Baza Prodhuese e Arsimit.	
2. Ndërmarrja Shërbim Komunale	28 prona
3. Ndërmarrja Rruga	6 prona
4. Parku i Eksportit	10 prona
5. Parku Udhëtareve	29 prona
6. NPA	4 prona
7. Ndërmarrja Komunale Plazh	27 prona
8. UMB	4 prona
9. Pallati i Kulturës	2 prona

- | | |
|---|---------|
| 10. Klubi i Shumësporteve “Teuta” | 2 prona |
| 11. URT | 3 prona |
| 12. Parking te Stacioni i Trenit. | |
| 13. Poligoni dhe Objektet e Ndërmarrjes Rruga”. | |
| 14. Ish Zyrë Fronti me shkresë. | |
| 15. Depo Helmi me shkresë. | |
| 16. Tregu Bujqësor i Shumicës. | |

- **Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.**

Për asetet që kanë fushë përdorimi bujqësinë dhe ushqimin në pronësi të Bashkisë Durrës, janë kanale të treta, tokë inprodutive dhe objekte të N.B-së.

- Kalojnë në përdorim të Bashkisë Durrës “ Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë produktive si arë, pemëtore, ullishte, vreshtë.

Bashkisë, i kanë kaluar gjithsej 32 prona në pronësi në fushën e bujqësisë, nga keto në pronësi 28 prona janë të ndara ose të zaptuara dhe vetëm për 3 prona janë pa kufizim, gjithsej 54 ha dhe kjo tokë inprodutive (shkëmbore, ledh, kullotë).

Në përdorim kanë kaluar 7 prona (toka produktive) prej 110 ha, prona të cilat u janë ndarë punonjësve dhe dhënë në përdorim.

- Në pronësi të Bashkisë kanë kaluar dhe prona të emërtuara “vendstrehim” dhe që kanë **destinacion mbrojtjen**. Janë kaluar në pronësi 472 vendstrehime, janë pa numër pasurie dhe indeks harte.
- Eshtë revokuar e drejta e pronësisë për 5 prona, hequr nga lista e inventarit me VKM nr. 983 dt. 02.07. 2008 dhe VKM Nr. 1051 Prot. Dt. 22.12. 2010.
- 189 prona të miratuara me VKM nr.536, date 01.05.2008 janë rrugë, rrugica, të cilat nuk janë rregjistruar pasi ka pasur pengesa serioze nga ana e ZVRPP-së Durrës, për mospërputhje të dhënave teknike të miratuara me VKM nr.536, datë 01.05.2008, të gjendjes në fakt dhe të gjendjes në kontabilitet të ndërmarrjes.
- Janë marrë vendime të Këshillit Bashkiak për 5 prona:

AKTIVITETI LIGJOR

Për 62 prona, të cilat janë në inventar të institucioneve të tjera (jo të Bashkisë) dhe që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë, si asetet që kanë fushë përdorimi shëndet parësor, bujqësi, gjelbërim i lartë pyjor, i është kërkuar që të ngrejë grupe pune për dorëzimin e aseteve që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë.

Gjithashtu, ka vazhduar puna për rregjistrimin e atyre aseteve për të cilat është menduar se mund të kalojnë në fond banese, lidhja e kontratave me qera sociale apo përdorimi i tyre për interes publik. Pjesa dërmuese e këtyre aseteve janë në administrim të Ndërmarrjes Komunale Plazh.

POLITIKAT ZHVILLUESE

Drejtoria e Politikave Zhvilluese, në mbështetje të strategjisë së Institucionit të Bashkisë bashkëpunon me të gjithë partnerët e mundshëm brenda dhe jashtë vendit, për të ndërtuar politika që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë, për të thithur projekte dhe për t'i vënë në shërbim të komunitetit të Durrësit.

Kjo Drejtori, ka në fokus të punëve të saj, orientimin drejt politikave të një zhvillimi të qendrueshëm në aktivitetet që ndërmerr Bashkia Durrës . Roli i saj është jo vetëm koordinues me të gjitha sektorët dhe drejtoritë e Bashkisë, por funksionon në të njëjtën kohë si njësi e rëndësishme kontakti në nivel Kombëtar edhe Ndërkombëtar duke përmbushur detyrën e marrëdhënieve me jashtë dhe të qenurit kontakti kryesor i Institucionit.

Kjo Drejtori, gjithashtu shërben si një qendër informacioni statistikor, ku mblidhen të dhëna për gjendjen social ekonomike të qytetit të Durrësit, të cilat shërbejnë për efekte studimore në programet e zhvillimit dhe në bazë të tyre bëhet monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Vendor. Në bazë të të dhënave statistikore hartohet dhe Buletini Vjetor Informativ-Statistikor i Bashkisë Durrës.

Në përbërje të këtij departamenti janë **Spektori i Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit** si dhe **Spektori i Analizës, Statistikës dhe Planifikimeve afatmesme**.

Gjatë vitit 2015, nga **Spektori i Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit** është punuar:

Ky sektor, është i gjithëpërfshirë në mbështetje të projekteve në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar.

-Në kuadër të projekteve **Cross Border programi IPA Adriatik 2007-2013**, vazhdon menaxhimi i projektit ADRIACOLD , ku Bashkia e Durrësit është partnere dhe përfituese në këtë projekt. Ky projekt, ka të bëjë me përhapjen e teknologjive ftohëse dhe freskuese duke përdorur si burim Energjinë Diellore në rajonin e Adriatikut. Është një projekt european, që konsiston në promovimin e sistemeve të freskimit që ushqehen nga nxehtësia e prodhuar nga panelat diellore, dhe si rrjedhojë uljen e konsumit të energjisë elektrike për ajrin e kondicionuar. Projekti ka filluar në Tetor 2012 dhe ka një kohëzgjatje deri në vitin 2015.

Më poshtë, po paraqesim pamje nga aktivitetet në kuadër të zbatimit të këtij projekti:


POLITIKAT ZHVILLUESE

Aktivitete në kuadër të projektit “ADRIACOLD”



POLITIKAT ZHVILLUESE

Aktivitete në kuadër të projektit “ADRIACOLD



POLITIKAT ZHVILLUESE

Bashkia Durrës merr pjesë suksesshëm në Programin IPA CBC 2007 -2013 në fushën e Turizmit dhe atë të Mjedisit. Kjo krijon mundësi të financimit për projektet për Turizmin :

Së shpejti fillon zbatimi i projekteve jo vetëm me rëndësi Lokale por edhe Kombëtare dhe aq më tepër Rajonale .

Nisma një “Epokë e re Urbane” për qytetin me Planin e Ri Rregullues, me Rijetëzimin e “ Sheshit Liria”, me zbatimin e një programi rikualifikimi për rikthimin e hapësirave publike dhe krijimin e një qyteti policentral, janë projekte, të cilat ndikojnë në zhvillimin e një turizmi të qendueshëm.

Këto kulmojnë me Studimin e vijës bregdetare, projekt të cilin e kemi emërtuar “ Vija e Kaltër” e Durrësit që mundësohet, nga krijimi i një infrastrukture moderne të: Portit Turistik- Shëtitores Taulantia - Zona beryl-currila deri tek zhvillimi i turizmit elitar në Kallm.

Sheshet e reja që i janë rikthyer qytetarëve edhe qytetit, janë përshtatur me hapësirat publike në shërbim të vizitorëve turistë. “ Sheshi Liria ” është pjesë e këtij transformimi, me ndërtimin e një galerie të arteve të bukura, me një sipërfaqe rreth 90 m ². Ky shesh, në Rijetëzimin e “Qendrës historike ” të qytetit, lidhet me “ Sheshin Demokracia” me anë të bulevardit “Dyrrah ” që ka një hapësirë për këmbësorë prej 5000 m ² dhe me një pistë ciklistike 390 metër linearë.

Projekti i Ndërtimit të Pishinave të qytetit, një kompleks i mirëfilltë sportiv do të vihet në shërbim të rinjëve të qytetit. Ka përfunduar projekt - zbatimi dhe konceptet e projektit janë: “ Pishina Olimpikë dhe Sportet”, dy fusha volejboli dhe basketbolli, dy fusha tenisi, ambiente shërbimi për kompleksin sportiv dhe hapësira publike në ajër të pastër.

Gjithashtu, nga ky sektor për vitin 2015, në kuadër të turizmit është punuar:

- Në bashkëpunimin me Agjensinë Kombëtare të Turizmit, me Prefekturën, Këshillin e Qarkut, por edhe me ndërmarrjet e saj të varësisë duke programuar punën për përgatitjen dhe mbarëvajtjen me sukses të sezonit turistik 2015.
- Po ashtu në bashkëpunim me Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit u përcaktuan vendet për mjetet motorrike të ujit në mënyrë që të mos përsëriteshin ngjarje jo të pëlqyera me pushuesit që preferuan në këtë sezon plazhin e Durrësi.

POLITIKAT ZHVILLUESE

- Nga ana tjetër janë marrë masa për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme artistike e kulturore në mënyrë që sezoni të kete sa më shumë gjalleri dhe pjesmarrje të publikut vendas dhe turistëve të ndryshëm.

Prioriteti i Bashkisë Durrës ka qenë dhe është rritja gjithnjë e më shumë e fluksit të vizitorëve të ndryshëm duke hapur mundësi për rritjen e vazhdueshme të turizmit si një nga prioritetet e zhvillimit ekonomik të qytetit tonë e materjalizuar edhe në strategjinë lokale të zhvillimit ekonomik.

Turizmin, Bashkia e Durrësit e ka trajtuar si një çështje pa kufij, e cila intersektohet me mjedisin, zhvillimin ekonomik, shërbimet, tregtinë, transportin, rendin e qetësinë publike, ndërtimet dhe ndërkohë është pasur parasysh ruajtja e vijës bregdetare prej 6 Km. Performanca e turizmit dhe përmiresimi i shërbimeve e mbështetur nga politikat e ndjekura nga Bashkia Durrës, bën të mundur, që në një pik sezoni prej 150 mijë pushues, me të ardhura mbi 120 milionë EURO në vit (vlerësimet e UAMD), ta vendos atë në vendin e parë të listës së kontribuesve të produktit turistik shqiptar.

Trashegimia Kulturore është pasur parasysh në projektet ambicioze të Bashkisë Durrës, duke e kthyer këtë qytet si një vitrinë të vizitueshëm nga të gjithë.

Spektori i Analizës Statistikës dhe Planifikimit Afatmesëm, pranë Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit, ka si qëllim: të krijojë bazën e të dhënave statistikore të zhvillimit demografik, ekonomik dhe social të qytetit si dhe të gjitha statistikat e tjera për Bashkinë Durrës, të përpunojë dhe të publikojë informacionin statistikor duke shërbyer si qendër informimi statistikore dhe të hartoj Buletinin Informativ Statistikor Vjetor.

Gjatë vitit 2015, nga **Spektori i Analizës, Statistikës dhe Planifikimeve afatmesme** është punuar për:

-Përgatitjen e **Programit Buxhetor Afatmesëm**.

- Nga ky sektor bëhet dhe planifikimi afatmesëm, që në bashkëpunim me GSBI dhe EMP, përcaktohen listimi i projekteve prioritare nga Plani Strategjik i Zhvillimit që do të shërbejnë si programe me fokus projektet kapitale për buxhetin afatmesëm.

POLITIKAT ZHVILLUESE

- Në lidhje me këtë, në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe pikës 67 të Udhëzimit nr.8 dt.29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm ", ky sektor ka zbatuar afatet për përgatitjen e PBA në bazë të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.
- Eshtë punuar në përgatitjen e formateve me komponentët e Profilit të Programit, të cilat janë elementet e Deklaratës së Politikës së Programit si:
 - Emri i Programit
 - Përshkrimi
 - Politika e Programit
 - Qëllimi i Politikës për periudhën 2017-2019
 - Objektivat e politikës / 10 hapa për percaktimin e objektivave
 - Kriteret e përzgjedhjes së objektivave të programit
 - Produktet e programit me fokus projektet kapitale
 - Aktivitetet e lidhura me produktin e programit
 - Burimet
- Për të vijuar më pas nga Sektori i Buxhetit me percaktimin e Shpenzimeve të Programit dhe Tavanet e Programit si dhe me Drejtorinë e Tatim Taksave me Parashikimin e të ardhurave.
- Plotësimi i formularëve Nr.1 "Parashikimi i të ardhurave" dhe Nr.2 "Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 3-vjecare"si dhe relacionin për mënyrën e llogaritjes së PBA dhe dorëzimin brenda datës 1 Qershor të cdo viti pranë Ministrisë së Financave.

-Në lidhje me **statistikat**, ky sektor ka punuar për:

- Krijimin në vazhdimësi të bazës statistikore të të dhënave të Bashkisë Durrës. Për këtë vitë, me ndarjen e re territorial, janë mbledhur të dhëna statistikore dhe për funksionet e deleguara si bujqësia, blegtoia etj. për të cilat nuk kemi pasur bazë të dhënash, duke krijuar dhe për to data base përkatës.

POLITIKAT ZHVILLUESE

- Bashkepunimin dhe thithjen e informacionit statistikor nga të gjitha drejtoritë, ndërmarrjet dhe institucionet në varësi të Bashkisë si dhe ato jashtë varësisë së saj.
- Ruajtjen, përpunimin e të dhënave statistikore dhe analizimin e indikatorëve të zhvillimit ekonomik.
- Përgatitjen e evidencave të ndryshme statistikore të Bashkisë si:
 - Evidencën statistikore mbi realizimin e të ardhurave vendore dhe dorëzimin në Prefekturën e Qarkut Durrës çdo muaj.
 - Evidencën statistikore mbi Numrin e Punonjësve, Punë-Pagave dhe Investimeve të Bashkisë dhe dergimin e tyre pranë Drejtorisë së Statistikave Durrës në çdo 3/muaj.
- Gjithashtu nga ky sektor janë hartuar dhe Buletini Informativ Statistikor Vjetor 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Më poshtë po japim disa të dhëna statistikore për **turizmin**.

- Gjatë vitit 2015, në territorin e Bashkisë së Durrësit kanë ushtruar aktivitetin **78 hotele**.
Nga këto:
 - Durrësi, ka 68 hotele dhe Motele me 1606 dhoma dhe numër shtretër 5149
 - Rrashulli, ka 10 hotele dhe Motele me 165 dhoma dhe numër shtretër 251**Bashkia Durrës, ka 78 hotele me 1771 dhoma 5400 shtretër**
- **Sipas Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit** për vitin 2015, numëri i shtetasve të huaj dhe shqiptarë që kanë hyrë - dalë është 773.648 shtetas nga 789.998 shtetas që kanë hyrë-dalë për vitin 2014, ose 16.350 shtetas më pak.

Udhëtarët Shqiptarë dhe të huaj që kanë hyrë-dalë në Shqipëri për viti 2015

Udhëtarë	Hyrë-Dalë	Hyrë në Shqipëri	Dalë nga Shqipëria
Shqiptarë	553.248	253.015	300.233
Të huaj	220.400	105.266	115.134
Gjithsej:	773.648	358.281	415.367

Burimi i te dhenave: Drejtora e Kufirit dhe Migracionit

POLITIKAT ZHVILLUESE

Sipas Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për vitet 2014 dhe 2015 , numërin më të madh të shtetasve të huaj që kanë hyrë në Shqipëri e përbëjnë:

	Viti 2014	Viti 2015
• Itali	46.708	46.766
• Kosova	35.540	26.663
• Maqedoni	15.831	13.721
• Zvicër	4.460	4.185
• Angli	2.765	1.764
• France	2.571etj.	2.288 etj.

Sipas qëllimit të udhëtimit për vitet 2014 dhe 2015 shtetasit e huaj që kanë hyrë janë:

	Viti 2014	Viti 2015
• Turizëm	61.606 shtetas	54.768 shtetas
• Biznes	2.445 shtetas	2.671 shtetas
• Vizitë	2.298 shtetas	1.788 shtetas
• Shërbim	349 shtetas	197 shtetas
• Tranzit	43.901 shtetas	34.928 shtetas
• Punësim	806 shtetas	499 shtetas
• Studime	104 shtetas	159 shtetas
• Aktivitete	27 shtetas	12 shtetas
• Të tjera	4.538 shtetas	10.137 shtetas

Sipas Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për vitet 2015, hyrje Shqiptarësh nga Rajoni janë si më poshtë:

• Shqiptarë nga Kosova	26.663 shtetas
• Shqiptarë nga Maqedonia	8.500 shtetas
• Shqiptarë nga Mali Zi	350 shtetas
• <u>Shqiptarë nga Serbia</u>	<u>756 shtetas</u>
Gjithësej:	36.269 shtetas

POLITIKAT ZHVILLUESE

Gjatë vitit 2015, Pika e Kalimit Kufitar - Port Durrës është frekuentuar në total nga **259 mjete lundruese turistike** me **3970 turistë** nga këto:

247 Jahte Turistike me **770** turistë

12 Krocera me **3200** turistë

- Numri i shtetasve të cilët kanë frekuentuar PKK Port Durrës me mjete lundruese turistike gjatë vitit 2015 është 3.970 shtetas me 259 mjete lundruese.
- Për vitin 2015, sipas statistikave të **Autoritetit Portual**, numri i shtetasve të huaj dhe shqiptarë që kanë hyrë-dalë, është 774.411 shtetas dhe numri i mjeteve është 216.918 nga këto:

Viti 2015

Udhëtarë	Hyrë-Dalë	Hyrë në Shqipëri	Dalë nga Shqipëria
Shqiptarë	498.189	227.451	270.738
Të huaj	171.468	90.511	80.957
Të mitur	104.754	47.166	57.588
Gjithsej:	774.411	365.128	409.283
Mjete gjithsej	216.918	116.589	100.329
Vetura	152.497	82.519	69.978
Kamiona	58.494	30.953	27.541
Trajlera	5.927	3.117	2.810


Më poshtë po paraqesim për vitet 2012-2013-2014 dhe 2015, statistikën sipas Autoritet Portual për hyrje-daljen e pasagjereve dhe mjeteve.

Emertimi	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Pasagjere total	798.524	717.399	774.682	774.411
Pasagjer shqiptare	474.117	442.617	479.675	498.189
Pasagjere të huaj	208.331	178.747	194.134	171.468
Pasagjer të mitur	116.076	96.035	100.873	104.754
Mjete total	245.840	215.701	215.081	216.918
Autovetura	183.263	152.272	150.703	152.497
Kamiona	51.673	55.145	57.031	58.494
Trajlera	10.904	8.284	7.347	5.927

Burimi i te dhenave: Autoriteti Portual

POLITIKAT ZHVILLUESE

Paraqitja grafike e pasagjerëve që kanë hyrë-dalë në Shqipëri për vitet 2011-2015 ndarë sipas grupeve, duke iu referuar të dhënave të Autoritet Portual është:



- Për periudhën qershor-korrik-gusht-shtator të vitit 2015, që është dhe fluksi më i madh i turistëve, numri i turistëve që kanë hyrë-dalë, është 448.631 persona.

Në mënyrë të detajuar, po paraqesim tabelën e realizimit të hyrjeve dhe daljeve të turistëve nga tragetet gjatë muajve qershor-korrik-gusht-shtator për vitin 2015 si më poshtë:

Realizimi i hyrjeve të turistëve nga tragetet gjatë muajve Qershor-korrik-gusht-shtator për vitin 2015

Emertimi	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	4/m
Pasagjere total	20.325	61.087	103.105	20.919	205.436
Pasagjer shqiptare	12.869	30.652	62.095	13.430	119.046
Pasagjere të huaj	4.904	18.929	22.338	5.792	51.963
Pasagjer të mitur	2.552	11.506	18.672	1.697	34.427

POLITIKAT E ZHVILLIMIT

Realizimi i daljeve të turistëve nga tragetet gjatë muajve Qershor-korrik-gusht-shtator për vitin 2015

Emertimi	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	4/m
Pasagjere total	17.457	28.861	143.163	53.714	243.195
Pasagjer shqiptare	12.671	18.666	82.408	35.236	148.981
Pasagjere të huaj	3.151	6.008	31.796	9.391	50.346
Pasagjer të mitur	1.635	4.187	28.959	9.087	43.868


Realizimi i hyrje-daljeve të turistëve nga tragetet gjatë muajve Qershor-korrik-gusht-shtator për vitin 2015

Emertimi	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	4/m
Pasagjere total	37.782	89.948	246.268	74.633	448.631
Pasagjer shqiptare	25.540	49.318	144.503	48.666	268.027
Pasagjere të huaj	8.055	24.937	54.134	15.183	102.309
Pasagjer të mitur	4.187	15.693	47.631	10.784	78.295

Burimi i te dhenave: Autoriteti Portual

Paraqitja grafike e hyrje-daljeve të turistëve nga tragetet gjatë muajve Qershor-korrik-gusht-shtator

Viti 2015




POLITIKAT E ZHVILLIMIT

**Realizimi i hyrje-daljeve të turistëve (shqiptare, të huaj dhe të mitur)
nga tragetet gjatë muajve qershor-korrik-gusht-shtator për vitet 2011-2015**

Emertimi	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Pasagjere total	405.910	415.796	403.202	448.348	448.631
Pasagjer shqiptare	215.303	223.174	230.061	253.461	268.027
Pasagjere të huaj	113.513	112.827	101.881	118.809	102.309
Pasagjer të mitur	77.094	79.795	71.260	76.078	78.295

Paraqitja grafike e Realizimit hyrje-dalje të turistëve (shqiptare, të huaj dhe të mitur) nga tragetet gjatë muajve qershor-korrik-gusht-shtator për vitet 2011-2015 paraqitet si më poshtë:



Sic vihet re nga tabela, numri i turistëve në këto katër muaj, kur dhe fluksi është më i madh, për vitin 2015 në krahasim me vitin 2011, është rritur në masën 10.5%, krahasuar me vitin 2012, është rritur me 7.9%, krahasuar me vitin 2013, është rritur në masën 11.3% dhe krahasuar me vitin 2014, është rritur në masën 0.1%.

Pra për vitin 2015, numëri i pasagjerëve që kanë hyrë dhe dalë në Shqipëri ka ardhur duke u rritur dhe për vitet 2014-2015, numëri i pasagjerëve është pothuajse i njëjtë.

POLITIKAT E ZHVILLIMIT

Përsa i përket numrit të turistëve (vizitorëve) që kane vizituar Muzeun Etnografik në qytetin e Durrësit për vitin 2015, janë **500 vizitorë**, nga të cilët 357 vendas dhe 143 të huaj.

Në tabelën e mëposhtëme po japim disa të dhëna statistikore për numrin e vizitorëve që kanë vizituar Amfiteatrin dhe Muzeun Arkeologjik në qytetin e Durrësit për vitet 2010-2015.(Në Muzeun Arkeologjik gjatë viteve 2012-2014, nuk ka pasur vizitorë pasi ka qenë në rikonstruktion).

Numri i vizitorëve në vitet 2010-2015

Viti	Amfiteatri			Muzeu Arkeologjik			Vizitorë gjithësej
	Vizitorë vendas	Vizitorë të huaj	Delegacion + nxënës	Vizitorë vendas	Vizitorë të huaj	Delegacion + nxënës	
2010	140	2738	4677	625	1802	4720	14729
2011	184	3068	4913	565	1515	4450	14695
2012	116	3527	3612				7255
2013	42	3775	2680				6497
2014	96	6616	3073				9785
2015	229	5928	5202	1223	2623	9668	24873

Burimi i të dhënave :Drejtoria Rajonale e Kultures Kombetare Durrës

Të ndryshme

Gjatë vitit 2015, sektori ka qenë pjesmarrës në aktivitetet dhe workshopet e ndryshme që ka organizuar Drejtoria e Politikave të Zhvillimit në Bashki në kuadër të projekteve.

Ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme.

Më poshtë po paraqesim foto nga aktivitetet e organizuar në kuadër të projekteve:

URBANISTIKA

Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Durrës, gjatë vitit 2015, ka kryer misionin e saj në zbatim të studimeve, zbatimit të politikave dhe strategjive për zhvillimin, administrimin dhe kontrollin e territorit të qytetit të Durrësit në përputhje me ligjin e Planifikimit të Territorit dhe akteve të tjera ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Kjo Drejtori funksionon në bazë të sektorëve të mëposhtëm:

- Sektori i Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun.
- Sekretaria Teknike dhe Arkiva.
- Sektori i Studim-Projektimit dhe Kontrollit Teknik.
- Sektori i Kadastrës Urbane.
- Inspektoriat i Mjedisit.
- Njësia e Projektimit dhe Infrastrukturës

Sektori i Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun gjatë vitit 2015, ka bërë:

- Shqyrtimin e të gjitha praktikave që lidhen me kërkesë-ankesat e qytetarëve, për lejet e sheshit dhe lejet e ndërtimit të dhëna para hyrjes në fuqi me efekte të plota të Ligjit: “Për Planifikimin e Territorit”.
- Koordinimin e punës me Sektorin e Kadastrës Urbane për të gjitha aplikimet e paraqitura për certifikimet e relievit, për aktet e kontrollit të piketimit të objekteve dhe kontrollit të kuotës +/-0.00, në mbështetje të Nenit Nr. 54 të Ligjit të Urbanistikës si dhe të programeve të hartuara nga vetë Departamenti.
- Ofrimin e asistencës ligjore.
- Pritjen e popullit pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, në përmbushje të detyrimit për shërbimin ndaj qytetarëve.
- Ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve gjyqësore që kanë lidhje me problemet e urbanistikës.
- Kontrollin e praktikave të paraqitura nga institucionet e ndryshme për privatizim të objekteve shtetërore në mbështetje të V.K.M në fuqi.

URBANISTIKA

Sekretaria Teknike dhe Arkiva, në bashkëpunim me të gjithë sektorët e tjerë të këtij departamenti, gjatë vitit 2015:

- Ka kryer kontrollin dhe pranimin e kërkesave për leje sheshi dhe leje ndërtimi të paraqitura nga qytetarët dhe subjektet ndërtuese.
- Ka kryer protokollimin e të gjitha kërkesave drejtuar Drejtorisë së Urbanistikës, ndarjen sipas sektorëve dhe kthimin e përgjigjeve përkatëse.
- Ka kryer dhe përgatitur në bashkëpunim me Sektorin e Studim-Projektimit, autorizimin e pagesave për objektet e miratuara sipas kategorive përkatëse që për koston e ndërtimit për m² për qytetin e Durrësit është 31709 lekë.
- Ka rakorduar me financën në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit
- Janë miratuar 70 kërkesa për vitin 2015 si në tabelën e mëposhtme:

Viti 2015

Kerkesa te miratuara	Sasia
Leje perdorimi	32
Leje perdorimi për ndrysh. Funksioni perdorimi	3
Leje ndertimi	13
Leje ndertimi per investime publike	22
Total:	70

Burimi i te dhenave: Departamenti Urbanistik

Sektori i Studim-Projektimit dhe Kontrollit Teknik gjatë vitit 2015, ka kryer:

- Kontrollin mbi akt-kontrollet e karabinave dhe sistemeve përfundimtare të objekteve sipas kërkesave të depozituara.
- Përfundimin e emërimit të rrugëve, shesheve, bulevardeve dhe rrugicave të qytetit.
- Përfundimin e numërimit të objekteve konform kriterëve të përcaktuara në Ligjin: “Për sistemin e Adresave „.
- Dhënien e konsulencës teknike për të gjitha problematikat e ndryshme që kanë pasur qytetarët apo subjektet ndërtuese dhe grupet e projektuesve të objekteve të paraqitura për shqyrtim tekniko-ligjor.

URBANISTIKA

- Pjesmarrjen në disa grupe pune për marrjen në dorzim të një sërë projektsh.
- Pjesmarrjen në disa grupe pune për të dhënë specifikime teknike për investime të ndryshme në Bashkinë e Durrësit.

Spektori i Kadastrës Urbane gjatë vitit 2015, ka kryer:

- Përfundimin e 15 kërkesave për certifikime relieve nga 20 kërkesa të depozituara pranë këtij sektori.
- Përfundimin e 55 kontrolleve të piketimit dhe kuotave 00 nga 59 të depozituara.
- Në bashkëpunim me Sektorin e Pronave dhe Menaxhimit të Aseteve, matjen në terren të ambjenteve të shkollave të mesme dhe 9-vjecare, objektet e ish URT-së dhe ambjente të tjera pronë e Bashkisë për arsye të lidhjes së kontratave, përpunimin e vizatimeve të këtyre ambjenteve.
- Përgatitjen e 15 praktikave me gen-plane dhe konfirmimin e plan rilevimit të pronave që i kanë kaluar me VKM, Bashkisë Durrës.
- Përfundimin e zbatimit të sipërfaqeve të taksueshme të Autoritetit Portual Durrës.

Inspektoriati i Mjedisit pranë këtij departamenti gjatë vitit 2015 ka punuar në drejtim të:

- Realizimit të zbatimit të ligjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe dhënies së 38 përgjigjeve ligjore dhe teknike për problemet specifike të komunitetit për ndotje në mjedis si dhe janë marrë masa në bashkëpunim me Policinë Bashkiake me qëllim minimizimin e ndotjes së mjedisit urban.
- Janë prezantuar në Komisionin e Mjedisit dhe kanë kaluar në Këshill Bashkiak 16 kërkesa për pajisjen me Mendimin e Këshillit të Bashkisë.
- Janë kryer korrespondencat duke dërguar shkresat përkatëse subjekteve kërkuuese dhe Agjensisë Rajonale të Mjedisit dhe janë organizuar 36 takime me publikun.
- Sqarimit të qytetarëve dhe subjekteve të interesuara për probleme që kanë lidhje me impakte në mjedis, detyrimet ligjore, teknikat dhe teknologjitë për mbrojtjen e mjedisit.

URBANISTIKA

Njësia e Projektimit dhe infrastrukturës pranë kësaj drejtorie gjatë vitit 2015, në mbështetje të planit të investimeve të Bashkisë ka realizuar projektet e zbatimit.

-Njësia e Projektimit dhe infrastrukturës ka hartuar dokumentacione tekniko-ligjore për cdo projekt të hartuar si brenda Bashkisë ashtu dhe ato të hartuara nga studio private përsa i përket prokurimeve publike.

-Janë shqyrtuar në bazë të Ligjit të ri për planifikimin e territorit 8 praktika për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

-Janë shqyrtuar dhe janë dhënë 32 leje përdorimi.

Të ardhurat e realizuara nga Departamenti i Urbanistikës për vitin 2015, janë dhënë në tabelën e më poshteme:

Të ardhurat e realizuara për vitin 2015

EMERTIMI	PLANIFIKIMI ne leke	REALIZIMI ne leke
Taksa e Infrastruktures nga ndertimet e reja	200.000.000	28.530.918
Te ardhura nga studimet urbanistike 1%	-	3.762.840
Tarife te Urbanistikes	9.000.000	3.024.726
Takse per plazhe private	12.000.000	3.200.000
Taksa e reklames	5.000.000	2.556.780
Takse gjelberimi per cdo njesi kantjer ndertimi	7.500.000	5.600.000
Tarife pastrimi	6.000.000	3.700.000
Te ardhura nga procesi i legalizimeve (ALUIZNI)	-	90.321.247
Total:	239.500.000	140.696.511

Burimi i te dhenave:Departamenti i Urbanistikes

Nga analiza e tabelës së të ardhurave për vitin 2015 nga kjo drejtori, duke krahasuar planifikimin me realizimin e tyre, vëmë re se në total kemi një realizim në masën 58.7%.

SHENDETSI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor në qytetin e Durrësit për vitin 2015, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shëndetit Publik, është i organizuar si në tabelën e mëposhtëme:

Viti 2015

Emertimi	Rrethi Durres	Qyteti Durres
Qendra Shëndetësore me status të drejtorive nga keto: -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	18 nga keto: 1 1 1 1 1	9
Qendra Shëndetsore sipas ushtrimit të aktivitetit shëndetsor -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	39 nga keto: 5 7 1 1 7	12
Ambulanca -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	49 nga keto: 4 - 8 11 3	
Spital shtetëror		1(shtreter 340)
Spital Privat		1
Poliklinik		1
Qendra farmaceutike nga keto:	74	
Farmaci shtetore	2	2
Farmaci private me kontratë shtetore -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	72 nga keto: 1 agjensi farmaci 2 (1+1) 2 - 2 agjensi farmaci	61
Klinika dentare -Shtetore prane DRSH -Private të licensuara me mjek stomatolog -kabinete dentare (prane Q. Shendetsore Katund Sukth	115 2	1 92
Maternitet	1	1

Konsultore për gra -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	69 nga keto: 7 7 9 9 9	1
Konsultore për femije -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	84 nga keto: 7 7 9 12 9	12
Personel mjeksor me arsim të lartë -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	136 mjek nga keto: 8 mjek 9 mjek 5 mjek 4 mjek 9 mjek	79 mjek
Infermjer dhe mami -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	310 (infermjer të larte 220 dhe 90 me arsim të mesem mjeksor) 20(15 larte+5mes) 19(12 larte+7mes) 16(14 larte+2mes) 21(11 larte+10mes) 24(17 larte+7mes)	134 (inf. të larte 95 dhe 39 me arsim të mesem mjeksor)
Numri i vizitave në Qendra Shëndëtsore dhe Ambulanca -Komuna Katundi Ri -Sukth -Manez -Ishem -Rrashbull	418142 nga keto: 18153 27178 10191 15457 28551	258474
Numri i lindjeve të gjalla	2467	1646
Treguesi i vdekshmërisë amësores	0%	0%
Vdekshmëria foshnjore për 0-1 vjec	3.65%	3.65%
Niveli i vaksinimit	99.6%	98%

Burimi i të dhënave: DRSH Durres

Më poshtë po japim disa të dhëna mbi inventarin e objekteve shëndetësore (qendra shëndetsore, spitale, materitete, poliklinika dhe konsultore për rrethin dhe qytetin e Durrësit në vite :

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Vitet	Q.Shendet. me status te Drejtorive		Q.Shend.sipas ushtrimit aktiv.shendet.		Spitale				Maternitet		Poliklinika		Konsultore			
					Shtetror		Privat						Gra		Femije	
	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rr	Q	Rr	Q	Rr	Q	Rr	Q	Rr	Q	Rr	Q
2010	18	9	40	12	1	1	1	1	1	1	1	1	68	1	84	12
2011	18	9	39	12	1	1	1	1	1	1	1	1	68	1	84	12
2012	18	9	39	12	1	1	1	1	1	1	1	1	68	1	84	12
2013	18	9	39	12	1	1	1	1	1	1	1	1	68	1	84	12
2014	18	9	39	12	1	1	1	1	1	1	1	1	69	1	84	12
2015	18	9	39	12	1	1	1	1	1	1	1	1	69	1	84	12

Disa tregus statistikor për klinikat dentare dhe farmacitë për rrethin dhe qytetin e Durrësit në vite janë paraqitur në tabelën e mëposhtme :

Vitet	Farmaci		Klinika Dentare							
			Shtetore		Private		Ne shkolla		Kabinete Dentare	
	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti
2010	61	52	1	1	110	64	1	1	4	0
2011	63	61	1	1	110	74	1	1	3	0
2012	75	66	1	1	110	74	1	1	2	0
2013	76	58	1	1	101	80	1	1	2	0
2014	74	58	1	1	101	80	0	0	2	0
2015	74	61	1	1	115	92	0	0	2	0

Në tabelën e më poshtme po paraqesim disa tregues statistikor në lidhje me personelin shëndetsor për rrethin dhe qytetin e Durrësit në vite.

Vitet	Mjeke		Infermier dhe mami			
	Rrethi	Qyteti	Rrethi		Qyteti	
			Arsim i larte	Arsim i mesem	Arsim i larte	Arsim i mesem
2005	123	77		293		143
2006	124	77		293		144
2007	135	90		314		167
2008	138	80		309		160
2009	138	80		312		130
2010	139	80	5	307	3	132
2011	138	80	5	306	3	135
2012	140	81	5	306	3	132
2013	137	80	172	139	73	62
2014	138	80	173	139	73	62
2015	136	79	220	90	95	39

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Gjithashtu, në tabelën e më poshtëme po paraqesim disa tregues statistikor në lidhje me numrin e lindjeve, treguesit e vdekshmërisë, niveli i vaksinimit dhe numrin e vizitave për rrethin dhe qytetin e Durrësit në vite.

Vitet	Numri i lindjeve te gjalla		Vdekshmeria amesore %		Vdekshmeria foshnjore 0-1vjec %		Niveli vaksinimit %		Nr.vizitave ne Q.shendet. dhe Ambulanca	
	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti	Rrethi	Qyteti
2005	2618	1658	0.60	0.40			98.20	98.00	176016	123542
2006	2685	1580	0.00	0.00			98.00	98.00	174351	121417
2007	2675	1568	0.60	0.40		11.50	99.80	99.80	238360	164426
2008	2620	1609	0.00	0.00		6.80	99.80	99.80	249208	157713
2009	2688	1656	0.00	0.00		5.40	99.00	99.00	309287	196587
2010	2783	1681	0.00	0.00	10.70	10.50	99.90	99.90	379967	230945
2011	2927	1812	0.00	0.00	6.70	4.10	99.80	99.80	394132	238072
2012	2828	1785	0.00	0.00	6.00	4.50	99.90	99.90	399615	237141
2013	2842	1771	0.00	0.00	6.00	4.50	99.90	99.90	398808	249373
2014	2742	1684	0.00	0.00	3.28	1.78	99.90	99.90	399199	274965
2015	2467	1646	0.00	0.00	3.65	3.65	99.60	98.00	418142	258474

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Arsimi

Gjatë vitit 2015 shpenzimet faktike në programin e arsimit parauniversitar arritën në 82.780 mijë lekë. Shpenzimet e këtij programi zënë 3.5% të totalit të shpenzimeve faktike. Këto shpenzime përfshijnë shpenzimet operative për mirëmbajtjen dhe funksionimin e 42 institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe investimet në këtë sektor, ushqimin e fëmijëve në 6 kopshte dhe 2 konvikte, gjithashtu dhe institucionet arsimore parauniversitare të 5 njësive administrative që u shkrinë dhe ju bashkëngjiten Bashkisë Durrës nga muaji Korrik 2015.

Në mënyrë më të detajuar ato paraqiten:

000/leke

Programi i Arsimit Parauniversitar	Buxhet 2015	Fakt
Qendra ekonomike e arsimit	74.134	71.642
kopshtet dhe shkollat 9 vjecare	46.000	45.394
shkollat e mesme	3.800	3.800
konviktet	14.006	12.272
<i>Shpenzime personeli</i>	<i>2.228</i>	<i>2.047</i>
<i>Shpenzime operative</i>	<i>8.100</i>	<i>8.100</i>
<i>Investime</i>	<i>0</i>	<i>29</i>
Qendra Kulturore e Femijeve	3.000	2.524
Bashkia	22.907	8.613
TOTAL:	100.041	82.779

Investimet (shpenzimet kapitale) në Arsim për vitin 2015, në total kapën vlerën : **000/leke 37.453** nga të cilat :

-Investimet e realizuara në arsimin parauniversitar me fondet e **Buxhetit të Bashkisë** për vitin 2015 arritën në **7.473 mijë lekë**.

Më konkretisht u realizuan këto investime :

- Rikonstrukcion pjesorë i shkollës 9-vjecare me 3.073 mijë lekë.
- Ndërtim i shkollës 9-vjecare Romanat (Rrashbull), me 4.400 mijë lekë.

-Investimet e realizuara në arsimin parauniversitar me fondet e **Buxhetit të Shtetit** (fondi i zhvillimit të rajoneve) për vitin 2015 arritën në **30.000 mijë lekë**.

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Shpenzimet kapitale nga buxheti i shtetit

Për vitin 2015 fondi i alokuar nga buxheti i shtetit ishte vetëm 30.000 mijë lekë, alokuar nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve për arsimin parauniversitar vetëm për një objekt si më poshtë:

000/ leke

Objekti		Burimi i financimit	Celur ne Thesar per vitin 2015	Fakt 2015
1.	Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare B.Curri	MASH (Fondi per zhvillimin e rajoneve)	30.000	29.980
TOTALI			30.000	29.980

-Objekti **“Rikonstruksion i shkollës B.Curri ”** është nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për projektet e arsimit . Vlera e kontraktuar për këtë objekt është 96.564 mijë lekë . U financua në 2015 për 29.980 mijë lekë, mbetet për t’u financuar ne 2016 për diferencën prej 66.584 mijë lekë.

Të dhëna të përgjithëshme për arsimin në Bashkinë e Durrësit për vitin 2015

Më poshtë po japim disa të dhëna statistikore për arsimin për qytetin e Durrësit si dhe për Bashkinë Durrës pas ndarjes së re territoriale, ku futen 5 komunat si : Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katundi Ri.

Të dhënat për vitet shkollore 2013-2015, në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare të qytetit të Durrësit, si dhe për vitin 2015 për komunat e përfshira në Bashkinë e Durrësit, po i paraqesim në tabelën e mëposhteme:

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Te dhëna të përgjithëshme për arsimin në qytetin e Durrësit në vitet 2011-2015

Emertimi	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
	Total	Publik	Jo Publik	Total	Publik	Jo Publik	Total	Publik	Jo Publik
Cerdhe gjithsej	3	3	-	4	4	-	4	4	-
Femije te rregjistruar	260	260	-	330	330	-	487	487	-
Nr. edukatoreve	40	40	-	56	56	-	53	53	-
Kopeshte gjithsej	30	23	7	28	21	7	30	21	9
Femije te rregjistruar	2700	2397	303	2404	2088	316	2469	2091	378
Nr. edukatoreve gjithsej	131	110	21	117	96	21			
Shkolla gjithsej	56	30	26	58	30	28	63	30	33
Nr. i nxenesve gjithsej	27466	22549	4917	24734	20988	3746	24074	20235	3839
Nr. i mesuesve gjithsej	1314	985	329				1442	1036	406
Shkolla 9-vjecare	34	21	13	37	21	16	38	21	17
Nr. i nxenesve gjithsej	18220	15983	2237	16556	14283	2273	16058	13628	2430
Nr. i mesuesve gjithsej	877	686	191	882	676	206	937	697	240
Shkolla te Mesme gjithsej	22	9	13	21	9	12	25	9	16
Nr. i nxenesve	9246	6566	2680	8147	6705	1442	8016	6607	1409
Nr. i mesuesve gjithsej	445	314	131				505	339	166
Shkolla te Mes. te Pergj	13	4	9	15	5	10	20	5	15
Nr. i nxenesve	6525	3984	2541	5299	3992	1307	4888	3609	1279
Nr. i mesuesve	263	161	102				390	245	145
Shkolla Profesionale	5	4	1	5	4	1	5	4	1
Nr. i nxenesve	2626	2582	44	2757	2713	44	3031	2998	33
Nr. i mesuesve	170	153	17				102	94	8
Shkolla Fetare	1	-	1	1	-	1	1	-	1
Nr. i nxenesve	95	-	95	91	-	91	97	-	97
Nr. i mesuesve	12	-	12	12	-	12	13	-	13


Te dhëna të përgjithëshme për arsimin në Komunat për vitin 2015

Emertimi	Viti 2015		
	Total	Publik	Jo Publik
Kopeshte gjithsej	33	33	-
Femije te rregjistruar	1341	1341	-
Shkolla gjithsej	42	41	1
Nr. i nxenesve gjithsej	9923	9887	36
Nr. i mesuesve gjithsej	538	527	11
Shkolla 9-vjecare	34	34	-
Nr. i nxenesve gjithsej	8373	8373	-
Nr. i mesuesve gjithsej	452	452	-
Shkolla te Mesme gjithsej	8	7	1
Nr. i nxenesve	1550	1514	36
Nr. i mesuesve gjithsej	86	75	11


Burimi i te dhenave :Sektori i Arsimit ne Bashki, DAR

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

**Paraqitja grafike në vite e shkollave të sistemit para universitar
në qytetin e Durrësit**




**Paraqitja grafike në vite e shkollave të sistemit parauniversitar
në Bashkinë e Durrësit**




SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Më poshtë pa paraqesim grafikisht të shprehur në % numërin e shkollave të ndara në publike dhe jo publike për qytetin e Durrësit dhe për Bashkinë e Durrësit për vitin 2015.

Paraqitja grafike e shkollave në qytetin e Durrësit për vitin 2015




Paraqitja grafike e shkollave në Bashkinë e Durrësit për vitin 2015



Nga paraqitjet grafike vëmë re se për qytetin e Durrësit, numri i shkollave publike është 30 ose 48% , pra më i vogël se numri i shkollave jo publike që është 33 ose 52%. Përsa i përket Bashkisë Durrës, numri i shkollave publike është 71 ose 68%, pra më i madh se numri i shkollave jo publike që është 34 ose 32%. Kjo ndodh se në Komuna kemi vetëm një shkollë jo publike dhe 41 shkolla publike.

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Paraqitja grafike në vite e shkollave dhe nxënësve të rregjistruar



Më poshtë po paraqesim të dhëna për cerdhet dhe kopshtet e qytetit të Durrësit për vitin 2015.

Cerdhe Publike

Emertimi	Numri i cerdheve	Numri i femijeve	Punonjes	
			Gjithsej	Edukatore
Cerdhe	4	487	87	53
Cerdhe Nr.1		124		12
Cerdhe Nr.2		96		11
Cerdhe Nr.3		167		16
Cerdhe Nr.4		100		14

Kopshtet në Qytetine Durrësit

Emertimi	Publike				Jo Publike				Nr. Kopeshte ve ne total	Nr. femijeve total
	Me ushqim		Pa ushqim		Me ushqim		Pa ushqim			
	Nr. kopesht eve	Nr. femijev e	Nr. kopsh teve	Nr. Femije ve	Nr. kopsh teve	Nr. femijev e	Nr. kopshte ve	Nr. femijev e		
Kopeshte	6	883	7	820	3	112	1	29	17	1844
Kopeshte ne shkolla			8	388	4	178	1	59	13	625
Nr. kopesh.gjithsej	6		15		7		2		30	
Nr. Femij. gjithsej		883		1208		290		88		2469

Burimi i te dheneve: Sektori i Arsimit ne Bashki

SHENDETESI-ARSIM-KULTURE-SPORT

Kopështe në Komunitet e Bashkisë Durrës

Komunitet	Kopështe Publike Pa ushqim			Nr. i Fëmijëve në Kopështe		
	Total	Kopështe	Kopështe në shkollë	Total Fëmijë	Kopështe	Kopështe në shkollë
Sukth	6	3	3	386	211	175
Manez	7	4	3	228	150	78
Ishëm	8	1	7	182	46	136
Rrashbull	6	2	4	325	172	153
Katund i Ri	6	2	4	220	73	147
Total	33	12	21	1341	652	689

Për vitin 2015, për Bashkinë Durrës, numri i kopështeve është 63 si më poshtë :

- Kopështe në Durrës 30
 - Kopështe në Sukth 6
 - Kopështe në Ishëm 7
 - Kopështe në Rrashbull 8
 - Kopështe në Katundin e Ri 6
- 63**

Sipas pasqyrës së mësipërme, në qytetin e Durrësit ka 30 kopështe nga të cilat 21 kopështe janë publike dhe 9 kopështe janë jo publike, që do të thotë që 70% janë kopështe publike dhe 30 % janë kopështe jo publike.

Në Bashkinë Durrës, për vitin 2015, ka 63 kopështe, nga të cilat 54 kopështe janë publike dhe 9 kopështe janë jo publike, që do të thotë që 85.7 % janë kopështe publike dhe 14.3 % janë kopështe jo publike. Kjo vjen për faktin se në Komuna nuk ka kopështe jo publike.

Arsimi shkollor përbëhet nga shkollë të ciklit 9-vjecar, të mesëm klasik dhe profesional.

